ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 20 SHKURT 2021. NUMËR 118. VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Filologjia shqiptare krenohet me një traditë të lavdërueshme studimesh në lëmin arbëresh. Ajo, e nisur me baza të shëndosha shkencore nga Demetrio Camarda, është përditësuar gjatë shekullit të kaluar nga filologë të shkëlqyer, përmend në veçanti Imzot Giuzeppe Schirò, zbulues i disa veprave të rëndësishme si dhe botues i parë i *Mesharit* të Gjon Buzukut.

MATTEO MANDALA:

Njerëzit e mëdhenj dhe veprat e mëdha kanë fatin të kujtohen përjetësisht

Bisedoi Andreas Dushi

MEHMET KRAJA
nderohet me çmimin
"Azem Shkreli"
për Vepër Jetësore (fq. 5)

IN MEMORIAM
Shuhet Lefter Çipa,
poeti i bregut (fq. 7)

Shpërfillja e Gjergj Pekmezit
Istref Haxhillari (fq. 9)

SHËNIME PËR LIBRAT

Mbresa nga dy librat e Xhevat Beqarajt "Rruazat e vesës" dhe "Me një dallëndyshe"

Këndaqësia me artin e përkryer
Xhevat Syla (fq. 10)

Mbi librin "Kartela të realizmit të dënuar" të Visar Zhitit

Heshtja ndihmon shtypësin, asnjëherë viktimën
Minella Aleksi (fq. 12)

Romani "Mirë se vini zoti ambasador" nga Ardian Haxhaj

Sarkazma dhe grotesku si kundërvënie ndaj realitetit ekzistencial
Arben Veselaj (fq. 13)

Libri me tregime "Mbretëria e ëndrrave" i Ndue Ukajt

Kumtet e andrrave të këqija
Nga Ardian Ndreca (fq. 15)

Romani "Kukulla" i Kadaresë

Metamorfoza e shndërrimit të nënës në kukull
Gentiana Bajrami Atashi (fq. 14)

Silueta prometeike e De Radës
Skënder Karriqi (fq. 16)

SHKRIMTARI DHE JETA PUBLIKE
Tony Morrison

(fq. 22)

A ka një shkencë letrare?
Nga Behar Gjoka (fq. 6)

Humnera verifikuese, ose situata e mbrapshtë e mosverifikimit të letërsisë prej studimeve shqiptare, me ndonjë parathënie rastësore, e sidomos me kumtesa të shqiptuara përvitshëm në katedrat e trojeve shqiptare, me llomotimën e vet, ma tepër të një shkencërimi kinse formal, e ka sjellë situatën deri në shtrimin e çështjes hapur, në se ka vërtet një shkencë për letërsinë?

BIBLIOTEKË

Shqiptar Oseku
Lamtumirat (fq. 18)

Nasi Lera
Vetmia e syve të qenit (fq. 19)

Jorge Luis Borges
Mrekullia e fshehtë (fq. 20)

Studiuesit dhe shkrimtarit Çapaliku i është dashur shumë kohë për kërkime e hulumtime në Shkodër, në Durrës, si edhe në vendlindjen e artistit, në Itali.

RENZO COLLURA,
një artist i humbur në Shqipëri
Ferid Hudhri (fq. 17)

Fuedalizmi si "Tjetri" i shqiptarëve (fq. 8)
Artan Hoxha Ph. D.

Studimi "Shpikja e Mesjetës: Vetja dhe Tjetri në medievistikën shqiptare" i Doan Danit i botuar në vitin 2016, paraqet mjaft interes për diskutimin që i bën historiografisë shqiptare...

MATTEO MANDALA:
Njerëzit e mëdhenj dhe veprat e mëdha kanë fatin të kujtohen përjetësisht

Bisedoi Andreas Dushi

Profesor Matteo, biseda me ju është një gëzim i parrëfyeshëm, si ai që ndjen një nxënës kur profesori pasionant merr fjalën dhe fillon të shpjegojë temën e ditës. Libri juaj "Arbërishtja në rrjedhë të shekujve" u nderua me Çmimin Kombëtar të Letërsisë si libri më i mirë studimor. Me ç'emocion e përcollët këtë vlerësim?

Gjithashtu është një kënaqësi për mua të bisedoj me ju, i dashur Andreas. Faleminderit për fjalët që më drejtuat, të cilat i vlerësoj veçanërisht për sinqeritetin e tyre. Por me të njëjtin sinqeritet do të doja t'ju tregoja se veprimtaria ime kërkimore ka për qëllim arritje (potenciale) shkencore dhe në veçanti, përparimin e shkencës sonë të përbashkët, albanologjisë. Prandaj nga pikëpamja profesionale më shpërblejnë plotësisht konsideratat, madje edhe kur ato janë kritike, (por të shëndosha) të kolegëve të mi të nderuar albanologë. Kur këto vlerësime shoqërohen edhe me surprizën e bukur të një çmimi me prestigj siç është Çmimi Kombëtar i Letërsisë për librin më të mirë studimor, emocionet janë të pashmangshme. E shfrytëzoj rastin për të falënderuar përzemërsisht Jurinë e çmimit dhe organizatorët e këtij evenimenti të rëndësishëm për Kulturën dhe Albanologjinë mbarëshqiptare.

Veprimtaria juaj kërkimore dallohet për një spektër të gjerë fushash – nga historia deri në gjuhësi, në letërsi dhe në filologji... Por duhet thënë se një rëndësi të veçantë i keni kushtuar letërsisë arbëreshe. Si e shihni sot panoramën e përgjithshme të studimeve të kësaj letërsie? A ka mjaftueshëm studime cilësore për të?

Me qëllimin e mirë që një shkencë të mund të quhet e gjallë, studimet nuk mund të konsiderohen asnjëherë shteruese. Sipas një ligji të Karl Popper-it do të bënim një gabim të madh nëse do të konsideronim përfundimtarë rezultatet e arritura. Për pasojë, kërkimi shkencor duhet të jetë përherë, në mënyrë të vazhdueshme, në lëvizje dhe të eksplorojë hipoteza dhe rrugëtime të reja. Studimi i letërsisë arbëreshe dhe në përgjithësi i asaj shqiptare gëzon shëndet të plotë. Studimet filologjike të kryera nga katedrat albanologjike simotra të Universiteteve të Kalabrisë dhe Palermos, kanë propozuar botimet kritike të klasikëve arbëreshë në variante tekstesh në besnikëri të plotë dhe njëherazi kanë sjellë vepra të pabotuara të autorëve që kanë jetuar në shekujt XVIII dhe XIX. Me ardhjen e tyre në dritë, këto botime, jo vetëm që kanë plotësuar boshllëqet që haseshin sidomos në fazën "fillestare" të letërsisë moderne arbëreshe, por duke na dhënë mundësinë të rindërtojmë historinë e qytetërimit letrar arbëresh, kanë pasuruar më tej njohjen e një fenomeni letrar dhe kulturor të një rëndësie të veçantë në një periudhë kur në vendet shqipfolëse të Ballkanit nuk kishte lindur ende një fenomen të ngjashëm. Pa dyshim, ky mund, ka kërkuar përditësim metodologjik dhe një vizion të ri epistemologjik të shkencës së përbashkët albanologjike. Duke ecur në gjurmët e mësimeve të vyera të Mjeshtërve të shkëlqyer të së kaluarës (përmend për të gjithë studiuesit shqiptarë Eqrem Çabej dhe Dhimitër S. Shuteriqi si dhe ata arbëreshë Giuseppe Faraco, Francesko Solano dhe Antonino Guzzetta), katedrat e sipërpërmendura kanë vënë në jetë metodologji shumëlëndore që kanë rrëzuar kufijtë e rremë ndërmjet specialiteteve në fushën albanologjike, duke nxjerrë kështu në pah pikat e forta të secilës dhe duke arritur rezultate që janë të dukshme për këdo. Në programin dhjetravjeçar të kërkimeve të përgatitur dhe në një pjesë të mirë të ndikuar nga miku dhe kolegu Françesko Altimari, *Decanus* i albanologëve italianë, hetimet gjuhësore dhe ato filologjike, ato historiko-kulturore dhe antropologjike, kanë dialoguar në mënyrë të frytshme, duke u dhënë një shtysë të fortë kërkimeve që sot vijojnë sipas angazhimit të studiuesve të rinj arbëreshë.

Duket sikur studentët tek përgatisin temat apo desertacionet, studiojnë vetëm pak emra të përveçëm nga përfaqësuesit e letërsisë arbëreshe. Si sugjerim për to, por edhe si konstatim i nxjerrë nga përvoja juaj e gjatë akademike: Për cilin nga shkrimtarët arbëreshë mendoni se studimet e deritanishme janë të pamjaftueshme?

Nëse i referohemi studentëve shqiptarë, ndesh vështirësi t'i përgjigjem pjesës së parë të pyetjes. Nuk kam ndër duar elementë të mjaftueshëm për të vlerësuar arsyet që shpënë në këtë situatë të pakëndshme, kundër së cilës do të ishte e udhës të kërkohej një fuqizim i efektshëm i didaktikës së kulturës arbëreshe në fushën universitare shqiptare. Për sa i përket studimeve, ndeshemi me një situatë kontradiktore: nga njëra anë, nuk ka dyshim se disa autorë arbëreshë janë studiuar në të shkuarën dhe se të tjerë kanë tërhequr vëmendjen kohët e fundit, kjo edhe në sajë të njohjes së trashëguar nga e kaluara. Porse, nga ana tjetër, dergjen në errësirë autorë pak të njohur ose të panjohur, veprat e të cilëve pak nga pak po dalin në dritë. Kujtoj këtu, për shembull, veprat e Nikollë Ketës (Nicolò Chetta, 1742-1803) ose *Kodiku i Kieutit* (italisht *Codice chieutino*) i Nikollë Filjës (Nicolò Figlia, 1693-1769), të parat të botuara tashmë edhe në Shqipëri dhe tjetra në rrugë botimi. Në pjesën dërrmuese bëhet fjalë për autorë të fazës më të hershme të letërsisë shqiptare, të përmendur shpesh në historitë e letërsisë shqiptare, porse shumë pak të studiuar si fenomene letrare. Së fundmi, nuk mund të mos shpreh keqardhjen rreth vëmendjes së mangët për autorët bashkëkohorë, disa të botuar në Shqipëri, por edhe këta pak të përhapur dhe të studiuar.

Për të qëndruar edhe pak këtu, prej shumë vitesh tanimë, keni ligjëruar në disa universitete, në Itali dhe Shqipëri. Si e shihni interesimin e studentëve

në studimin e letërsisë, historisë apo kulturës arbëreshe në përgjithësi?

Pikësëpari u jam mirënjohës kolegëve të disa universiteteve shqiptare, si atij të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Elbasanit, Gjirokastrës dhe Vlorës, të cilët në të kaluarën e afërt kanë organizuar aktivitete kushtuar kulturës arbëreshe duke na krijuar mundësinë e të qenit në kontakt me disa breza studentësh shqiptarë. Në përgjithësi, mund të them, edhe në sajë të dëgjuesve të shumtë, që takimet janë shoqëruar me interes të lartë nga ana e studentëve; por që gjithsesi nuk më lejon të them më shumë sesa ajo që thashë më sipër, duke mos pasur të dhëna të tjera.

Sipas jush, cila mund të jetë arsyeja përse Jeronim de Rada, ndonëse shkroi shumë për Shqipërinë, nuk e vizitoi asnjëherë atë?

Kanë luajtur rol, patjetër, kushtet historiko-politike të përgjithshme, por nuk duhen përjashtuar edhe arsyet personale - pasojë e vuajtjeve të hequra nga i madhi Jeronim de Rada. Për hir të së vërtetës, janë shumë të paktë arbëreshët që vizituan Shqipërinë para Pavarësisë së saj në 1912. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX Pietro Chiara ndërmori një udhëtim të gjatë, i cili frymëzoi librin e tij *L'Albania* (1869), më vonë qe Terenzio Tocci që erdhi për të ndihmuar kryengritjen ushtarake kundër pushtimit osman dhe pas shpalljes së Pavarësisë, qe Giuseppe Schirò që arriti të shumëdëshiruarën tokë mëmë. Mund të themi, se për ironi të fatit, Jeronim de Rada nuk pati fatin e mirë të shkelte tokën e Shqipërisë ideale, që ai vetë kishte kontribuar të ndërtonte.

Në studimet tuaja, vërejmë qasjen nëpërmjet filologjisë moderne shqiptare, ektodikës. Çfarë mund të na thoni diçka më tepër për këtë metodë?

Filologjia shqiptare krenohet me një traditë të lavdërueshme studimesh në lëmin arbëresh. Ajo, e nisur me baza të shëndosha shkencore nga Demetrio Camarda, është përditësuar gjatë shekullit të kaluar nga filologë të shkëlqyer, përmend në veçanti Imzot Giuzeppe Schirò, zbulues i disa veprave të rëndësishme si dhe botues i parë i *Mesharit* të Gjon Buzukut. (Gjej rastin të kujtoj këtu, se botimi i parë kritik i veprës së Buzukut dergjet ende në dorëshkrim: njohja e saj nga ana e studiuesve shqiptarë do të ishte me vend dhe patjetër do të ishte vlerësimi më



Matteo Mandala dhe Kadare, Bar Juvenilja, Tiranë, 28 nëntor 2018

i mirë ndaj figurës dhe punës së Imzot Schirò). Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, rifillimi i studimeve është meritë e padiskutuar e një plejade studiuesish (Gaetano Petrotta, Giuseppe Valentini, Marco la Piana, Matteo Sciambra, Giuseppe Faracco, Francesco Solano dhe Antonino Guzetta), të cilët i lanë detyrë brezit pasardhës zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm të albanologjisë, i cili në të njëjtën kohë kishte marrë stimuj që nuk mund të mos merreshin në konsideratë nga studiues shqiptarë, ndër të cilët kam nderin të përmend Eqrem Çabejn. Shtysa erdhi nga Francesco Altimari, i cili me largpamësinë e vet shënjoi trajektoren e re të studimeve albanologjike duke dalluar dy pikësynime parësore: nga njëra anë qasja ekdotike për risjelljen e teksteve dhe, nga ana tjetër, përpunimin informatik të tyre që lejon analizën leksikore e cila i vjen në ndihmë përpilimit të fjalorit të madh, si dokument i shkruar i gjuhës arbëreshe. Si vijim i kësaj ideje, lindi projekti BESA (Biblioteka Elektronike e Studimeve Arbëreshe), që sot ka arritur në fazën përmbyllëse falë publikimit të një pjese të mirë të veprave letrare të traditës arbëreshe. Ekdotika ka luajtur rol kryesor në arritjen e këtij rezultati duke qenë se ka përfaqësuar metodën më funksionale në shërbim të synimit të dyfishtë të projektit. Nëse kjo qasje do të lulëzojë edhe në mesin e studiuesve shqiptarë, do të jetë e mundur të niset një projekt i ngjashëm edhe për letërsinë shqiptare.

Ka një apo dy vjet që është risjellë sërish në vëmendje Françesk Anton Santori. Ç'mendim keni për këtë personalitet si dhe çfarë vendi zë ai në udhën e letërsisë arbëreshe?

Nismat e ndërmarra nga katedra e albanologjisë së Kalabrisë për të kujtuar këtë figurë të ndritur me rastin e dyqind vjetorit të humbjes së tij, si dhe botimi i veprës së tij të plotë sipas një qasjeje të rreptë ekdotike, ishin më se të duhura. Për shkak se shumë prej shkrimeve të tij janë akoma të pabotuara, njohja e veprës së tij është ende e pa plotë. Porse, kjo nuk na pengon aspak të pohojmë se Françesk Anton Santori zë një vend nderi në panoramën e letërsisë arbëreshe të Rilindjes, qoftë për cilësinë, për zhdërvjelltësinë dhe origjinalitetin e veprës së tij letrare në përgjithësi, qoftë për tiparin modern të angazhimit të tij intelektual. Jam i bindur se interesi për Santorin do të vijë gjithnjë në rritje, ashtu si edhe përhapja e veprave të tij, botimi i të cilave është programuar nga Francesco Altimari me bashkëpunimin e një grupi të konsiderueshëm studiuesish arbëreshë.

Para pak ditësh, keni nxjerrë në dritë një dokument të panjohur për Heroin tonë kombëtar, Gjergj Kastriotin. Si e shihni vendin e tij në historinë e Evropës dhe a mendoni se sot, ai ka gjithë vlerësimin e merituar?

Përtej të gjitha pozicionimeve, Gjergj Kastrioti mbetet pikë referimi e historiografisë që ka objekt studimi mesjetën evropiane. Nga pikëpamja kulturore, përhapja në kohë dhe hapësirë e mitit të tij ka qenë vazhdimisht frymëzim për letrarët e pothuaj të gjithë vendeve të Kontinentit të Vjetër. Nëse sot nuk çuditemi që vazhdojnë e zbulohen vepra letrare, siç është rasti i asaj që pata fatin të zbuloja unë, lidhet pikërisht me famën që ka pasur Skënderbeu gjatë shekujve pas humbjes së tij. Në javët vijuese do të paraqes për lexuesit e *ExLibris* të tjerë artikuj të shkurtër kushtuar Heroit tonë, të cilët e kanë përjetësuar në *Fushat e Elizeut* si të Privilegjuar, i dashur nga hyjnitë. Ky mund të konsiderohet si përgënjeshtrim i përpjekjeve të atyre

që menduan se ishte e thjeshtë të çliroheshim nga forca e rrënjosjes së një miti të vërtetë si ai i Skënderbeut: nuk ishte hera e parë, por ajo që ndodhi para pak vitesh ishte e pahijshme si për nga diletantizmi dhe gjykimi sipërfaqësor i të ashtuquajturve çmitizues.

Së fundmi, keni "sprovuar" veten, nëse më lejoni ta përdor këtë term, edhe në përkthim nga shqipja në italisht. "Metamorfozat e një kryeqyteti" të Ylljet Aliçkës si dhe "Rrugët e ferrit" të Visar Zhitit, nëpërmjet jush, i janë paraqitur a do t'i paraqiten lexuesit italian. Si ishte kjo eksperiencë për ju, kur mund të themi se si shqipja, si italishtja janë gjuhë amtare tuajat?

Nëse në marsin e vitit 2019 pandemia e papritur nuk do të më kishte detyruar të mbyllesha në shtëpi, ndoshta nuk do të kisha menduar asnjëherë se do të përktheja romanet e Ylljetit dhe Zhitit. Përkthimi, edhe pse një nga fushat e mia të studimit, nuk më ka përfshirë asnjëherë në vetë të parë. Duhet të them se ka qenë një përvojë stimuluese, që më ka lejuar të verifikoj *in corpore vili* vlefshmërinë e disa teknikave të përkthimit dhe të shoh të tjera. Fakti që jam dygjuhësh ka qenë avantazh, por jo vendimtar, edhe sepse shqipja e dy romaneve, e dallueshme sipas veçantive të autorëve, është e ndryshme nga gjuha arbëreshe.

Dhe për ta mbyllur, doja t'ju pyes pak për shkrimtarin tonë të madh Ismail Kadare. Veprën e tij e keni përfshirë shpesh në studimet tuaja. Veçoj këtu "Në studion Kadare – Botim kritik i dorëshkrimeve të romanit Dimri i vetmisë së madhe", studim i cili krijon një fushëpamje të re të kësaj vepre, nëpërmjet dorëshkrimit autograf. Cila ka qenë njohja juaj e parë me autorin si dhe, si e vlerësoni sot rëndësinë e veprës së tij në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar?

Interesi im për veprën e Ismail Kadaresë është përqendruar në planin shkencor pas ftesës nga botuesi Bujar Hudhri për të shkruar parathënien e romanit *Kështjella* në rastin e botimit të veprës së plotë në njëzet vëllime. Rastësia më diktoi të lexoja të gjithë prodhimtarinë narrative kadareiane, e cila më ofroi ide frymëzuese që më parë, edhe në sajë të leximit episodik të veprave të shkëputura, më mungonin plotësisht. Prej atij *full immersion* përftova një perspektivë të re kritike, një qasje personale hermeneutike ndaj botës narrative kadareiane që më lejoi ta ripagëzoj *Ismailand* [nga angl.: (it) is-my-land]. Botimi besnik i romanit *Dimri i vetmisë së madhe,* që unë çmoj si kryevepër të mirëfilltë narrative, bazohet në dorëshkrimet prej të cilëve u bë botimi i vitit 1973. Qe një përvojë ekdotike me dobishmëri të madhe që më hapi portat e laboratorit të shkrimtarit duke më lejuar të hyj kështu në atë zonë sekrete ku mësohen të fshehtat e të shkruarit vetjak, sistemi i punës, teknikat, shtysat, zakonet dhe deri te përfytyrimet më intime. Të rindërtosh fjalë për fjalë dhe fjali për fjali tekstin e një vepre të ndërlikuar në strukturë dhe me përmbajtje mjaft të brishtë për kohën, ka qenë mbështetja më e plotë që një studiues letërsie mund të ketë për të hyrë në shpirtin e artistit dhe të veprës së tij. Mund të pohoj se e njoha Kadarenë duke u endur nëpër shtigjet e fshehta që përshkojnë romanin e tij të famshëm dhe që për habinë time, përsëriten në historitë e të gjitha veprave të tjera. Fakti që sot kjo vepër madhështore narrative bën pjesë në trashëgiminë e letërsisë botërore dhe emri i Ismail Kadaresë lartësohet në Panteonin e shkrimtarëve më të çmuar, tingëllon si vlerësimi më i mirë dhe i autoritetshëm që asnjë mburracak s'do të mund të zbehë. Njerëzit e mëdhenj dhe veprat e mëdha kanë fatin të kujtohen përjetësisht.

Përktheu nga italishtja: Dr. Lindita Kazazi

I pari libër që bleva gjatë udhëtimit tim të parë në Shqipëri

Matteo Mandalà

"Në botën e arbëreshëve të Italisë" ka qenë i pari libër që bleva gjatë udhëtimit tim të parë në Shqipëri. Gjatë atij udhëtimi do të blija të tjerë libra, por ky qe i pari. Ishte fundi i verës së vitit 1987 dhe bëja pjesë në një grup studentësh arbëreshë që ndiqte kursin e gjuhës dhe të kulturës shqiptare.

Mbaj mend sesi kureshtja e natyrshme e arbëreshit që për herë të parë vizitonte atdheun mitik të të parëve përplasej dhunshëm me realitetin e një vendi që na u shfaq qysh në fillim në tërë zymtësinë, trishtimin dhe prapambetjen e thellë ekonomike. Nga ai udhëtim prisja të zgjeroja njohuritë e mia, çka ndodhi vërtet, por nuk prisja të përjetoja ato përshtypje që më lanë mbresa të thella.

Në vend që të na vendosnin në Tiranë, sikurse ka kishin premtuar, na degdisën, "për arsye sigurie", në një hotel të plazhit të Durrësit: ato ditë ambasada italiane ishte e rrethuar nga policia sepse brenda mureve të saj ndodhej familja Popa që kishte kërkuar strehim politik. Mund të merret me mend gjendja që u krijua mes ankimeve tona të drejta për izolim dhe sikletit të shoqëruesve që përpiqeshin me çdo mënyrë të na kënaqnin sa mundeshin. Një ditë fundi shtatori u organizua një ekskursion. Rrugës për në Berat, ndërsa përshkonim qytetin e Lushnjës me një autobus të vjetër, më zuri syri librari. Kërkova dhe m'u dha leja ta vizitoj. Zbrita me nxitim nga autobusi dhe iu afrova shitëses, e cila po ngjiste në derë një fletë ku kishte shkruar: "me raport mjekësor". "Jemi mbyllur, shok!", më tha duke me treguar fletën. Mirëpo ato çaste mbërriti një djalosh me një pako me libra dhe shitësja u detyrua ta hapte derën. Rrëmbeva librin e parë nga pakoja e sapohapur mbi banak dhe pa lexuar as titullin pagova dhe dola jashtë. Më në fund kisha në duar një libër të botuar në Shqipëri! Sapo hipa në autobus lexova kopertinën: Eqrem Çabej, Në botën e Arbëreshëve të Italisë. Ishte si një shenjë ogurmirë! Ai titull më bëri aq shumë përshtypje sa fshiu si me magji absurditetin e situatës ku gjendeshim dhe më ngrohu zemrën, duke më dhënë kurajën për ta vazhduar deri në fund atë udhëtim të çuditshëm.

Në parathënien e shkruar nga një tjetër studiues i shquar, prof. Mahir Domi, lexova shprehje që më kanë mbetur në kujtesë dhe që i përsëris sa herë më bie rasti t'u shpjegoj shqiptarëve rolin që lozën historikisht arbëreshët në procesin e gjatë dhe të mundimshëm të formimit të lëmenjve të ndryshëm që përbëjnë albanologjinë e sotme. Mahir Domi vinte në pah njohjen e thellë dhe vlerësimin e Çabejt për atë rol, duke e mbyllur parathënien me fjalët: "Botimi i kësaj përmbledhjeje do t'i shërbejë shumë jetës sonë shkencore e kulturore, do të bëjë të njohura në rrethe të gjera aspekte me interes të historisë së kulturës shqiptare, të pasurive shpirtërore të popullit tonë, studime këto me vlerë të një figure të shquar të shkencës sonë".

Sot për hir të së vërtetës nuk kam të dhëna të sakta mbi efektet dhe ndikimin që ushtroi ky libër ndër lexuesit dhe studiuesit shqiptarë. Mund të flas vetëm për ndikimin që ushtroi tek unë, asokohe student i ri, që hidhja hapat e parë në botën magjepsëse të albanologjisë. Leximi i asaj përmbledhjeje studimesh ngjalli tek unë një nderim të menjëhershëm për nivelin shkencor të Eqrem Çabejt, nderim që gjatë viteve në vijim u konsolidua e u shndërrua në një vlerësim objektiv të kontributit të tij të jashtëzakonshëm në lëmin e studimeve arbëreshe. Udhëzimet e vyera metodologjike të Çabejt, interesi i sinqertë dhe ndjenjat e tij miqësore për arbëreshët që rrezatonin faqet e atij libri mund të them se përcaktuan zgjedhjen time për t'iu përkushtuar kërkimeve albanologjike. Edhe për këtë arsye fjalët e Mahir Domit e ruajnë ende sot të njëjtin vitalitet që më trazoi asokohe ndërgjegjen.Angazhimi i gjuhëtarit dhe filologut që e kishte zënë fillin me studimet vjeneze, u konkretizua me studime të shumta që u botuan gjatë periudhës mes viteve '30-'50. Po t'i shohim këto studime nga një pikëpamje globale, do të vëmë re se metoda e zbatuar nga Çabej mbante gjurmët e mësimeve të profesorit të tij të madh, Norbert Joklit, dhe të veprës së tij Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen (1923), vepër që kishte përuruar – sikurse thoshte Carlo Tagliavini – një «model të historisë gjuhësore-kulturore një një fushë veçanërisht të vështirë» si ajo e albanologjisë. Veç kësaj, disa shqyrtime të tjera krahasuese mbi punimet rinore të Çabejt më lejuan të evidentoj karakterin thellësisht shkencor të sistemit të tij hermeneutik.

Përfundimet e mia nxirrnin në pah jo vetëm rolin e rëndësishëm që luajti Çabej qysh në fillim të viteve '50 për t'i hedhur themele të forta shkencore ngrehinës së filologjisë shqipe, por edhe përpjekjet e tij titanike në përvijimin e kufijve të rinj epistemologjikë të Albanologjisë, a thënë ndryshe, të asaj shkence ndërdisiplinore që ai parapëlqente ta quante "Albanistikë", duke zgjedhur një term të traditës perëndimore dhe evropiane, në vend të asaj sovjetike.

Në fakt, Çabej ishte ndër të paktët studiues që vinin në qendër të vëmendjes tekstin, problemet dhe strukturën e tij, – në radhë të parë gjuhën, por edhe stilin, pra, formën dhe shkrimin, – pa lënë mënjanë edhe gjithçka që rrethonte tekstin (autorin, kontekstin historiko-kulturor, diakroninë tekstore). Ai nuk iu nënshtrua kurrë prirjeve ideologjike të pedagogjisë popullore, e cila i kërkonte shkencës t'u përshtatej me çdo kusht nevojave divulgative dhe propagandistike të regjimit. Qëndrimet e tij, të karakterizuara nga maturia, takti dhe thellësia e mendimit sot marrin vlerë të veçantë dhe na japin përmasat moderne të shkencës së albanologjisë nëse i shohim në tërësinë e tyre, pleksur bashkë aspektet gjuhësore me ato kulturore, pra, qoftë kontributet organike dhe sistematike, si botimi kritik i "Mesharit", qoftë edhe studimet me frymëmarrje të gjerë historiko-kulturore si ato që përfshihen "Në botën e arbëreshëve të Italisë".

Nga ky kënd vështrimi hulumtimet e tij në botën arbëreshe marrin një vlerë të jashtëzakonshme, do të thosha strategjike për fatet e ardhme të albanologjisë. Me anë të tyre Çabej shpërndau mjegullën e dendur që kishte rrethuar historinë, gjuhën, letërsinë, kulturën dhe etnografinë arbëreshe dhe u rrëfeu udhën studiuesve të rinj për një qasje epistemologjike më moderne e organike ndaj studimit të çështjeve ende të hapura të botës sonë arbëreshe. Jo rastësisht, Çabej i konsideroi arbëreshët si një burim të pashtershëm për njohjen dhe studimin e historisë së gjuhës shqipe si edhe të përmasave të saj antropologjike e kulturore, duke u njohur atyre një rol që për fat të keq ende sot nënvlerësohet: "Nga këto vatra të shkëputura, nga ky "gjaku ynë i shprishur", si shprehet Jeronim De Rada, ato të Italisë nga pikëpamja kulturale zënë vendin e parë. Bijtë e shquar që kanë dalë prej këtyre vatrave të andejdetit kanë vënë një gur themeltar në ndërtesën e një kulture shqiptare".

Nëse gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve të fundit albanologët arbëreshë kanë sjellë dëshmi të reja që konfirmojnë përfundimet ku mbërriti Eqrem Çabej, merita për këtë i shkon edhe atij që në kohë të vështira, falë kontributeve të shumta dhe refleksioneve stimuluese, diti të çelë shtegun dhe të tregojë udhën për t'u ndjekur. Asnjë gur, sado i lashtë, nuk ka gojë të dëshmojë për historinë po nuk e bëri të flasë arkeologu i ditur. Eqrem Çabej i dha gojë historisë së arbëreshëve dhe rolit të tyre në kulturën kombëtare e për këtë arbëreshët do t'i jenë përjetë mirënjohës.

(Marrë me shkurtime nga libri i M. Mandalà-së me titull "Studime albanologjike", botimet "Naimi", Tiranë 2018)

Mehmet Kraja nderohet me çmimin "Azem Shkreli" për Vepër Jetësore

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit këtë vit Çmim Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli", ia ndau autorit, njëherit kryetarit të Akademisë së Shkencave, Mehmet Kraja.

Për nder të 13-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ndau edhe çmimet vjetore për letërsi për Ag Apollonin dhe Blerina Rugova-Gaxha.

Ministrja në detyrë, Vlora Dumoshi tha se përmes letërsisë është shpërfaqur identiteti jonë kombëtar.

"Nuk është e rastësishme që e kemi caktu këtë ditë për ta ndarë këtë çmim. Letërsia është shtet ndërtimi i Kosovës. Gjithmonë e kemi shpërfaqur identitetin tonë kombëtar përmes letërsisë, vargut dhe prozës", tha ajo.

Ndërsa, fituesi i çmimit, autori Mehmet Kraja duke u shpreh falënderues, tha se çmimet nuk e bëjnë letërsinë, por për ambientin e letërsisë kanë rëndësi, raporton KP, transmeton Klan Kosova.

"Urojë që vlerësimet që kanë dalë nga juria të jenë vlerësime reale. Çmimet nuk e bëjnë letërsinë, por për ambientin e letërsisë kanë rëndësi", tha ai.

Marrë nga Klan Kosova











A ka një shkencë letrare?

Nga Behar Gjoka

Humnera verifikuese, ose situata e mbrapshtë e mosverifikimit të letërsisë prej studimeve shqiptare, me ndonjë parathënie rastësore, e sidomos me kumtesa të shqiptuara përvitshëm në katedrat e trojeve shqiptare, me llomotimën e vet, ma tepër të një shkencërimi kinse formal, e ka sjellë situatën deri në shtrimin e çështjes hapur, në se ka vërtet një shkencë për letërsinë? Ndaj kësaj pyetjeje, në thelbin e vet sugjeruese dhe, mbi të gjitha, të vënë në kërkim të rrënjëve të interpretimit dhe verifikimit të teksteve letrare, evidentohen së paku dy qëndrime të ndryshme:

A – Ka një shkencë të letërsisë, madje që lulëzon gjer në kulm, si dëshmi klasike dhe moderne, e cila përbëhet nga teoria letrare, kritika dhe historia e letërsisë. Pra, simbas

akademizmit diturak, në këto punë kemi një shkencë të mirëfilltë, që përbëhet nga tri disiplina dhe, secila prej këtyre kanë si objekt letërsinë. Përsëri, gjendur përballë zhurmës zyrtare, mbi gjoja shkëlqimin e shkencës së letërsisë, vetvetiu më erdhi në mendje Harold Bloom-i, që mes të tjerash, për mbijetesën e letërsisë, thotë: ... zor se ia ka nevojën trumbetave potermadhe të sekteve akademike... te libri Si dhe përse lexojmë, që ndihmon ca më shumë për të hapur debatin mbi këtë çështje jetike për letërsinë dhe të rolit të studimeve letrare mbi të.

B – Letërsia, në mjediset serioze, që e dinë mirë se ç'janë vlerat specifike shpirtërore/letrare, ka qenë dhe është e para, dhe ndërkaq, e dyta në radhë është qasja dhe verifikimi i saj, që kryhet në procesin e leximit dhe të studimit të veprës letrare. Kur letërsia përjetohet dhe thuhet se është e para, përfundimet e leximit, rileximit, shqyrtimit dhe analizës, pra proceset e njohjes dhe të interpretimit të saj, janë të ndërvarura nga thelbi i tekstit letrar, i cili megjithatë, në çdo lexim zbulohet rishtas, si dhe ndërkohë, asnjë lexim, sado i ardhur nga akademikët, nga profesorët e universiteteve, nga studiuesit e qendrave apo të institucioneve albanologjike, nuk arrin që të shpjegojë përfundimisht të pashpjegueshmen e veprës letrare, që përbën një realitet imediat, i cili zbulohet vetëmse pas çdo leximi. Konceptimi i shkencës së letërsisë duhet bazuar në hulumtime dhe jo në tituj, në libra dhe jo në paçavra llafollogjemash, pra jo të bëjmë sikur po bëhet shkencë e madhe me anë parathëniesh dhe kumtesash, por të rrahim mendimet përtej interesave mësimdhënëse, që kanë të bëjnë me dobinë utilitare e jo me vlerat estetike gjithëkohore. Vlen të sillet në vëmendje pohimi i Tzvetan Todorovit në librin e tij Poetika e prozë s, ku shprehet: Njohjes së letërsisë vazhdimisht i kanosen dy rreziqe të kundërta: ose ndërtohet një teori koherente, por shterpë; ose kënaqemi së përshkruari disa "fakte" duke kujtuar se çdo gur i vogël do të hyjë në punë për të ngritur ndërtesën e madhe të shkencës. (2000: 109), që hedh dritë në të dyja aspektet, nga njëra anë në teorinë letrare, e në anën të tjetër të vetë shkencës mbi të, pra të asaj që lehtësisht emërtohet si shkencë. Në teoritë e ndryshme letrare, sidomos ato moderne, marrëdhënia me letërsinë, përfundimet më të arrira të secilit lexues, përsëri janë të varura drejtpërsëdrejti nga leximi dhe rileximi i faktologjisë letrare, si një prani që mbetet e hapur për secilën kohë dhe brez, e po kaq edhe për secilën hapësirë të letërsisë së përbotshme. Dámaso Alonso, në shqyrtimet e veta, më tepër është skeptik kundrejt mundësisë së një shkence të letërsisë, teksa nënvizon: Nëse esenca e veprës së artit dhe veprës letrare është individualiteti i saj, dhe kjo mund të njihet vetëm në mënyrë intuitive, do të lihej mënjanë njohuria shkencore, e cila konsiston në, më saktësisht, në gjetjen e ngjashmërive, në përgjithësimet dhe në krijimin e ligjeve universale. Midis këtyre tri disiplinave që merren me interpretimin e veprës letrare, ajo që mendohet si shkencë e letërsisë, me gjithë reminishencat e pranishme, mbahet dhe përjetohet si e tillë (madje shpeshherë si të qe një shkencë ekzakte në të gjitha parametrat e veta, që shpeshherë ka bërë edhe zbulime). Megjithatë, teoria letrare, teksa merret me aspektet teorike të gjinive, llojeve, zhanreve, të stilistikës etj., i përmbush disa parametra kryesore të përcaktimit të saj, së paku si një shkencë teorike.

A është shkencë kritika letrare?

Një pyetje që, formalisht dhe logjikisht, do të kërkonte qëmtime më të thelluara, larg trajtimit bardhezi, që e ndeshim shpesh në media dhe mjerisht edhe në mjediset akademike, mbi praninë ose papraninë e kritikës letrare si shkencë. Në pamje të parë, lidhur ngushtësisht me praninë e shkencës në metatekstet kritike, më tepër i bie që të rrahësh ujin në havan, sesa të rrekesh të ndërtosh kështjella prej rëre, ose kështjella pa dritare, që madje mezi komunikojnë me veten, brenda auditorëve shurdhanë. Ideja e Zherar Zhenetit: Një kritikë mund të jetë e pastër empirike, naive, e pavetëdijshme, "e egër"; një metakritikë, gjithmonë implikon "njëfarë ideje" të letërsisë dhe ky implikim nuk do mungojë gjatë kohë për t'u eksplikuar. (1985: 70) te libri Figura, duket se e lë të hapur përcaktimin e kritikës letrare, gjer në një situim që përfshin shumëçka në të, pa shmangur praninë subjektive, që të largon nga rrafshet e trajtimit shkencor. Në të gjitha rastet e mundshme, me shumë gjasa teorike dhe praktike, kritika letrare, veçmas në kohërat moderne dhe postmoderne, tashmë është thjesht dhe vetëm një reagim parak, informues dhe afirmues, ndaj botimeve bashkëkohore, me gjasë një qasje thelbësisht subjektive, që natyrisht shqiptohet përmes recensioneve përcjellëse, ose në një këndvështrim edhe më të ngushtë shpalimi. Gjithashtu, në një pikëpamje më të ngushtë, kritika letrare mund të jetë edhe një tejqyrë për të sjellë në bashkëkohësi vlerat e dikurshme, pra një rivlerësim i teksteve të mëparshme, të antikës dhe hershmërisë së shkrimit letrar. Në mes të tjerash, thotë Roland Barthesi: Kritika është vetëm një moment i kësaj historie në të cilën po hyjmë dhe e cila na shpie në njësi – në të vërtetën e shkrimit. (2008: 208) te libri Aventura Semiologjike. Ngado që ta rrotullosh gjuhën, në teoritë klasike dhe bashkëkohore, vështirë që të arrihet në përfundimin se kritika letrare është shkencë, mbase as për hije, së paku e pikëvështruar si ndërvarje në kriteret e logjikës formale.

Po historia e letërsisë a është shkencë?

Niçe, nga njëra anë, historinë që shumëkush e mendon si shkencë, ky filozof i kohëve moderne e ka emërtuar më tepër "interpretim faktesh". Për analogji formale, varësisht fuqisë së mendimit të Niçes, historia e letërsisë, me shumë gjasa i bie që të jetë "interpretim tekstesh ose veprash". Pra, më shumë kemi të bëjmë me një rrethanë mbizotëruese të vlerave estetike që leximi i veprave mbetet i hapur. Po në këtë linjë, shoqëruar me shtjellime të gjera studimore, vijon edhe Benedeto Kroçe, në pjesën më madhe të veprave dhe shqyrtimeve të tij. Përfundimet e historisë së letërsisë shqipe, bazuar kryesisht në parimet sociologjike dhe historiciste, shpien ujë në rishikimin e saj, të historisë së përjashtimeve dhe paragjykimeve, që madje shpallet me të madhe si shkenca e historisë së letërsisë, më tepër duke krijuar një ishull të mbyllur të qarkut hermetik, të një historie pa letërsi ose të një letërsie pa histori. Tashmë jemi në rrethanat e përjetimit të saj si një interpretim të periudhave dhe teksteve të secilës prej këtyre fakteve letrare, sesa si përfundime shkencore përfundimtare, që kinse janë të dhëna njëherë e përgjithmonë, që ka gjasa, po t'i marrësh seriozisht, pasi ke lexuar "shkencën" e madhe të mësimdhënësve, të mos jetë e nevojshme të lexohet më as Shekspiri:

Së pari: Varësisht rrethanave të sistemit të realizmit socialist, që me ekzistencën e vet realizon historinë e

përjashtimeve, ku u la anash gjysma e saj, në motet e sundimit të socrealizmit, sepse u përjashtuan Fishta, Konica, Skiroi, Koliqi, etj.

Së dyti: Historia e letërsisë shqipe, ndërkaq është vështruar në një pikëpamje më të ngushtuar, pra si eseistikë dhe kulturologji, çka ka bërë që në Prishtinë, koncepti shkollë letrare dhe avangardë, të shtrihet në mënyrë abuzive dhe, me mungesë të logjikës formale dhe të argumentuar, në të gjithë zhvillimin letrar, duke krijuar një keqkuptim konceptual, sa edhe Fishta dhe krijimtaria e tij letrare të përfshihet në rrjedhat e modernitetit.

Së treti: Britmat alarmuese për nevojën e shkencës letrare, madje duke synuar që shkencërimi me titujt të zëvendësojë vetë letërsinë, si dhe mendimin verifikues për të, përmes kumtesash dhe parathë niesh dhe, me marrjen e gradave shkencore me anë të monografive (ku simbas konceptit zyrtarist, mjafton ta emërtosh kështu dhe që në pak raste e përmbushin si metodikë, ke shënuar majën e shkencës mbi letërsinë), zakonisht pa libra, një tipar i dëshmuar me krenari absurde, sidomos në shtetin amë, ku secili nga "shkencëtarët" e graduar aspiron të shkruajë historinë unike të letërsisë shqipe.

Teoria letrare si konceptim shkencor

Ligjërata mbi shkencën letrare, krahasuar me dy anët e tjera, me kritikën letrare dhe historinë e letërsisë, teoria letrare anon nga shenjat e pranishme të disiplinës shkencore, e cila është e pajosur me jo pak elemente metodike dhe hulumtuese, që parashtrojnë udhën për te portat e verifikimit shkencor. Megjithatë, nga mënyra e funksionimit, në këtë rast, sërish evidentohen dy tipe teorish letrare:

- Teoritë letrare që organikisht ndjekin procesin letrar, njohin dhe zbërthejnë arritjet e letërsisë, qysh në zanafillën e vet, pavarësisht gjinive dhe shkollave të ndryshme letrare. Po kaq, përmes interpretimit të veprave apo teksteve letrare, realizojnë kodifikimin e letrares, ndërkohë sugjerojnë metodika të leximit dhe vlerësimit të letërsisë. Teoria letrare zë fill qysh me veprën Poetika të Aristotelit, që ka vënë bazat e saj, të gjinive fondamentale të letërsisë, dhe duket sikur ajo ngrehinë ka mbetur në këmbë qysh prej antikitetit dhe deri në kohët moderne. Në thellim të kësaj qasjeje teorike mbi letërsinë, janë teoritë moderne të dy shekujve të fundit, të cilat thellojnë dhe plasojnë analizat strukturore të teksteve letrare.

- Teoritë letrare që marrin përsipër ta udhëheqin letërsinë dhe ta modelojnë në varësi të nevojave letrare dhe jashtëletrare. Kështu ka ngjarë në kuptim të ngushtë me klasicizmin, që për nevojat e oborrit të monarkisë absolute, hartohet një platformë rregullash detyruese për letërsinë dhe artin. Megjithatë, ai përmbushi edhe kërkesat e letrares, në lidhje me vlerësimin e antikitetit, dhe të lënies hapur të shansit për të materializuar vlera artistike, më përtej normave fikse. Krejt ndryshe qëndron çështja me realizmin socialist, që me kriteret e shpallura jashtëletrare, të partishmërisë proletare, heroit pozitiv, tendenciozitetit klasor, me vetëdije të shpallur ideologjike, e mbylli të bukurën në kuvli. Më tepër e mbërtheu në prangat e propagandës së ideologjisë komuniste, duke e kthyer në propagandë në interes të ideologjisë së kohës. Në këtë kuptim, ata që prangosën letërsinë shqipe me atë model ideologjik, që mëkuan artin dhe letërsinë me dobinë e shërbesës ndaj sistemit, si dhe një pjesë e konsiderueshme e studiuesve të sotëm, ndonëse kanë rënë në kontakt me dijen moderne letrare, në marrëdhënie me letërsinë, sidomos me debatin për të, bartin po atë mentalitet, të rolit udhëheqës në letërsi dhe art. Letërsia, me gjinitë dhe llojet letrare, kuptohet që është e para dhe kjo nuk ka nevojë të diskutohet. Fjalët e Umberto Eco-s, te libri Si shkruaj: Tekefundja, unë duhet të shkruaja një roman fundi i të cilit – qoftë dëshpërim, pas një dështimi të çdo esteti, dhe duke i respektuar në tërësi ligjet e krijimit, të cilat janë krijuar qysh prej romanit helenistik e deri më sot, për mos thënë që prej Poetikës së Aristotelit – duhet të shkaktojë kënaqësi gjatë rrëfimit. (2003: 40). Madje ajo rrethanë zyrtare që për ditë rrekemi ta paraqesim si shkencën e letërsisë, sërish ajo që emërtohet si shkencë është thelbësisht e ndërvarur nga teksti letrar. Fatit të mbramë të shqipes, që gjendet në udhëkryqin ekzistencial më të vrazhdë të mundshëm, tashmë i shtohet edhe qasja zyrtare dhe snobiste, se nuk kemi letërsi shqipe, se ajo është në nivele të papërfillshme estetike. Pavarësisht faktit se kush e thotë, ideja duhet marrë seriozisht në analizë, madje do të duhet vështruar në të gjithë treguesit e vet, duke parë tekstet dhe kontekstet, me përqendrim të vëmendjes te vlerat letrare që bart materia e letrave shqipe. Është e vërtetë që letërsia shqipe, në shtjellat e veta, varësisht konteksteve, më tepër ka kryer funksione të dyfishta, por edhe letrare, në lavrimin e zhanreve dhe llojeve të ndryshme. Në një kuptim, në të gjitha periudhat e shkrimit, arti i fjalës, ndërkaq ka pasur më tepër ngarkesë jashtëletrare. Kuptohet që ngarkesa e këtillë jashtëletrare, ka qenë e lidhur ngushtësisht me rrethanat ekzistenciale të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Në periudhën e parë, letërsia shqipe pati barren e madhe të identifikimit të gjuhës shqipe, që hedh themelet me Mesharin e Gjon Buzukut. Periudha tjetër, që përkon me letërsinë romantike, mori përsipër që nga hiri i sundimit shumëshekullor të otomanëve, të shënonte Rilindjen e kombit, pa lënë në hije lëvrimin e letërsisë. Gjithnjë simbas studimeve zyrtare, të të gjithë anëve të shkrimit të shqipes, me veprën e Naim Frashërit dhe Jeronim De Radës, zë fill letërsia e mirëfilltë, ku padashtas krijohet një hije konceptuale, se paska edhe letërsi jo të këtillë. Megjithatë, kulmin e vet të detyrimeve jashtëletrare/ideologjike, letërsia shqipe e përjetoi në motet e realizmit socialist, kur asaj zyrtarisht iu vunë prangat e bërjes së njeriut të ri, në emër të ideologjisë komuniste.

Letërsia shqipe, ashtu si çdo letërsi tjetër, merr kuptim në varësi të tekstit dhe kontekstit, të leximit dhe vlerësimit të këtyre aspekteve, ku në fund fare mbetet vlera estetike e teksteve, që kapërcen kohën e vet, si dhe kohën e leximeve të shumëfishta. Për ta vijuar formalisht logjikën e mospasjes së letërsisë, të mungesës së vlerave në gjuhën shqipe, që për hir të së vërtetës nuk është se kemi kaq shumë vlera, por edhe krejt pa to nuk jemi. Në lidhje të ngushtë me vlerat, nuk jemi as qendra e botës, po as bishti i saj. Atëherë kur nuk paskemi letërsi, për të ecur në logjikën e nihilizmit skajor, pa u thelluar këtu në argumentet e marrëdhënies së konteksteve dhe të teksteve, çfarë nevoje kemi që të kemi katedra letërsie, ose titujmbajtës që i kanë marrë titujt me vepra të letërsisë shqiptare?!

Në vend të përfundimit

Nga njëra anë, shqiptarët e të gjitha anëve të kufirit, janë poetë e shkrimtarë të papamë, kritikë dhe eseistë të nivelit më shkencor të mundshëm, madje siç e pohojnë po vetë, gjeni që s'janë parë në shpinë të tokës. Nga ana tjetër, me parametra gjeometrikë, në mënyrë të pakthyeshme, sa vjen dhe zhduket fara e lexuesve të teksteve, jo e leximit biografik dhe hermetik, të cilët që të dy këto tipe të mosleximit të veprës letrare, të largojnë nga magjia e tekstit. Më herët, Benedeto Kroçe, në mes tjerash, theksonte: Kritikët profesorë rrallëherë zhvishen në gjykimet e veta nga përvoja e tyre si profesorë të pranishëm në provim a gjyqtarë konkursesh... (1998: 11) te libri Poezia antike dhe moderne. Edhe kur është e pranishme soji i leximtarëve, së paku nga sa shohim në media dhe nëpër institucionet e shpallura si shkencore, ky xhins mbizotërohet nga lexues të asojmë, që mjafton që të jenë mësimdhënës dhe vetvetiu janë edhe shkencëtar të mbaruar. Pohimi i T. Todorovit te libri Letërsia në rrezik, ta sqaron në dritën e diellit përjetimin e këtillë, kur shkruan: Ne – specialistët, kritikë letrarë, profesorë – në të shumtën e kohës nuk jemi gjë tjetër përveç se xhuxhë të strukur në sqetullat e viganëve. (2007: 22), duke përveçuar mjeshtrit e shkrimit letrar nga soji i leximtarëve të ndryshëm.

Ky debat, letrar në thelbin e vet, të paritetit të letërsisë apo verfifkimit shkencor mbi të, është i gjerë, me shumë hapësira konceptuale dhe, mbi të gjitha, do të kërkonte kontributin e të gjithë faktorëve të tekstit letrar, të autorit si krijues, si dhe të lexuesit të letërsisë, qoftë edhe studiues me tituj dhe fame.

IN MEMORIAM

Shuhet Lefter Çipa, *poeti i bregut*

Është ndarë nga jeta në moshën 79-vjeçare poeti Lefter Çipa. Prej më shumë se një viti, ai vuante nga një sëmundje e rëndë.

Lefter Çipa është një ndër poetët më të shquar shqiptarë në vitet 1970-2021. Autor i 18 librave të botuar me poezi dhe një kolane në proces redaktimi për botim. Shumicën e librave të këtij autori tipologjik i ka botuar Shtëpia e njohur botuese "TOENA" në Tiranë. Ndër librat më të qarkulluar të këtij autori me poezi janë : "Bejkë e bardhë", "Bilbilat e vendit tim", "Shqipëri moj ballëhapur", " Këngët e Ruzanës", "Dheun tim përsipër mbaj", "Për Kosovën prapë do të ngrihem", "Kënga që tret lotin", "Këngët e Akroqeranit","Princi i Dashurise", " Flet princi i polifonise", " Engjej te polifonise", " Vij nga drita", "Endrra neper duar", " Njerez me drite" etj.

Konsiderohet "princi i sotëm" i polifonisë shqiptarë. Autori më kreativ i polifonisë gjatë 40 viteve të fundit. Njëri prej studiuesve dhe hulumtuesve më këmbëngulës të poezisë orale popullore në trevat jugore të vendit. Autor i mbi 1250 këngësh të interpretuara nga grupet e famshme polifonike si ai i Pilurit (udhëheqës artistik i të cilit ka qenë për mbi 40 vjet, grupet polifonike të Himarës, Bënçës, Dhërmiut, Gjirokastrës, Vlorës, Lapardhasë, Ansamblit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve si dhe dhjetëra ansambleve të tjera artistike në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni etj.

Lefter Çipa konsiderohet si autori i papërsëritshëm i këngëve të vlerës së lartë artistike dhe muzikore si "Bejkë e bardhë", "Vijnë djemtë nëpër vapë", "Nga kjo baltë e kësaj toke", "Naim Shqipëria", "Shqipëri pse të qan syri", "Zoga kaçake në male", "Këngë kurbeti", "Vito Pëllumbesha", "Hënëz e qiellit të gjerë", "Moj unaza gur jeshile", "N sokak të ngushtë", "O shokë vdekça nga kënga", "Lundroj në lundrën e këngës", "Kënga e manushaqes", " Zonjë e bukurisë", etj.

Ky autor ka qënë pjesmarrës me krijimet e veta në 6 Festivale Folklorike Kombëtare të zhvilluara në Gjirokastër, Berat dhe Lezhë duke qënë i lauruar në çdo Festival Kombëtar.

Lefter Çipa ka botuar një numër të shumtë artikujsh për autorë dhe përfaqësues të shquar të letërsisë kombëtare shqiptare. Ka një arkiv të pasur me dokumente që flasin për fondin autentik të vlerave polifonike shqiptare në Bregdetin e Himarës dhe zonat e tjera arbërore. Shumica e personaliteteve më të shquara të kulturës, mendimit dhe kërkimit shkencor kulturologjik kanë përcjellë vlerësime dhe publikime të rralla vlerësuese për veprën, kontributin dhe vlerat shumëplanëshe të këtij autori dhe organizatori të shquar të veprimtarive polifonike dhe folklorike shqiptare në gjithë hapësirën.

Lefter Çipa mbahet mend si bashkëorganizatori dhe autor i teksteve te trios së famshme Vlonjate. Ai është burimi ku ushqehen shumica e këngëtarëve dhe kompozitorëve të sotëm modernë shqiptarë dhe ku shumica e këngëtarëve kanë preferuar që në repertorin e tyre të kenë të kryerenditur poezitë dhe lirikat befasuese të këtij autori.

Është nderuar me çmime dhe dekorata, ndër te cilat me me te larten "Nderi i Kombit"

NJË VLERËSIM KRITIK MBI STUDIMIN "SHPIKJA E MESJETËS: VETJA DHE TJETRI NË MEDIEVISTIKËN SHQIPTARE" TË DOAN DANIT

Fuedalizmi si "Tjetri" i shqiptarëve

Artan Hoxha Ph. D.

Studimi "Shpikja e Mesjetës: Vetja dhe Tjetri në medievistikën shqiptare" i Doan Danit i botuar në vitin 2016, paraqet mjaft interes për diskutimin që i bën historiografisë shqiptare. Kjo sprovë është pjesë e debatit që zhvillohet në Shqipërinë post-komuniste mbi identitetin e shqiptarëve dhe raportet e tyre me Europën. Në këtë punim, Dani, i frymëzuar sidomos nga medievsiti i njohur Patrick Geary, zbërthen se si studimi i Mesjetës ka shërbyer si një funksion i programit nacionalist shqiptar dhe shpikjes së identitetit. Po njëlloj si Geary, Dani kërkon të dekonstruktojë narrativat që mëtojnë vijimësinë midis europianëve modernë dhe "paraardhësve" të tyre mesjetarë. Duke e parë komb-ndërtimin në Shqipëri si një projekt intelektual thellësisht të lidhur me ndërtimin e një narrative që theksonte orientimin perëndimor të shqiptarëve, Dani shtjellon se medievistika shqiptare është përshkuar nga Orientalizmi, i kuptuar si demonizim i Perandorisë Osmane dhe minimizimi i trashëgimisë bizantine dhe ndërshkëmbimeve me fqinjët. Në këtë mënyrë, akademia, në vend që të kërkojë gjetjen e të vërtetës, ka shërbyer si një instrument politik që ka synuar të krijojë mitin e identitetit kombëtar të shqiptarëve si perëndimorë duke nxitur urrejtjen për Orientin dhe fqinjët.

Për të çmitizuar këtë narrativë, Dani arsyeton se shqiptarët nuk kanë kaluar nëpër të njëjtat procese historike si Perëndimi, e prandaj ata nuk janë perëndimorë. Një nga elementet qendrore të argumentit të tij është teza se në Shqipëri feudalizmi, të cilin Dani e identifikon si një dukuri thellësisht perëndimore, ka qenë mjaft e kufizuar. E këtu, ai përplaset edhe me historiografinë shqiptare, sipas së cilës feudalizmi ka qenë mënyra dominuese e prodhimit në formacionin social të shqiptarëve gjatë Mesjetës. Rrënjën e skemës që shqiptarizon feudalizmin, ai e gjen te marksizmi dhe adoptimin e tij prej historiografisë komuniste shqiptare. Dani, nënvizon se funksioni i feudalizmit si kategori qendrore në shkrimin e historisë ishte për t'i identifikuar shqiptarët me Perëndimin dhe për t'i ndarë ata nga fqinjët ballkanikë – objektiv ky jo edhe aq internacionalist dhe marksist. Punimi i Danit, ka meritën të jetë ndër të parat studime që ngre pikëpyetje mbi eurocentrizmin e narrativës nacionaliste të historiografisë shqiptare; kjo sprovë dëshmon se sa ngushtësisht është i lidhur shkrimi i historisë me programet politike dhe mënyra se si ne kuptojmë dhe analizojmë të shkuarën formësohet nga ligjërimet hegjemone. Gjithashtu, ai nxit studiuesit shqiptarë të mos i marrin për të mirëqena kategoritë analitike që ata përdorin dhe të mos ia nënshtrojnë atyre realitetit – gjë që ndodh rëndom.





E megjithatë, disa prej përfundimeve të Danit meritojnë një vlerësim kritik. Këtu dua të diskutoj në mënyrë të posaçme mbi konkluzionin e tij se koncepti i feudalizmit ka shërbyer për të identifikuar shqiptarët me Perëndimin dhe se kjo skemë është produkt i historiografisë marksiste. Është e vërtetë se historianët marksistë joperëndimorë e kanë përdorur nocionin e feudalizmit për t'ia përshtatur historisë së vendeve të tyre brenda skemës marksiste, sipas së cilës feudalizmi ishte një formacion social që i paraprinte kapitalizmit – gjë që argumenton për rastin kinez edhe historiani Arif Dirlik, të cilin Dani e referon. Dirlik ka argumentuar se historiografia kineze ka qenë thellësisht e ndikuar nga interesat politike të ditës. Medievistët kinezë të viteve 30-të të shekullit XX, të cilët shpesh ishin edhe politikanë, e përdorën konceptin e feudalizmit si një mjet për të integruar historinë e Kinës në metanarrativën e historisë universale të marksizmit, e cila ishte thellësisht eurocentrike. Prej viteve '80, në përputhje me objektivin e integrimit të Kinës në rrjetin kapitalist global dhe me përpjekjet e udhëheqjes së PKK-së për të gjetur një rrugë kineze të zhvillimit ekonomik, medievistët kinezë nisën të flirtonin me idenë e një feudalizmi kinez që nuk përputhej me modelin universalist marksist. Por ka edhe një pikë tjetër që Dirlik vë në dukje: në Kinë, si historianët marksistë e jomarksistë, e kanë përdorur kategorinë e feudalizmit në të njëjtën mënyrë. Madje, ai vë në dukje se qysh në vitet '30, feudalizmi ishte pjesë e rëndësishme e zhargonit politik modernizues të Guomindangut, armikut politik të komunistëve, që deklaronte se kishte për qëllim kryesor zhdukjen e feudalizmit.

Qysh në vitet '20, edhe Shqipëria ziente programe të ndryshme, ku në thelb feudalizmi trajtohej si "Tjetri" që duhej eliminuar. Ligjërime të tilla politike gëlonin në krejt Ballkanin, Itali, Spanjë dhe Turqi. Pra feudalizmi ishte armiku i modernizuesve, të cilët e konsideronin atë si burimin e të gjitha të këqijave dhe prapambetjes. Gurra ideologjike e këtyre programeve ishte diskursi të përparimit – gjë të cilën edhe Dani e përmend, por pa i dhënë rëndësinë e nevojshme për të kuptuar funksionin që feudalizmi ka luajtur në imagjinarin politik, e për rrjedhim edhe historiografik shqiptar. Në këtë kuptim, feudalizmi ka përfaqësuar prapambetjen dhe stanjacionin. Këtë kanë pohuar pa ndërprerje modernizuesit shqiptarë, spanjollë, italianë, grekë, turq, egjiptianë, indian e kinezë – dhe lista mund të vazhdojë edhe më. Në terma Levi-Strosian, për të gjithë pjesëtarët e këtij grupi, që kërkonin të nxehnin shoqëritë e tyre, feudalizmi simbolizonte shoqërinë e ftohtë.

Ndryshe nga sa pohon Dani, në ligjërimin politik dhe historiografik shqiptar, feudalizmi ka pasur gjithmonë ngjyrime negative dhe jo pozitive. Pushtimi dhe administrimi osman janë demonizuar rregullisht në historiografinë tonë jo vetëm për shkak të Orientit dhe Islamit, sikundër pretendojnë kohët e fundit

shumë dekonstruktivistë dhe çmitizues. Argumenti kryesor i vlerësimit negativ të sundimit osman ka qenë identifikimi të tij me feudalizmin. Është pikërisht kjo arsyeja pse Perandoria Osmane anatemohet në krejt Ballkanin; jo thjesht pse ajo identifikohet me Islamin, por mbi të gjitha identifikohet me prapambetjen feudale dhe shihet si rrënja e varfërisë së kombeve të siujdhesës. Një nga arsyet kryesore të stigmatizimit të Islamit ka qenë sepse ai është vlerësuar si një sistem ideologjik që nuk nxiste zhvillimin – bindje kjo tashmë gjerësisht e kritikuar. Vlerësimin që historiografia shqiptare i bën pushtimit osman është tepër i nuancuar. Ndërsa medievistët dhe osmanologët shqiptarë theksojnë se trevat shqiptare ishin në një shkallë të avancuar të feudalizmit, ata nuk thonë se ky i fundit ishte pozitiv. Përkundrazi! Nëse ka një konstante në punën e tyre është cilësimi negativ i feudalizmit. Por ata argumentojnë se përpara pushtimit osman, feudalizmi ishte në kalbëzim dhe si rrjedhojë Shqipëria po futej në rrugën e krijimit të një monarkie absolute. Pra, kishte hyrë në fazat e para të shkërmoqjes graduale të organizimit feudal dhe ky tranzicion, nëse nuk do të kishte ndodhur pushtimi osman, do të çonte më pas në kapitalizëm. Asnjë historian shqiptar nuk ka mëtuar se në shekullin XV në Shqipëri kishte filluar të shfaqej kapitalizmi. Sipas tyre, pushtimi osman ndërpreu këtë proces pasi ricikloi një feudalizëm që trevat shqiptare e kishin kapërcyer. Si pasojë e këtij pushtimi, thonë ata, kapitalizmi do të shfaqej vetëm në shekullin XIX, gjatë Rilindjes Kombëtare.

Kuptohet se narrativa nacionaliste e futur brenda skemës teleologjike marksiste dhe eurocentrike mund të kritikohet në cilindo front të mundshëm. Megjithatë, konkluzionet e saj nuk duhen shtrembëruar. Marksistët dhe jo marksistët e kanë parë feudalizmin si një formacion shoqëror që pengon zhvillimin, i ndërtuar për të ruajtur stanjacionin. Kështu, rrënja e përdorimit të feudalizmit nuk do parë te marksizmi. Fundja Marksi ishte produkt i Iluminizmit dhe e gjithë teoria e tij u frymëzua prej ideologëve të "shekullit të dritave". Marksizmi ishte produkt i shekullit XIX i cili mbarte vulën e epokës ku progresi fetishizohej dhe gjithçka që e pengonte atë demonizohej. Kuptohet që përdorimi i feudalizmit si nocion themelor në periodizimin historik e integronte historinë e Shqipërisë në historinë e Europës perëndimore, por kjo ishte më tepër një rrjedhojë se sa objektivi kryesor i historianëve, intelektualëve dhe politikanëve shqiptarë. Për ta, qëllimi kryesor ishte zhvillimi i Shqipërisë, që jo pa të drejtë, e kanë parë nga modelet shekullare dhe laike europiane. Në dy shekujt e fundit, asnjë vend jo europian nuk ka arritur të faktorizohet pa përvetësuar arritjet e qytetërimit modern industrial të zhvilluara në hapësirën e Atllantikut të veriut – pjesë e të cilit ka qenë edhe sistemi sovjetik. Kundërshtarët e këtyre transformimeve janë ngritur pikërisht kundër arritjeve të Iluminizmit dhe shekullarizimit. Nën flamurin e rebelimit të dhunës së modernitetit, ata mundohen të esencializojnë Europën dhe ta identifikojnë atë vetëm me racizmin dhe imperializmin.

Të kërkojmë të kuptojmë të shkuarën dhe ta çlirojmë atë nga gjuha e urrejtjes është një gjë dhe të kërkojmë revansh nëpërmjet viktimizimit historik është një gjë krejt tjetër – praktikisht është të krijosh një gjuhë tjetër urrejtje. Emancipimi i historisë shqiptare dhe rehabilitimi i zërave të shtypur nuk vjen duke kaluar nga euroteizmi në orientoteizëm; apo në viktimizimin e Orientit, që shfaqet gjithnjë e më shumë së fundmi në Shqipëri. Ndërsa të gjithë merren me Orientalizmin, stigmatizimin e Lindjes prej Perëndimit, askush nuk diskuton dhe dekonstrukton të anasjellën: ligjërimin antiperëndimor dhe mitet e tij në vendet e Azisë dhe Afrikës. Ndoshta ka ardhur koha të studiohet edhe në Shqipëri. Shembujt për këtë nuk mungojnë.

Ende vepra e Gjergj Pekmezit lëkundet mes njohjes dhe mosnjohjes. Figura e tij çmohet në tërësi, pa hyrë në detaje, ku shpaloset vlera e vërtetë. Mungon përmbledhja e plotë si gjuhëtar, mësues, studiues, atdhetar, diplomat.

Shpërfillja e Gjergj Pekmezit

Nga Istref Haxhillari

Në analet e kulturës pogradecare me shtresëzim të gjerë gjerdanit kombëtar, doktor Pekmezi zë vend të dorës së parë. Ndihmesa e tij në shërbim të çështjes shqiptare është e shumanshme.

Përkthyesi i komisionit ndërkombëtar për caktimin e kufijve, themeluesi i shoqërisë kulturore "Dija" dhe publikuesi i memorandumit drejtuar Kongresit të Berlinit, e përdori misionin e konsullit të nderit në Austri për të mbledhur arkivave të Vjenës mbi tetëmijë faqe të shtypura, ku zbulohen makinacionet e fuqive të mëdha për pavarësinë e Shqipërisë në harkun kohor 1871-1894.

Gjatë viteve të qëndrimit në Austri përshtati "Bleta shqiptare" të Thimi Mitkos dhe publikoi studimin shkencor "Gramatika e gjuhës shqipe", e para vepër shkencore nga e cila morën shtysë gjuhëtarët pasardhës. Dy vjet më vonë nxori në dritë punimin e rëndë "Bibliografia shqipe" dhe në vazhdim "Libër mësimi e leximi i shqipes" shoqëruar me një fjalor ndihmës shqip-gjermanisht.

Në detyrën e kryetarit të "Komësisë letrare shqipe" për alfabetin e Manastirit së bashku me albanologun Nahti Gali dhe Ndre Mjedën studioi të folmen e Elbasanit që kulmoi me studimin "Përkujtime mbi çështjen e një gjuhe të përbashkët shqipe".

Dijetari ynë do të krijonte shtratin gjermano - austriak për të tjerë dijetarë, që e ndoqën në vitet e më pastajmë, midis tyre Lasgush Poradeci dhe Eqerem Çabej. Nuk është e rastit që albanologët më të shquar qenë dijetarët gjermanë e austriakë të nxitur nga punimet e tij. Botimet e Pekmezit u bënë në gjuhën gjermane, jo pse atë e njihte në mënyrë të përkryer, porse donte t'i drejtohej publikut të gjerë e të kulturuar evropian për të kuptuar në tërësinë e vet xhevahirin e harruar e të pluhurosur të shqipes, ndër më të vjetrat gjuhë të Evropës.

Si përkthyes i komisionit ndërkombëtar për caktimin e kufijve, mbetet i unik akti i hedhjes së monedhave një turme fëmijësh në Korçë, të udhëzuar e paguar të flisnin greqisht për t'u treguar të huajve se ato troje nuk ishin shqiptare. Kur po mblidhnin monedhat e Gjergjit, fëmijët harruan porosinë e të huajve dhe zunë të shanin shqip njëri - tjetrin.

Ç'mund të bënte më shumë një personalitet i ditur i kohës?

Si një çudi e pa kuptuar, vepra e Gjergj Pekmezit lëkundet mes njohjes dhe mosnjohjes. Figura e tij çmohet në tërësi, pa hyrë në detaje, ku shpaloset vlera e vërtetë. Ende mungon përmbledhja e plotë si gjuhëtar, mësues, studiues, atdhetar, diplomat. Shpresoj se një ditë gjuhëtarët do të merren seriozisht me këtë vepër madhore që do të nderonte edhe më të mirin studiues të kohës së sotme...

Një dimension disi i panjohur i Pekmezit, është ai i mësuesit të gjuhës shqipe në trevat malore të Pogradecit. Pasi mbaroi arsimin fillor dhe tre vite të mesme, ndërpreu përkohësisht studimet. Ishte viti 1887, kur merr rrugën e gjatë e të vështirë për të dhënë mësim në shkollat e para shqipe të krahinës së Mokrës. Vetëm pak muaj pas çeljes së mësonjëtores në qytetin e Korçës, do të sillte për nxënësit e Llëngës libra në gjuhën amtare me alfabetin e Sami Frashërit. Por sa i çuditur mbeti kur aty, mes maleve, hasi abetare shqip, futur fshehur nga patriotët shumë kohë më parë!

A ishte e rastit surpriza e këndshme në atë mëngë të largët të vendit?

Natyrisht jo.

Përgjatë vijës Egnatia, krahas Voskopojës, Shipckës dhe Grabovës, Llënga njihet ndër vendbanimet më të hershme. Në fund të shekullit të gjashtëmbëdhjetë radhitej nga më të mëdhatë e qytezave të sanxhakut të Ohrit. Viteve që erdhën popullsia u mpak nga shpërnguljet për shkak të taksave që i detyronin të përqafonin fenë islame, po largimet nuk reshtën dëshirën e banorëve të mbetur për të mësuar gjuhën.

Adoleshenti i rritur në mjedis të kulturuar, inteligjent prej natyre, iu përkushtua me tërë energjinë e moshës këtij misioni të panjohur. Mjedisi pjellor i dha mundësinë të shpalosë aftësitë e fshehta mësimdhënëse. Në mungesë të programeve të mirëfillta krijoi sistemin e vet ku vendin e parë e zinte nxënia e shkrimit e këndimit shqip, pastaj aritmetika, historia e Shqipërisë, gjeografia... shpesh i ndodhte të harrohej pas tingëllimës së gjuhës sonë, maleve e fushave, bëmave të të parëve nëpër rrjedhat e historisë.

Nxënësit ishin gjithfarësh, nga mosha e njomë tek burrat e pjekur dhe gratë duarlyer me brumin e bukës. Vinin me nxitim të dëgjonin magjinë e gjuhës shqipe shpalosur nga ky çunak që s'ta mbushte edhe aq syrin. Për shkak të numrit të kufizuar të nxënësve, e shtoi punën si mësues shëtitës nëpër fshatra të tjerë.

Përmbi Llëngë, shpella e famshme e Nikës, limer i përhershëm i komitëve të Shahin Matrakut e Tun Kokoneshit, u bë ndër klasat e shumta të mësimit. Burrave që kishin lënë shtëpi e katandi mësuesi i ri u shpjegonte nevojën e bashkimit për të larguar turkun e grekun, për të shmangur copëtimin e atdheut.

Falë aftësisë për t'u futur pa droje në shtëpitë e thjeshta fshatare, u afrua me të gjithë. Gjeti në atë vend me hire natyrore mbresëlënëse njerëz të mençur, të dashur e të dhembshur që iu bënë prindër të dytë. Mësuesi nga qyteti u bë mik i burrave që e deshën si askush tjetër rioshin gojëmbël.

Fjalët e tij mbetën në mendjen e tyre duke kapërcyer kohën nga njëri brez tek tjetri...

Në vitet tetëdhjetë të shekullit të shkuar një burrë i vjetër nga fisi i Kokoneshëve më tha se në Mokër ka qenë Skënderbeu kur nisi të bëjë Arbërinë.

- Nga e ke dëgjuar? - e pyeta.

- Ia ka thënë tim ati Gjergji, - ma ktheu, po nuk dinte të shtonte më shumë.

Edhe më vonë kam dëgjuar banorë të këtyre anëve t'i referoheshin kur përmendnin ndonjë gjë të mençur:

"Kështu ka thënë Gjergji".

I pavëmendshëm atëherë, nuk u vura rëndësi. Vonë mësova se në mjegullinën e kohës shkëlqente emri i mësuesit të ditur, ngulitur në kujtesën e njerëzve. Llënga, pastaj Mokra e tërë, u bënë shkolla e parë ku zë fill gjuhëtari, historiani, atdhetari dhe mendimtari i ardhshëm. Aty mblodhi gjuhën e virgjër të vendasve, zakonet e mira e të liga, virtytet dhe veset, ritet në gëzime e hidhërime.

Si makinë e kurdisur për punë regjistroi gjithçka.

Mokra dhe Gjergji i dhanë njëri-tjetrit ç'mundën e ç'dinin, më shumë se çdo gjë shpirtin e kulluar si vetë trojet e vendit. Mësuesi u largua, ngjiti me shpejtësi shkallët e dijes dhe u bë burri që i shërbeu si rrallë tjetër vendit. Njerëzia zënë me punët e përditshme nuk e dinin, po brez pas brezi e kujtuan djalin që pat qenë njëherë e një kohë atyre anëve. Në kuvende burrash të menduar për hallet e vendit, dëgjohej shpesh referenca:

"Siç thoshte Gjergji...".

Mbresa nga dy librat e rinj të Xhevat Beqarajt "Rruazat e vesës" dhe "Me një dallëndyshe", botoi Ombra GVG, Tiranë, 2005 dhe 2017

KËNAQËSIA ME ARTIN E PËRKRYER

Xhevat SYLA

Në njërin nga panairet e librit të Tiranës, në stendën e botimeve të Shtëpisë botuese Ombra GVG më ndodhi befasia e radhës, e këndshme, që lidhet me krijimtarinë e Xhevat Beqarajt. Aty gjeta libër të tij të ri, "Rruzat e vesës", titull që mund të ishte gjetje vetëm e një poeti si ai. Edhe u befasova këndshëm, edhe u gëzova shumë.

Libri "Rruazat e vesës" i Xhevat Beqarajt më gëzoi jo vetëm mua, por edhe dashamirësit e tjerë të poezisë për fëmijë, të gjithë ata që moti janë mësuar të kënaqen me çiltërinë, butësinë dhe bukurinë e ligjërimit poetik të këtij poeti. Kur e mora në dorë këtë libër me një ballinë shumë artistike të piktorit dhe botuesit Gëzim Tafa, edhe unë, sigurisht si edhe dashamirësit e tjerë të poezisë për fëmijë, isha kureshtarë të kuptoja çfarë përmbante ky libër që na vjen disa vjet pas botimit të librave më të fundit të këtij autori. Vjersha të reja? Mbase më parë do të mund të prisja ndonjë zgjedhje nga librat e mëparshëm. Por jo. Libri ishte me vjersha e poema të reja, të cilat kishin edhe datat e krijimit. Nga datat e krijimit të vjershave, madje të një intervali të gjatë kohor, që nga fillmet e krijimtarisë letrare të autorit e deri në ditët tona, nuk mund të kuptoje menjëherë nëse ato vjersha ishin të reja, të papërfshira në librat e botuar më parë, apo ishin krijime të cilave tek tani ua kishte dhënë "vizën" për botim autori. Sidoqoftë, vjershat që i gjeta aty nuk i kujtoja nga librat e mëparshëm, por edhe ato më tërqethën me bukurinë e tyre, madje më lumturuan shumë. Më kthyen në kënaqësitë që i kisha përjetuar si fëmijë me poezitë e këtij poeti të mrekullueshëm. Por çfarë kemi në këto poezi? Çfarë do të mund të na sjellë tani poeti Xhevat Beqaraj me gjithë atë përvojë të akumuluar dhe me gjithë atë mjeshtëri të arritur? Deri ku mund të arrijë mjeshtëria dhe bukuria e krijimt poetik?

Këtë gëzim dhe këtë befasi mund të them se e ndjeva fuqishëm, meqë kur kisha shkruar librin monografik për poezinë e Xhevat Beqarajt "Harmonika e atdheut", kisha menduar se kisha bërë një trajtim të gjithë asaj që na kishte dhuruar deri atëherë ky poet, i cili shkëlqeu dhe ngel të shkëlqejë përjetësisht në qiellin tonë poetik për fëmijë. Prandaj befasia e këndshme dhe gëzimi mund të jenë të kuptueshme kur në stendën e botuesit të përmendur gjeta libër të ri të tij. E ky, tash? – sikur pata shqiptuar më vete pyetjen ende pa e hapur kopertinën e librit. Çfarë na sjell? Dhe, me të shfletuar librin, pa u ndalur ende veçmas në ndonjë vjershë, kuptova se libri më i ri i Xhevat Beqarajt na vinte një sajim i bukur me poezi të shkruara më herët, por edhe të kohës më të re, me poezi të cilat nuk i kshin hyrë në konceptimet apo ndërtimet e librave të mëparshëm, apo për shkak se ndonjë poezi i kishte ngelur ide e papërfunduar e të cilës i ishte kthyer më vonë, apo edhe për arsye të tjera. Megjithatë, "Rruazat e vesës" na erdhi libër i ri me poezi e poema për fëmijë i mjeshtërit i cili i gëzoi fëmijët dhe dashamirësit e poezisë për fëmijë më shumë se pesë decenie me radhë. I ngjashëm më qe përjetimi edhe në Panairin e libritt të vitit 2017 në Tiranë, kur në po të njëjtën stendë gjeta e librin tjetër të ri të Xhevat Beqarajt "Me një dallëndyshe".

Në librat më të rinj të Xhevat Beqarajt"Rruazat e vesës" dhe "Me një dallëndyshe" gjejmë vjersha që mund të cilësohen edhe për fëmijë, edhe për të rinj, madje disa mund të themi se janë edhe për të rritur. Edhe kjo mund të jetë arsyeja përse vlera kaq cilësore të kenë ngelur të papërfshira në librat e mëhershëm për fëmijë të këtij poeti. E këtillë është, për shembull, vjersha "Eja nënë" , e shkruar më 1967, që është një përkushtim i fuqishëm nënës. Ose vjersha "Me gjyshen" , në të cilën kemi një kuvendim të nipit me gjyshen, përkatësisht shpalosjen e dy botëve, asaj të rritur në injorancë dhe asaj që ka përqafuar të renë, diturinë. Gjyshes nuk i pëlqen kur i biri i thotë atë që ka mësuar në shkollë, se toka rrotullohet e bashkë me të rrotullohemi edhe ne me detin, me malet e me diellin, me hënën e yjet, madje dhe me shtëpinë e shtratin ku flemë. Këto janë konstatime shkencore larg mundësive t'i kuptojë gjyshja, ndaj i thotë të birit: T'i nër gjynahe mos hyr', bir! Vjersha ka vit të të shkruarit vitin 1963, kohën kur në realitetin shqiptar kishim më shumë gjyshe e gjyshër, të cilët nuk i kishin as mund t'i kuptonin këto njohuri.

Vjersha "Eja nënë", por edhe disa poezi të tjera të këtyre dy vëllimeve janë krijuar atëherë kur mbase poeti ende nuk ishte krejtësisht i profilizuar si poet i mirëfilltë për fëmijë dhe kur poezia i lind më shumë si një çlirim i shpirtit, pa atë ngarkesën që do ta imponojë dedikimi moshës së më të vegjëlve. Si të këtilla, këto krijime vijnë si perceptime apo si përjetime të subjektit krijues më të rritur, ndaj edhe do t'u takojnë si dedikim të rinjve apo mbase edhe të rriturve. Ndryshe, si të kuptohet frymëzimi aq i fuqishëm dhe shprehja e mallit që "djegërka si zjarr" për nënën e humbur, përveçse si ndjenjë e një djaloshi të rritur që spikat aq fuqishëm zbrazëtinë që ndien:

Ka mbetur llambëza pa fshirë,
U vyshkën lulet në dritare,
Dhe fqinjët më nuk duken fare,
Që kur na le, moj nën' e mirë.

Subjekti krijues, përkatësisht narratori apo personazhi i vjershës këtu na del i një moshe më të rritur, me një ndjenjë e përjetim më të fuqishëm, por edhe me një liri më të madhe të shprehjes se sa që e gjejmë në librat e parë me poezi për fëmijë të Xhevat Beqarajt. Kjo flet për faktin se Xhevat Beqaraj, që në fillimet e krijimtarisë së tij shkruan poezi që u dedikohen edhe fëmijëve por edhe të rinjve, pra krijon poezi për fëmijë dhe të rinj, term ky që zuri të përdoret edhe në letërsinë tonë për fëmijë. Të ngjashme i kemi edhe krijimet e disa poetëve të tjerë, si Vehbi Kikaj me vjershën "Ti dëborë ke mbuluar shtigjet" apo shumë poezi të librave më të fundit të Agim Devës, në të cilat nëpërmjet përjetimeve aq të fuqishme paraqitet gjendja sociale e personazheve të ndryshme. Për dallim nga këta poetë të mirëfilltë dhe të shquar për fëmijë, te Xhevat Beqaraj këtë qasje e kemi në fillimet e krijimtarisë së tij, ndaj kjo mund të ketë qenë edhe arsyeja pse disa krijime kanë qëndruar më gjatë në sirtarët e tij dhe nuk janë përfshirë në librat e botuar më parë

Ndërkaq, kur të lexosh poezinë "Të kemi pritur", që i kushtohet pranverës, e në fund të saj sheh vitin kur është shkruar, 1962, poetin Xhevat Beqraraj nuk ka si ta përjetosh ndryshe përveçse një gurrë të çiltër, e cila asnjëherë nuk paska pushuar së dhuruari margatiritarët më të mirë. Dihet se Xhevat Beqaraj e pushtoi lexuesin me gjithë atë që i pati dhuruar atij me përmbledhjet e mëparshme, por del se tek ai paskan mbetur edhe shumë vlera të tjera të çmueshme, të cilat po të shpërfaqeshin në atë kohë, do të na e jepnin atë në një petk poetik edhe më të përkryer, me depërtime edhe më të thella dhe me një gamë edhe më të gjerë dhe më interesante tematike e motivore.

Vjershat me data të hershme të shkrimit mbase mund të kenë edhe arsye të tjera përse nuk janë përfshirë në përmbledhjet e mëhershme të këtij autori. Për shembull, duke përë portretizimin e gjelit, poeti shkruan: Nga gjumi përditë na zgjon, / Se kush tjetër po këndon?!" , që do të mund të kutohej se në realitetin që paraqet vjersha nuk këndoka askush tjetër përveç gjelit! Ndryshe, pse të mos jetë përfshirë kjo vjershë e bukur në librat e mëparshëm?!

Vënia e vitit të krijimit të vjershave në fund të tyre flet edhe për faktin se poetit ndonjëherë i duhet më shumë kohë për ta rrumbullakësuar idenë, për ta përfunduar krijimin e vet poetik. Për këtë vjersha e gjatë "Për vete, ti, na bëre det" ka dy vite të shënuara në fund, 1968 dhe 1990, dhe hapësirën kohore prej 22 vitesh sa do të ketë qëndruar ky krijim i pambaruar, i cili më në fund, falë disponimit dhe kohës që do të gjejë poeti, arrin të na japë në formë të përkryer shëtitjen e fëmijëve me kapitenin e anijes detit të gjerë. Aq shumë vjet i janë dashur poetit për ta mbaruar vjershën? Jo, ai nuk do të ketë punuar në të më gjatë se në vjershat e tjera, por është në natyrën e krijimit poetik që ai të ketë një nxitje apo një frymëzim për të lindur, por njëherësh të ketë edhe kohën tjetër në disponim për ta redaktuar deri ne realizimin final i cili do ta kënaqë autorin në radhë të parë. Krijuesit ndonjëherë i nevojitet më pak e ndonjëherë më shumë kohë. Madje do të ketë edhe frymëzime apo ide të cilat nuk arrijnë të rrumbullakësohen kurrë. Ngelin peng në zemrën e shkrimtarit. Librat më të rinj "Rruazat e vesës" dhe "Me një dallëndyshe" na bëjnë të kuptojmë se poeti Xhevat Beqaraj nuk do të ketë lënë pengje të tilla. Me durimin e krijuesit të lindur, por edhe të mjeshtrit të përkryer, ai arrin të na dhurojë krijime të një cilësie të rrallë artsitike. Poezitë e dy vëllimeve më të reja të Xhevat Beqarajt janë të krijuara që nga fillimet e tij letrare e deri në kohën më të re, por që kanë jetuar më gjatë në "arkivin" e tij poetik.

Temën e punës Xhevat Beqaraj e trajton që në krijimet e fillimeve letrare. Madje, sa i përket mënyrës si e paraqet atë, nuk vërehet ndonjë dallim nga mënyra si kanë shkruar rilindësit tanë. Kemi raste kur personazhet janë të njëjtë apo të ngjashëm. Dialogu i poetit më zogun që vjen të kërkojë ushqime duke shpupurishur borës është i gjallë, i sinqertë, shumë dashamirës, sado që për përtacinë e zogut, meqë nuk kishte punuar kur ishte koha, ai nuk ngurron të përdorë edhe fjalë ofenduese, duke e kritikuar pse nuk ka punuar edhe ai si mlilingona e vyeshme:

Pse, s'erdhe verës, budallë,
Të mblidhje grurë n'arat tona,
Siç vinte mblidhte milingona.
Ndër mend për dimrin nuk të ra?

Edhe poezitë që kanë motiv punën, por edhe ato të motiveve të tjera vijnë si preokupime edhe të shkrimtarëve pararendës, para së gjithash të rilindësve tanë, të cilët çelën hullitë e para në krijimtarinë tonë poetike për fëmijë. Poeti frymëzohet nga bota që e rrethon, nga stinët dhe ndërrimet që ndodhin në natyrë, nga zogjtë e shpendët e tjerë, nga bota faunale, përgjithësisht nga jeta që bëjnë fëmijët, por edhe qeniet e tjera. Të tilla janë poezitë "Çezmat e Tanës" (1959), Pse s'erdhe verës, zog" (1966), Gjer në pranverë, lamtumirë" (1964), Palmë, mos m'u brengos" (1963) etj.

Natyra në poezitë e Xhevat Beqarajt dhe çdo gjë që e bën atë, pra që jeton në të është e gjallë, lind, rritet, zhvillohet; ka ndjenja, e ndien dhembjen, dashurinë, mallin, mallëngjimin. Krejt sikurse qeniet njerëzore. Kjo arrihet falë figuracionit të pasur e të gjetur me invencion, metaforave, krahasimeve, epiteteve, simboleve etj.

Në një ambient të pastër, që i karakterizonte dikur shumicën e vendbanimeve, ndryshimet në natyrë janë vërejtur më së shumti në stinën e pranverës dhe të vjeshtës. Shenja të këtyre ndryshimeve kanë qenë kryesisht zogjtë shtegtarë, të cilët pranverën e bënin aq të bukur dhe aq shumë krijonin zbrazëti në vjeshtë, kur ua mësynin viseve të ngrohta. Këto kanë qenë frymëzime për shumë poetë, prandaj edhe për Xhevat Beqarajn. Por këngëtimi poetik i këtij poeti për zogjtë shtegtarë është më i veçantë. Vërtitjen e zogjve dhe cicërimat në fluturim para se të nisen për në vise të ngrohta, ai i përjeton si mërzitje apo përtesë të tyre të ikin:

Vajtueshëm zogjtë cicërojnë,
O, o, mërgimin nuk e dashkan.
Ja, sipër nesh, po vijnë e shkojnë,
Bo-bo, sa mall e fjalë paskan.

Ç'na thoni vall', kur cicëroni,
Ne s'ju kuptojmë zogj të mirë.
Mos, ndoshta doni të na thoni:
Gjer në pranverë... lamtumirë!

Duke i lexuar poezitë e këtyre vëllimeve, ndonjëherë fitohet përshtypja se ndonjë poezi nuk është përfshirë në librat e mëparshëm për faktin se autori do të ketë dëshiruar t'i kthehet për ta përpunuar, për të shtuar ndonjë varg a ndonjë strofë apo për t'i dhënë formë përfundimtare. Për shembull, një përshtypje të këtillë lë poezia "Kur ikën dimri" , e cila ka vetëm një strofë:

Derdh bora lotët, dëshpërohet
E nxihet porsi baltë.
Njerëzit për të më s'kujtohen,
Duan diellin e artë.

Mirëpo edhe vetëm me këto katër vargje vjersha qëndron. Lexuesit i krijon një imazh interesant të atmosferës në përfundim të dimrit, ndaj sado që vjersha mund të ketë pritur në sirtar të autorit që t'i kthehet, eventualisht ta plotësojë, t'i japë një kuptim më të thellë e ndoshta edhe një mesazh, në fund poeti do të jetë pajtuar që ajo të qëndrojë edhe kështu, si një strofë e vetme, si një përshkrim i bukur artistik.

Kjo, siç theksuam, shihet bukur në vjershën e fillimeve të krijimtarisë letrare të Xhevat Beqarajt "Të kemi pritur" e vitit 1962, të cilën ia kushton stinës së pranverës, e me të cilën e hap vëllimin "Me një dallëndyshe". Kjo vjershë është shkruar, nuk jam i sigurt nëse edhe është botuar, qysh para botimit të librit të parë të autorit (1965) dhe për çudi, edhe me vlerat e jashtëzakonshme që ka, nuk është përfshirë në librat me poezi për fëmijë të tij të botuar gjatë viteve '60, '70 e '80 të shekullit të kaluar, e madje as në librat e vitit 2000. Pse, athua? A mos është shkaku se vjersha nuk ka mundur të inkorporohet në strukturën e vjershave me të cilat i sajoi ai ata libra, apo se nuk i është përshtatur butësisë, por edhe temave e motiveve "të lehta" që trajtohen në to, apo mund të ketë qenë shkak edhe mundësia që ndonjë varg a strofë të kenë mundur të asocojnë në çështje e probleme të cilave u rrinte kujdestar syri përherë zgjuar i pushtetit, si p.sh.vargjet:"Të kemi pritur, moj pranverë,/Mërgimit të na vish". Ose, a mos kjo pranverë për të cilën shkruan poeti ka mundur të kuptohet edhe si diçka që në ato kushte e rrethana as ka guxuar të ëndërrohet apo mendohet – liria. Si do të mund të interpretoheshin në ato rrethana, bie fjala, vargjet:

Pranverën lepurushi e ndien,
Shkundet, larg strofkës ikën,
Fushash loz, kopshtesh, hop... kërcen,
Sikur s'e njeh më frikën.

Dhe qeni kolibën e lë
E merr përjashta vrap,
Të ngrohë putrat në shullë.
Pranvera erdhi prapë.

Atdheu është tema apo motivi që e gjejmë të trajtuar në më shumë poezi të Xhevat Beqarajt. E kujtojmë vjershën "Shqipëri, moj nënë", nga libri "Treni ynë", botuar më 1967, përafërsisht në të njëjën kohë kur është shkruar edhe poezia "Në muze" (1967), e cila ta kujton atmosferën e poemës së Ismail Kadaresë "Në muzeun e armëve" . Mirëpo derisa te poema e Kadaresë armët që ekspozohen në muze rrëfejnë, te vjersha e Xhevat Beqarajt shpata rri në muze, nuk ka gojë të rrëfejë për fitoret e saj me Skënderbeun. Pikërisht shpata e Skënderbeut, e cila vizitohet nga nxënësit, përjetohet simbol i luftës për lirinë e atdheut. Në atmosferën e rëndë që imponon meditimi në muze, vizitorët puthin shpatën:

O sa flet heshtja në muze!
Mësuesja jonë ballin rrudh,
Pastaj përulet, shpatën puth.
E puthim shpatën edhe ne.

E ndiejmë pranë Skënderbenë,
Si hij' e tij rreth shpatës bredh;
Si gjyshi mirë ne na mbledh
E zemrat ndez për mëmëdhenë.

Arsyen përse disa vjersha të Xhevat Beqarajt, ndonëse të shkruara shumë më herët, nuk janë përfshirë në librat e mëhershëm të tij, por u botuan tani vonë në librat e tij më të ri mund ta shohim në asociacionet që do të mund të kishin zgjuar disa vjersha e vargje në sistemin komunist në të cilin Shqipëria jetoi gati gjysmë shekulli. Në vjershën "Shqiponja" të poemës "Kopshti që mbledh kureshtarë" , kopshti ruhet dhe rregulli mbahet nga "policët vetullvrenjtur". Shpendin e bukur emblematik të shqiptarëve e gjejmë në kafaz, në burg, mbrenda telave, siç mbahen rëndom të gjitha shtazët e kopshteve zoologjike, mirëpo duke e përjetuar këtë mbyllje e mërzitje rëndë, deri në çmenduri. Merre me mend të botohej kjo poezi në kohën kur është shkruar, fillimi i viteve '80 të shekullit të kaluar! Me çfarë llupe do të shikohej dhe ku do të mund të ishte katandisur poeti i urtë, i dashur, me poezitë aq të gjalla, plot art e mendim? Këtu gjejmë, pra, edhe një arsye të fortë e të shëndoshë përse disa krijime të librave më të rinj të Xhevat Beqarajt nuk janë botuar kur janë shkruar, përse do të kenë ngelur të papërfshira në librat e atëhershëm këta xhevahirë poetikë.

Në vjershën "Majmunët" , që i kushtohet banorëve të këtij kopshti, kemi një tablo të gjallë që shohin sytë e vizitorëve të shumtë: majmunin e vogël që varet me bisht, majmuneshën që rend pas të birit duke u kacavjerrur nëpër drurë, pastaj majmunin plak që me dhëmballët gjysmërënë provon ta çajë një kokërr arre. Këtu kemi edhe vizitorët që shkrihen së qeshuri duke parë lëvizjet e familjes së majmunëve.

Poemat e Xhevat Beqarajt janë rrëfime më të gjata poetike, me gjetje interesante tematike dhe me një denduri figurative për lakmi. Në to ka më shumë përshkrime dhe më shumë personazhe që përshkruhen. Poeti, duke shkruar për prirjen e Suzanës të këndojë, nëpërmjet meditimeve të lexuesve përpiqet ta udhëzojë atë për çfarë të këndojë, në radhë të parë për njerëzit e dashur, për babin, mamin, gjyshen e gjyshin, për motrën e vogël dhe për shumë të tjerë, por edhe për pulëbardhat, ylberin, vjollcën, shiun, thëllëzen, abetaren, sorkadhen e bukur, kërpudhat në pyll, luleshtrydhet, mjegullën, liqenin e kaltër, zgalemin, yjet, duke e ftuar në fund që të këndojnë bashkë:

Po këngën më të bukur,
Në mundshim për ta thënë,
Do ta këndojmë bashkë
Për Shqipërinë nënë.

I kthehet kështu leitmotivit të tij në pozitë patriotike-atdhetare, që e gjejmë që në librat e parë të tij, ku ai Shqipërinë e identifikon me nënën, njeriun më të dashur jo vetëm të lexuesve të vet.

Personazhi i poemës "Me një ëndërr nëpër botë", Sokoli, bën një udhëtim interesant me anije detit të pafund, duke mbrritur në shumë vende e kontinente, si në Afrikë, te piramidat, në Indi, Australi, Amerikë, Arktik etj., dhe duke i paraqitur ato me gjallëri me veçoritë e tyre. Ja si shkruan për Indinë:



Rri si saç mbi kokë dielli,
Vapa të zë frymën,
Nuk e njeh mali dëborën,
Fusha s'e njeh brymën.
Ti mundesh dhe pa çarçaf,
Të flesh natën jashtë,
Dhe netët i ke të ngrohta,
Moj, Indi e lashtë.

Nga ky udhëtim interesant në ëndërr, Sokoli zgjohet derisa zë të ndjekë një sorkadhe nëpër xhungël. Krejt në fund të poemës, poeti jep edhe një përshkrim të personazhit, në mbarim të klasës së parë, me dëshirën të bëhet marinar, por edhe u drejtohet lexuesve me mundësinë që edhe ata të ëndërrojnë sikurse personazhi i poemës. Ngjashëm bëhet edhe organizimi i poemës "Tregim për Cac Ngacin" , një nxënës që nuk i le dy gurë bashkë. Në fillim bëhet portretizimi i tij e pastaj jepen prapësitë që ai bën kahdo që sillet. Poema ka një përfundim interesant: derisa Caci mbështet kokën në prehrin e gjyshes, poeti e përfundon poemën me vetëm një pyetje: I penduar? Kësaj pyetjeje mbetet t'i përgjigjen lexuesit me supozimet e veta.

ARTI I PËRKRYER

Poeti Xhevat Beqaraj përdor kryesisht kornizat e njohura metrike të ndërtimt të vargjeve dhe strofave, mirëpo mjeshtëria e vargnimit ndonjëherë shfaqet edhe me disa forma të çrregullta, por bukur. Ai nuk njeh as duron shabllone. Ka një liri të theksuar si në përzgjedhjen e trajtimin e temave e motiveve, ashtu edhe në realizimin artistik të tyre. Kjo flet se përdorimi mjeshtëror i gjuhës, loja me fjalë e shprehje dhe shkathtësia stilistike japin efekte mahnitëse estetike:

Era, duke lozur, borën
Përpara shtyn.
Nën pelerinën e bardhë
Pylli nuk merr frymë.

Këtë përjetim estetik e jep përshkrimi i pamjeve të rëndomta, i fuqizuar aq bukur me figuracionin e gjetur: pylli veshur me pelerinë të bardhë, përshkrim ky që kulmin e shprehjes artistike e arrin me vargun "Pylli nuk merr frymë".

Ngjashëm poeti do të shprehet edhe në vjershat për pyllin, ku, duke përshkruar rënien e pyllit në gjumë, shkruan:

Mbrëmja me dorën e butë
Mbyll portat e ditës.
Edhe gjuhëz e gjinkallës
U tulat prej frikës.
Si e lodhur, dhe puhiza
Nëpër lule fle.
Tani as gjethet, as bari
S'fërfëllijnë më.

Një vlerë të veçantë në poezinë e Xhevat Beqarajt paraqet gjuha, fjalët e reja, kompozitat interesante, fjalët si vendrojë, çafkat klithmëtare, mëngëpërveshur, mjamuni i vogël motak, dhëmballët gjysmërënë, ëndrrat këmbëshpejta, vesëlarë, vesëndritur, ujëmekur, gjysmëzgjuar, gjysmëfjetur, vetullvrenjtur etj., ose shkrimi dhe shqiptimi i fjalëve në trajtë tjetër për shkak të rimës apo ritmit që duhet të arrijë vjersha, si fërtymë për furtunë e të ngjashme. Pastaj përshkrimet interesante si: lejlejku që si i dënuar qëndron me një këmbë, bishti i fazanit pendëndritur paraqitet jo si pahitëse, por si freskore etj.

Xhevat Beqaraj poezinë e do dhe e krijon me përkushtim maksimal. Poezia e tij ka rimë, ritëm, muzikalitet. Për ta arritur këtë, siç u theksua, ai krijon edhe fjalë të reja, fjalë sinonimike apo edhe të poetizuara

Palmë, palmë, palma ime
Mike e kopshtit tënë,
Pse ke rënë në mendime,
Ç'brengë të ka zënë?!

Pra në vargun e dytë në vend të përmerit tonë poeti shkruan tënë në mënyrë që të arrijë rimimin me vargun e katërt dhe efektin e duhur tingullor.

Figuracioni i gjetur me invencion është ai që poezitë e Xhevat Beqarajt i bën të të habisin dhe të pushtojnë me bukurinë e imazheve që krijojnë. Kjo nuk arrihet vetëm nëpërmjet metaforave, krahasimeve e figurave të tjera, por edhe nëpërmjet shprehjeve të tëra metaforike që paraqesin veprimet e gjërave, sendeve, qenieve e dukurive që përshkruhen, si:

Grunaja det i gjelbër
Përkundet dallgë-dallgë.
Mbi dallgë lulëkuqe,
Posi yje të zjarrtë.

Poemat, si edhe poezitë e Xhevat Beqarajt, të pushtojnë që me vargjet e para. Janë tejet impresive vargjet hyrëse në poemën "Dielli sheh" , në të cilën poeti paraqet gjithçka që në tokë bën jetë në saje të ndriçimit nga rrezet e tij. Poeti përshkruan gjëra e qenie nga më të imtat, të atilla që ndonjëherë vështirë vërehen nga syri ynë, por që bëjnë jetën e tyre sikurse ne. Përshkruhet këtu rënia e rrezeve të diellit mbi çatitë e shtëpive, duke mos iu fshehur asgjë "syrit të tij të zjarrtë". Ai vëren sorrën mbi një rrufepritës, pastaj rosat, dhelprën që e ndjek një çoban me qen, vëren harabelat, maçokun, dhinë si nënëz e mirë me kecat e saj, viçin dhe lopën nënë që e lëpin atë, mushkonjat kërcimtare dhe kërmillin që ngjitet trungut të një shelgu, merimangën, lulet, bletën, po edhe fëmijët me zëra e lodra, si dhe depërtimin e rrezeve të diellit nëpërmjet xhamave në klasa ku përhapin dritë. Sa domethënëse dhe sa gjithpërfshirëse bëhet paraqitja e një drame të tërë jetësore, flet përshkrimi vetëm në një katrenë, me vargje të kulluara në sitën më të imët.

Me zëra, lodra fëmijësh
Mbushen udhët, mbushen sheshet.
Nga xhamat në klasa futen
Dhe dritë përhapin rrezet.

Dhe vazhdohet me pëllumbeshën në plevicë, më pëllumbin e qengjin që e ha ujku për shkak se ndahet nga kopeja, për të vazhduar me fluturat që ndjekin njëra-tjetrën, duke spikatur madje edhe skenën tragjike të mekjes së gëzimit të buzëqershisë nga plumb i verbër... dhe, duke ardhur prapë te përshkrimi i shkurtër, shumë racional dhe tejet i bukur i një drame të tërë tragjike të përbërë nga më shumë personazhe:

Bari skuq, tulaten zogjtë,
Dielli zbehet, i puth ballin,
Toka gjirin hap, merr vajzën,
Vjollcat qajnë, mbulojnë varrin...

Por ne nisëm qëmtimin me spikatjen e pamjeve që të mahnitin që në vargjet hyrëse të poemës, të cilat të pushtojnë që në nismë të leximit dhe të marrin me vete deri në vagun e fundit:

Një nga një zbritën yjet,
Hëna vendrojë ndërron,
Qerpikët i hapi dielli,
Fill i vetëm udhëton.

Kjo, pra, nisja e vjershës apo vargjet e para të saj, janë një mjeshtëri që e karaterizon poezinë e Xhevat Beqrarajt. Aty, përveç tjerash, del në pah spontaniteti dhe frymëzimi i thellë që do të ketë pasur autori.

Edhe nëse në këta libra hasen edhe poezi me vlera më modeste, si "Kur pyet mësuesja" , "Frika e Kreshnikut" , të cilat nuk shquhen për figuracion, megjithatë ato shquhen për rrëfimin poetik, për shpërfaqjen e detajeve nga jeta, nga lojërat dhe përjetimet e fëmijëve, të dhëna me atë racionalitetin që e shquan përgjithësisht poezinë e këtij mjeshtri të rrallë.

Gjuha e poezive të Xhevat Beqarajt është e çiltër, si edhe vetë poezia e tij. Gjenden fjalë të cilat ai i krijon edhe për rimim. Për ta cilësuar viçin e parehatshëm, të cilin në të folmen e zakonshme do ta quanim grindavec, ai përdor fjalën grindaman ("Në livadh me delen pranë/Kullot viçi grindaman") dhe për ta forcuar edhe më shumë këtë trajtë të fjalës, ai jep edhe shpjegimin në fjalorth, por nuk ngurron që fjalën ta vë edhe që në titull të vjershës. Këtë gjetje, këtë invencion sikur ia kërkon apo dikton bukuria e vjershës, arti i saj. Po kjo, pra tendenca për shprehje sa më artistike, do të ndikojë edhe në shmangien nga përdorimi i foljeve në ligjërimin e tij poetik, shpesh duke marrur në ndihmë onomatopenë, metaforën apo ndonjë figurë tjetër, si:

Qeni shullëhet pas portës,
Viçi fap, me bishtin kokës.

Ham-hum! Qeni, tëk, në këmbë,
Si shpërblim i fal dy dhëmbë.

ose

Era vu-uuu, pluhur ngre
E udhën mbulon,
E prej tij: stop, një veturë
Urën nuk dallon.

Nuk ka pothuajse vjershë apo poemë në këto vëllime, e cila qoftë edhe me një varg apo një strofë të vetme nuk të nxitë të meditosh, ta shpërfaqësh bukurinë e saj si rezultat i një përjetimi të veçantë dhe i një kënaqësie të thellë estetike. Poeti del mjeshtër në përdorimin artistik të gjuhës, në ndërtimin dhe thyerjen e vargjeve, në një rrëfimi poetik spontan, fort të natyrshëm dhe shumë artistik.

Nëse lëmë më një anë gjithë atë që ka botuar deri në vitin 2000 dhe marrim parasysh vetëm dy librat e tij më të rinj *Rruzat e vesës* dhe *Me një dallëndyshe*, Xhevat Beqaraj për lexuesit e poezisë sonë për fëmijë do të përjetohet si një Lasgush që ka shkruar për të vegjëlit. Kjo mbase bën që poezia e tij të kërkojë edhe lexues të kultivuar, lexuesin që di t'i vërejë vlerat dhe që di të kënaqet me to.

Në fund, këtë shkrim për disa kujtime për poezinë e poetit Xhevat Beqaraj, duke u fokusuar posaçërisht në mbresat nga leximi i dy librave të tij më të rinj, do të dëshiroja ta përmbyll me një vlerësim të shkrimtarit dhe studiuesit prijatar të letërsisë sonë për fëmijë, Bedri Dedjes: "Shikon rrugës, duke ecur, poetin për fëmijë Xhevat Beqaraj. Pakëz i ngrysur, i menduar, sikur gjithë hallet e botës kanë rënë mbi kokën e tij. Jo, nuk është kështu! Atë e "ngrysin" vargjet e reja që krijon e që bartin rrezet e diellit të Mallakastrës, bukuritë e vrazhda natyrore të Poçemit dhe hallet e fëmijëve të sotëm shqiptarë" . Do të shtonim: ai duket përherë i menduar edhe për shkak të përkujdesjes që frymëzimet dhe idetë e veta t'i artikulojë nëpërmjet vargjesh sa më të bukura, sa më të përkryera, me një përshkrim e rrëfim artistik që të pushton.

Xhevat Beqaraj është një vullkan i çiltër, nga i cili buron dashuria, bukuria, përgjithësisht arti i lakmueshëm letrar.

Të presim edhe befasi të tjera të këndshme nga poeti Xhevat Beqaraj!

Mbi librin "Kartela të realizmit të dënuar" të Visar Zhitit

HESHTJA NDIHMON SHTYPËSIN, ASNJËHERË VIKTIMËN

Nga Minella Aleksi

Të dëshmosh me shkrim pavarësisht nëse je një vajzë e vogël e fshehur në papafingon e një shtëpie apo je një institucion si "Amnesty international" që shkruan letra në emër të të burgosurve politikë, fuqia e tregimit të ndodhive dhe e kontekstit historik të kohës kur ndodhën, është ajo që zakonisht trondit dhe që shkakton ndryshime. Libri "Kartela të realizmit të dënuar" i shkrimtarit Visar Zhiti identifikon dhe analizon argumenta, reflekton e godet fortë, drejtë në ndërgjegjen e lexuesit, si një kujtesë e zymtë, keqardhëse për vlerat e humbura historike kombëtare, për koston e rëndë njerëzore të inteligjencës shqiptare, raportin me të vërtetën gjatë dhe pas regjimit komunist.

Përmban një bilanc tragjik të atyre që u quajtën "armik", në një kohë që fjala "armik" nuk kishte një përcaktim të saktë, por përfaqësonte një diapazon abuziv akuzash të pa limit, të imponuara me dhunën e ligjit nga pushteti komunist. "Armik" mund të ishte kundërshtari politik, mund të ishte një gazetar, intelektualë "borgjezë", artistë, profesorë, shkrimtar, muzikant, poet, shkencëtarë, ish pronar. Klasa dhe arsimi ishin shpesh kriteret kryesore për tu identifikuar si armik. Lexon tekstin dhe imagjinata të sjell përpara syve akuzatorët shqiptarë të stilit sovjetik, atyre të cilëve Partia u jepte porosinë: "Pyetjet e para duhet të jenë; cila është klasa e tij, cila është origjina, arsimi dhe edukimi i tij. Këto janë pyetjet që përcaktojnë fatin e të akuzuarit". Instikti i shkrimtarit e ka motivuar autorin Visar Zhiti, ish i dënuar i ndërgjegjes që të trajtojë në një libër "konfliktin shoqëror post komunist, konflikt për të cilin tre vite më parë, më 2017, dy studjues, Grigore Pop-Eleches (Princeton Univ.) dhe Joshua Tucker (Nevv York Univ.), kishin botuar studimin e tyre me titull "Hija e komunizmit". "Kartela të realizmit të dënuar" vjen si, apo përbën anën tjetër të medaljes e cila si një e vetme ndihmon për të kuptuar dhe thelluar arsyetimin mbi ecuritë post komuniste. Përgjatë tranzicionit shoqëria u ndesh me aspekte të dhimbëshme të karakterit kulturor të cilat përfshijnë qëndrime, besime, njohuri të ngulitura gjatë periudhës komuniste e që si kulturë shoqërore dhe kulturë politike shqiptare përbënin një "geto" të mjerimit shoqëror shqiptar. Analizohet fenomeni shoqëror në disa këndvështrime, e shtyn lexuesin drejt shtegut të meditimeve dhe gjykimeve individuale. Një libër që ngre më shumë pyetje sesa përgjigje të lehta.

P.sh., nuk mund të evitohet një pyetje: Përse ndodhën krimet mbi njerëz që kishin sakrifikuar dhe e kishin pasuruar kulturën shqiptare, çfarë krusje fatale pësoi shoqëria, tek e fundit ç'është kjo "dhimbje" e pashërueshme, përse atëhere, dhe akoma sot pas 30 vjetësh, kategoria e të persekutuarve politikë nuk u mirëseardhë në shoqërinë shqiptare?. Përse kur "armiku" i partisë binte në burg, siç bihet në një humnerë, edhe pse njerëzit ishin të vetëdijshëm për sa evazivë ishte termi "armik i partisë dhe i popullit" prapëseprapë, për fat të keq automatikisht te një pjesë e mirë e popullatës, krijohej një ndjenjë urrejtjeje ndaj këtij "armiku", e barazvlefshme në valencë me urrejtjen armiqësore që mbartëte etiketimi armik, sipas diktatorit dhe Partisë?. Nuk vihej në diskutim se për fajin që i ishte kundërvënë normave të partisë i dënuari jo vetëm konsiderohej armik, por familjarët dhe të afërmit e tij, në gjëndje ankthi dhe paniku bëlbëzonim me njëri tjetrin; mirë për vete që nuk mendoi por na mori në qafë edhe ne të tjerëve. Para rënies në burg këta intelektualë e artistë ishin të vlerësuar për punën që bënin, nderoheshin me "Çmim Republike", "Hero i punës", "Urdhëri Naim Frashëri", etj., ndërsa pas pak ditësh ata ishin "leprozët" të cilëve njerëzit u qëndronin sa më larg. Kreu i komunistëve shqiptarë vrau mbështetësit e tij më besnikë sepse ata nuk arritën të kuptonin se revolucioni nuk kërkonte më revolucionarë, por shërbëtorë të bindur.

Kjo psikozë frike, ankthi, pasigurie, tmerri, paranoje dhe realiteti i përndjekjeve, keqkuptime dhe kontradikta klasore, ishte si një re e plumbtë mbi kokat e shqiptarëve. Parulla e ditës ishte: O me ne o me armikun. Disa njerëz kishin keqardhje, dhimbje njerëzore, ndërsa shumë më shumë se këta ishin të tjerët, turma e indoktrinuar, ata që e mbajtën gjallë urrejtjen ndaj tyre. Edhe kur para vitit 1990 këta "armiq" dilnin nga burgu, te një pjesë e mirë e turmës së njerëzve vazhdonte të përjetohej urretja ndaj "armikut të partisë". Koha vërtetoi se sa më e madhe injoranca aq më i thellë indoktrinimi. Për fat të keq nuk u arrit të shmangej urrejtja që vazhdoi edhe në post komunizëm. Përse? Indoktrinimi komunist si strukturë edukate familjare dhe shoqërore nuk "pastrohet" me dekret, ashtu si me dekret mund të shpallet pluralizmi politik. Sa më i thellë indoktrinimi- injoranca, aq më tepër kërkon kohë emancipimi, çrrënjosja, dezintoksikimi ideologjik shtresë pas shtrese. Aksioma "Sapo të mësoni të lexoni, do të jeni përgjithmonë të lirë", çuditërisht nuk e bën të lirë turmën. Si fara e mirë që mbillet në tokë kripore.

Lenini, udhëheqsi i bolshevikëve, ideatori i revolucionit të tetorit, deklaronte dhe u përmbahej dy parimeve shumë të rëndësishme të ideologjisë së pushtetit komunist: "Na jepni fëmijën për tetë vjet dhe ai do të jetë një bolshevik përgjithmonë". Dhe parimi i dytë: "Ateizmi është pjesa e natyrshme dhe e pandashme e komunizmit". Në librin "Kartela të realizmit të dënuar" dëshmohen pasojat shkatërruese të këtyre parimeve leniniste në shoqërinë shqiptare. Në vitin 1967, i cilësuar prej ish të dënuarit të ndërgjegjes Spartak Ngjela si viti "i hordhive të revolucionit kulturor", u manifestuan qartësisht në shoqërinë shqiptare dy mësimet leniniste. Prej tridhjetë vjetësh shqiptarët në shumicë nën udhëheqjen e Partisë komuniste e kishin përqafuar bolshevizmin dhe e përjetonin përditë në formën e tij më të egër. Shkalla e indoktrinimit bolshevik ishte aq solide sa turmat e revolucionarizuara ateiste u gjëndën të gatëshme që menjëherë, pa asnjë hezitim, me thirrjen e Partisë u turrën dhe shkatërruan kultet fetare. Sa herë e mendoj atë periudhë aq më me vend më duket shprehja: "Një njeri i ndriçuar merr vendimet e tij; injorantët shkojnë me turmën". Partia i përcaktonte artistët e intelektualët armiq, turma i urrente si të tillë. Njëlloj si në Gjermani, Hitleri u vinte hebrenjve Yllin e Davidit në gjoks, turma tru shpëlarë i masakronte në mënyrë të përbindëshme. Raporti midis misionarve predikues (priftërinj e hoxhallarë) dhe pushtetit komunist ishte një raport toksik që e kishte manifestuar shijen e helmët që në ditët e para të pushtetit të diktaturës komuniste, sidomos me çfarosjen në bllok të klerikëve katolik. Eksperienca bolshevike dëshmon se në shoqëritë komuniste shkalla e "shpirtit revolucionarizues proletar komunist" e pranishme në një individ të veçantë ose në të gjithë kombin është drejtpërdrejt proporcionale me shkallën e devijimit nga Feja.

"Fryma e zjarrtë revolucionarizuese" si një infeksion shpirtëror, zë dhe e dëbon nga zemra e nga mendja e njeriut të thjeshtë shpirtin e besimit, dashurinë dhe dhëmbshurinë, i kundërvihet efektit amortizues që e ushqen dhe e çfaq feja.

Ndodh ajo që edhe njerëzit më të ndershëm të cilët i përkushtohen idesë për t'i shërbyer " shtetit të klasës punëtore" nën ideologjinë bolshevike e që janë gati të rrezikojnë vdekjen duke luftuar për idealet e komunizmit, pashmangshëm do të duhet dhe pranojnë në zemrat e tyre frymën e urrejtjes, bëhen të pamëshirshëm, të gatshëm për të zbuluar armikun brenda familjes, për të kërkuar armiq të brendshëm dhe të jashtëm, për të derdhur "gjakun në emër të interesave të Partisë".

U zhduk kisha dhe feja por turma ka nevojë për Kishën. I dorëzohet Kishës, Xhamisë, Teqesë, etj.. Turma s'ka vizion, nuk gjeneron ide, do udhëheqës. Turma i shkatërroi kishat e xhamitë nën udhëheqjen e Partisë. Individualitetet janë ata që e kapërcejnë Kishën, janë bartësit e ideve dhe vizioneve reformuese që shikojnë në thellësi të horizonteve. Rasti i Martin Lutherit brenda fesë është ilustrimi më i qartë.

Në shoqërinë komuniste që përpiqet të standartizojë të menduarit, individualiteti nënçmohet. "Zilia" për pasurinë e të tjerëve, për qëndrimin vlerësues të individit në shoqëri, për suksesin dhe talentet e të tjerëve, etj., në masat revolucionare me vetëdijen e paqartë të tyre ngrihet në rangun e një virtyti. "Frika e krahasimit" si tipar njerëzor ka shërbyer gjithmonë si karburant i xhelozisë. Ka një pasazh në libër ku zilia, cinizmi dhe xhelozia përmblidhen në mënyrën se si shprehet një shkrimtari i njohur pas lirimit të të burgosurve politikë: "Tani erdhën këta që të na zëvendësojnë".

Në librin "Kartela të realizmit të dënuar" lexuesi njihet me listën e gjatë të intelektualëve dhe të artistëve të burgosur e të zhdukur gjatë regjimit komunist. Të vjen në mend thënia e historianit të njohur britanik Martin Gilbert, biografi zyrtar i VVinston Churchill kur thoshte: "Hitleri dhe Çurçilli i para shkruan fundet e tyre, të katastrofës dhe të triumfit. Në

fillim të L2B Hitleri grumbulloi mëndjet më inteligjente të Gjermanisë dhe i zhduku në kampet e çfarosjes, ndërsa Çurçilli grumbulloi mëndjet më inteligjente të Anglisë dhe i vuri që të punonin për dekodimin e makinës "Enigma". Njëlloj në Shqipëri. Diktatori E. Hoxha grumbulloi të arsimuarit dhe i mbylli nëpër burgje, ndërsa mjelëset dhe mekanikët i vuri në udhëheqje të turmave. Me fillimin e Tranzicionit shqiptar "Realizmi i dënuar" ishte e pamundur që të çlirohej. Lidershipi i Partisë që erdhi në pushtet e në vazhdim ishte dhe mbeti një strukturë partiake që zbatoi besnikërisht metoda që në dukje ishin demokratike por ne thelb bolshevike. Të kujtonte thënien e politikanit gjermanolindor Walter Ulbricht: "Duhet të duken demokratike, por ne duhet të kemi gjithëçka në duart tona".

Mendoj se raporti Pushtet "demokratik " / ish të dënuar politik ishte i intoksikuar me urrejtje deri në atë masë sa ish të burgosurit politikë nuk e gjetën asnjëherë veten realisht dhe natyrshëm të njehsuar në radhët e PDsë dhe as si përfaqësues të së Djathtës politike në të. Paradoksalisht më mendje hapur ndaj të dënuarve të ndërgjegjes qoftë në mbështetjen institucionale financiare ashtu edhe moralisht u tregua forca tjetër politike, PS, nga e cila pritej më pak. Roli përcaktues i udhëheqsit të turmës!!

Kategoria e ish të burgosurve politikë u urryen kur u burgosën, urreheshin pas daljes nga burgu dhe në post komunizëm institucionalisht u mbajt e gjallë mungesa e dëshirës për rikonsiderimin e tyre në shoqëri. Shërbimi sekret shtetëror pas viteve 90tëishte një shëmbëlltyrë e shëmtuar e policisë sekrete të E. Hoxhës. Në mënyrën më djallëzore imazhi i kategorisë së të burgosurve të ndërgjegjes u kompromentua dhe u dëmtua rëndë me të gjitha format shantazhuese, dezinformuese, shpifëse, diskredituese etiketuese si bashkëpunëtorë, përzierje të qëllimshme me ish të burgosurit ordinerë, etj, etj. Jo pa qëllim shprehja" i rekrutuar nga sigurimi" i nënkuptonte të gjithë si spiunë të Sigurimit pa u marrë në analizë elementi bazë i rekrutimit, "Tortura". George Orvvell nënvizon se: "përballë dhimbjes në tortura nuk ka heronj". Pas rënies së diktaturës, në liri është e lehtë të flasësh dhe të akuzosh. Umberto Echo vinte në dukje:"Nën tortura ju jeni si nën sundimin e atyre ilaçeve që prodhojnë vizione. Gjithçka që keni dëgjuar të tregohet, gjithçka që keni lexuar kthehet në mendjen tuaj, sikur të transportoheni, jo drejt parajsës, por drejt ferrit. Nën tortura ju thoni jo vetëm atë që dëshiron inkuizitori, por edhe atë që imagjinoni se mund ta kënaqë atë, sepse midis jush dhe tij krijohet një lidhje vërtet djallëzore" .

Çfarë e bën lexuesin që të ndjekë leximin me interes dhe hap pas hapi të filloj që të identifikohet me mëndjen e autorit që e konceptoi dhe e kompozoi këtë libër. Subjekti i shkruar me stil, e drejton vëmëndjen e lexuesit në mënyrë të qëndrueshme. Dhe gjatë leximit ndjen sikur bashkëbisedon me mëndjet e holla të atyre individualiteteve të kohës së kaluar. Sikur edhe vetëm për këtë pasurim shpirtëror të lexuesit ia vlen që të lexohet. Gjuha figurative e kuptueshme, zgjedhja e fjalëve që përputhen me tonin dhe rëndësinë e subjektit të marrë në interpretim, struktura e fjalive të shkurtëra, teknika përshkruese, herë herë alegoria dhe ironia dramatike si shprehje e nënshtresës me deduksione filozofike, në tërësi shija e mirë artistike, krijojnë përmes tekstit "zërin autentik" të autorit, riafirmojnë stilin si vulën e origjinalitetit të tij. Stil letrar që e ka ngritur performancën artistike në nivelin admirues të një krijimi artistik të mirëfilltë që, "hyn" në mëndjen e lexuesit, e zgjeron vetëdijen e tij, e bën të kuptojë konfliktin shoqëror që e ka motivuar autorin. Mendoj se teksti është projektuar dhe inxhinjeruar si një mënyrë edukimi që stimulon te lexuesi vet studimin. Nëse e kaluara ishte një pengesë dhe një barrë, njohja e së kaluarës është emancipimi më i sigurtë. Me këtë libër shkrimtari vendos përballë lexuesit një pasqyrë. Lexuesi shikon në pasqyrë atë çka tashmë ai ka dhe ndjen brenda vetes së vet. Turma mund ta refuzojë e ta thyej pasqyrën. Shkrimtari i drejtohet pjesës së përgjegjëshme të shoqërisë, njerëzve të dijes, të kulturës dhe arteve. I drejtohet Individualiteteve jo Turmës. Jetojmë në sistem demokratik për të cilin Të Diturit na tërheqin vëmendjen se demokracia është një besim patetik në mençurinë kolektive të injorancës individuale. Autori nuk synon që "Ishët" të zëvendësojnë apo që "të fitojnë" mbi krijimtarinë egzistuese të arteve dhe të kulturës në diktaturë. Qartësisht, vjen me vullnetin që të ftojë lexuesit për të konsideruar "realizmin e dënuar" në një hapsirë shoqërore të vëmendjes dhe eksplorimit reciprok. Ai e ka kapërcyer post komunizmin komunist duke e sfiduar atë, duke refuzuar të heqë dorë nga njerëzorja dhe e vërteta. Dëshmia e tij për "Realizmin e dënuar", ka thyer brenda tij mbytjen e dëshpërimit mbi të, duke mbetur vet njerëzor. Libri "Kartela të realizmit të dënuar" i shkrimtarit Visar Zhiti është një kujtesë kurajoze e artistit qytetar, protestë e qëndrueshme kundër indiferencës, jo thjesht e bukur por domethënëse në këndvështrimin etik.

(Duke e lexuar romanin "Mirë se vini zoti ambasador" nga Ardian Haxhaj)

Sarkazma dhe grotesku si kundërvënie ndaj realitetit ekzistencial

Nga Arben Veselaj

Në arealin letrar të Kosovës, për më shumë se 15-vjet, prozatori Ardian Haxhaj padyshim se është ndër autorët më të suksesshëm. Haxhaj bëri emër me disa romane të vlerësuara nga shtypi dhe kritika, disa prej të cilëve kanë marrë edhe çmime në letërsinë kombëtare. Këtu veçoj sidomos romanin "Kryekronika e Fushës së Kosovës" (2008), i cili përfaqëson një prej sprovave të para letrare që rreket t'i eksplorojë sagat ballkanase nën rrogozin e miteve, si dhe romanin "Kujtimet e një çifuti" (ky roman e mori Çmimin Vjetor për Letërsi në vitin 2010), me të cilin ky autor, ndër të paktët e letrave shqipe, e bëri letërsinë tonë pjesë të asaj që disa studiues e kanë quajtur "Paradigma hebreje e letërsisë së shekullit XX".

Por, së fundi, Haxhaj na ka dhuruar një roman disi më ndryshe nga të gjashtët sa ka botuar deri më tani: "Mirë se vini zoti ambasador"! Që në titull ai sikur na paralajmëron se është, siç do të thoshim ne gazetarët "provokativ". Pra, me këtë titull autori sikur na fton të "kacafytemi" brenda honeve të letërsisë kritike, ku realiteti sarkastik përjetohet si aventurë leximi dhe ku shkrimtari do të na shpall disa nga "herezitë" e tij më të fundit.

Romani ka një nota të larta të sarkazmit dhe groteskut që i kundërvihet realitetit ekzistencial. Ai kapë një fabul që shtrihet brenda një periudhe kohore mbi 30-vjeçare, kohë kur edhe ndodhin jetët dhe të bëmat e personazheve. Përmes një rrëfimi tërheqës, me një stil tregimtar të këndshëm, shpërfaqet "njeriu i Kosovës" brenda ingranazheve të procesit të gjatë dhe të mundimshëm të mbijetesës, të kërkimit të lirisë dhe dinjitetit njerëzor. Autori përdorë një gjuhë sarkastike dhe teksa përshkruan situata të rëndomta ato vetvetishëm marrin karakter figurativ, duke na zbuluar një botë krejtësisht groteske. Kjo gjuhë që përdorë autori jo vetëm që na grish të mos ndalojmë së lexuari, por edhe të reflektojmë për shumë çështje që na dalin parasysh gjatë të lexuarit, nganjëherë të mos pajtohemi, sikurse ndonjëherë edhe të polemizojmë me to.

Sikur shumë "histori" shqiptarçe që nisin si epope dhe në fund përfundojnë si komedi, edhe "historia" e Haxhajt ka këtë përfundim! Ajo gërsheton elemente imagjinare me ngjarje reale dhe na ofron një dokumentar letrar tragjikisht të bukur.

Haxhaj ka ndërtuar një rrëfim (histori) ndryshe për Kosovën, një histori me të cilën jo vetëm se kemi vijuar të jemi të vetëmashtruar që prej shumë kohësh, por me të cilën shpesh kemi arritur t'i mashtrojmë edhe të tjerët. Thyerjen e miteve (demitizimin) e kishte provuar edhe te romani "Kryekronika e Fushës së Kosovës", por kësaj radhe ai këtë e shprehë me një gjuhë krejtësisht të shkoqur, duke bërë një kapërcim cilësor nga një prozë alegorike drejt një proze me tone metonimike.



Rrëfimi i Haxhajt lidhet me një dialog imagjinar që narratori - Shkodrani, bën me një ambasador të porsaemëruar amerikan, i cili bëhet gati të zbarkojë me mision diplomatik në Kosovë. Shkodrani, që për ironi kishte bërë diplomë universitare për histori, por kishte përfunduar me punë të përhershme si kamerier në njërin nga restorantet kryeqytetase ku mbahen takimet jashtëprotokollare të zyrtarëve më të lartë të shtetit, duke përfshi edhe ato sekrete, ndien një nevojë të papërmbajtshme që t'ia rrëfejë ambasadorit një "New history" për Kosovën. Me sintagmën "Mirë se vini zoti ambasador" ai sikur dëshiron të thotë: Mirë se vini zoti shpëtimtar!

Këtë histori Shkodrani dëshiron t'ia rrëfejë ambasadorit nga zemra e plastë, sepse ai është i bindur se në Kosovë nuk kishte mbetur njeri i gjallë që nuk ishte bërë pjesë e skemave mashtruese e kriminale, që prej atyre institucionale e deri te ato parapolitike. Pra, në Kosovë nuk kishte mbetur një autoritet tek i cili do të mund të qahej hallesh njeriu i shkretë.

E, ndërkaq, rrëfimi i Shkodranit për ambasadorin është rrëfimi i njeriut të zakonshëm kosovar, njeriut nga më të përvuajturit, varfanjakut, të traumatizuarit nga regjimet serbe të paraluftës, regjimeve të pasluftës, njeriut çdo herë të gënjyer, çdo herë të mashtruar, çdo herë të plaçkitur, çdo herë të keqpërdorur, çdo herë të mohuar.

Duke rrëfyer historinë e familjes së vet, në fakt Shkodrani rrëfen fytyrën e vërtetë të shoqërisë kosovare me të gjitha pamjet e shëmtuara; atë fytyrën e palavdishme të cilës klasa politike dhe institucionaliste çdo herë kishte arritur t'ia ngjiste gazin e buzëqeshjen e paqenë, ndërkohë që brenda fshihte një tjetër krejtësisht të zezë.

Në këtë roman Ardian Haxhaj ka krijuar një regjistër interesant personazhesh, emrat e të cilëve lidhen edhe me veprimet e tyre, si: Nuhi Dera, I Qimi Nanës, Bythëmadhja, Gremqi etj. Ai ka tipizuar me shumë prej personazheve tragjikomikë, por, njëri prej tyre, Nuhi Dera, ka diçka të veçantë: me "të bëmat" e tij ai është disi i pangjashëm në letërsinë shqipe, duket sikur është "arratisur" nga romanet e Marquez-it, apo nga ata të Vargas Llosa-s. Aventura qesharake e një fshatari kooperativist, i cili përmes mashtrimesh arrin deri tek "kurorëzimi" me statusin e "heroit" të gjallë, e bënë Nuhi Derën t'u ngjajë personazheve maçoistë te romani "Festa e Cjapit" i Mario Vargas Llosa-s. Nuhi Dera është prototipi i atyre njerëzve që quhen "profiterët e luftës", ata të cilët në mungesë të autoritetit ligjor për më shumë se dy dekada e kanë bërë ligjin e të fortit. Rrëfimi për Nuhi Derën jepet me shumë mjeshtri. Brenda kësaj historie autori na përqas një kuptim të bartur e ironik, të hollë e të zhdërvjelltë, me argumente të huajtura krejtësisht nga jeta reale dhe nga njerëz realë, duke na përballur shpesh me tablo sarkastike, groteske e tragjikomike.

Me këtë roman Ardian Haxhaj ka arritur ta na zbulojë çdo aspekt të "superstrukturës" kriminale të vendit tonë. Me shumë guxim ai e vë në tallje sentimentin heroik-kombëtar, sepse konsideron se i njëjti është keqpërdorur për qëllime nga më të errëtat. Përmes personazhit të tij, të shkretit Shkodran, autori sikur përvijon bindjen se, duke u keqpërdor ky sentiment në Kosovën e pasluftës u krijuan shumë skema mashtrimi, skema kriminale, që nga ato politiket, e deri te zhvatja me pasuritë shoqërore. Me aq sa "lejon" shprehësia letrare ai nuk e kursen aspak arsenalin që ka në dispozicion për t'i demantuar epikat e paqena të paraluftës, heroizmat e rremë të kohës së luftës, sikurse as heronjtë e paqes dhe të kinse shtetndërtimit etj.

Në fund duhet thënë se romani "Mirë se vini zoti, ambasador" mund të konsiderohet një lament i rrallë letrar që i kushtohet krizës së madhe morale dhe ekzistenciale që ka pllakosur mbi vendin tonë që prej shumë vitesh. Qëndrimi kritik ndaj kohës së vet, edhe pse ndoshta i vetmuar, e bënë autorin e këtij romani, një zë që fuqishëm kumbon brenda ndërgjegjes së lënduar të shoqërisë kosovare.

Metamorfoza e shndërrimit të nënës në kukull

Gentiana Bajrami Atashi

Hyrje

"Kukulla" e Ismail Kadaresë fillimisht u botua si pjesë e librit "Mëngjeset në Kafe Rostand - Motive të Parisit". Në vitin 2015 u botua si roman me vete, me titullin "Kukulla" dhe me nëntitullin "Portreti i nënës". Në leximin e parë, ai shfaqet si roman absurd në cilësimin e nënës, por kjo paarsyeshmëri fiksionale tretet nga rileximet, sepse çdo herë e më shumë del në pah vlera e këtij romani, në veçanti për lexuesit semiotik siç kanë potencuar studiuesit si karakteristikë e veprës postmoderne.

Nga shumë kritikë, "Kukulla", konsiderohet roman autobiografik dhe ashtu reflekton, sepse pothuajse e gjithë vepra përshkruan udhëtimin intim në jetën e Kadaresë, duke vënë në pah marrëdhënien e tij komplekse me nënën e tij.

Në romanin "Kukulla", shkrimtari në mënyrë kronologjike jep të dhëna për jetën, nisur nga fëmijëria e deri në vitet e mëvonshme të pjekurisë së tij. Ismail Kadare përshkruan me mjaft përpikmëri periudhën jetësore të hershme (shkruan nga këndvështrimi i fëmijës) dhe rrëfimi vazhdon deri në momentin e shkrimit të veprës. Përbrenda këtyre dy skajeve, autori portretizon familjen dhe shoqërinë e asaj periudhe, në mënyrë specifike jetën nën konturat e komunizmit. Personazhi kryesor i veprës është kukulla, nëna e tij. Ai rrëfen ngjarjet që nga martesa e saj e detyruar si një shtatëmbëdhjetë vjeçare. Kadare përshkruan familjen e nënës (Dobatët) dhe të babait (Kadarenjtë); dy familje të një qyteti antik shqiptar (Gjirokastra), e që midis tyre, në mënyrë të nënkuptuar ka ekzistuar një lloj 'lufte' e ftohtë. Në mënyrë të hollësishme, Kadare tregon ndikimin e traditës së ashpër patriarkale, veçanërisht faktin që nëna qe e obliguar të jetonte nën vëzhgimin e vjehrrës së saj dhe ndikimin e po të asaj në vendimarrjet familjare, e cila qëndronte brenda 'burgut', duke ndjekur zakonet familjare. Rolin e babait e konsideronte gjykatës dhe funksioni i tij ishte gjykimi i marrëdhënieve midis gruas dhe nënës. Misteri i shtëpisë monumentale ishte burgu, enigmën e të cilit nuk e mësoi asnjëherë. Gjithashtu,romani mbizotërohet nga karakteristika të fillesës së shkrimeve të tij dhe jetës rinore, njohjen dhe martesën me Helenën, vitet e mëvonshme të krijimtarisë së tij, si dhe vdekjen e babait dhe të nënës.

Raporti i Kadaresë me nënën e tij është pasqyruar në shumë pjesë të romanit, por në mënyrën enigmatike, që sipërfaqësisht dukej i pazakonshëm. Përbrenda gjithë asaj mjegullie theksohej një lidhje e fortë shpirtërore, por që ishte e pamundur të kalonte në lidhjen e tyre reale. Gjatë leximit hetohen shumë karakteristika në mospajtimin, largësinë, ashpërsinë, fyerjen, ironinë e relacionit bir-nënë, por edhe ajo lidhje e ngushtë, e cila vështirë e perceptohej në leximet e para.

Kukull ishte emërtimi i shkrimtarit për nënën. Për arsyen e emërtimit të tillë të së ëmës duhet nisur nga ajo që veprat e Kadaresë shënjojnë thellësinë psikologjike, që në shumicën e rasteve duhet nënkuptuar hapësirat e brendshme të të pathënave dhe funksionin e tendosjes personale, gjë që e bën "Kukullën" roman unik në letërsinë shqipe, por edhe më gjerë.

Metamorfoza e nënës

Gjeneza e shndërrimit të nënës në kukull, gjurmohet me elementet autobiografike të viteve fëmijërore dhe rinisë së Kadaresë. Së pari, autori nxjerr në pah shpërputhjen e nivelit shoqëror të familjes së Dobëve dhe të Kadarenjve. Hatixheja ishte vajzë e rritur në një mentalitet komplet tjetër, në një familje të emancipuar dhe të pasur; në roman përmendet shkollimi i familjarëve të saj (ungjve të tij të cilët ishin shkolluar në Budapest dhe Moskë). Kontrastet e radhës familjare ai i përshkruan nga këndështrrimi i një të rrituri, pasi që do të ishte e pamundur të hetoheshin në fëmijërinë e tij.Përveç dallimit se shumica e Dobatëve ishin në jetë, kurse Kadarenjtë ishin të vdekur, ai dikton edhe shumë element të ndryshueshmërisë në mes të këtyre dy familjeve: shtëpitë, parfumet, violinat, bujqit grekë të ish-pronave të gjyshit, ish shërbëtorët, bisedat dhe leximi i gazetave për çështje me rëndësi, si neoshqiptarizma, idetë e Frojdit e të Branko Merxhanit, etj., që për tjetrën ishin të pazakonta. Të dy familjet kishin vendosur që në raportet e tyre të maskoheshin: Dobatët ta fshehnin pasurinë e tyre, kurse Kadarenjtë maskimin e madhështisë së rreme. Në njërën nga faqet, Kadare shkruan: A mund të krahasohej, për shembull, rënia e violinës, me dy dhomat ku s'na lejohej të hynim ose me hapsanën, siç quhej burgu? Kontrasti në mes të këtyre dy familjeve ishte më i thelle se sa dukej.



Autorja e shkrimit, Gentjana Bajrami Atashi, duke marrë romanin "Kukulla" të nënshkruar nga Kadare

Madhështia e rreme dhe relacioni i kundërshtisë

Rritja e kësaj vajze shtatëmbëdhjetë vjeçare ishte ndërprerë nga një marrëveshje që qysh në fillesat e saj ishte e gabuar: 'mëkat' që s'ishte marrë vesh kurrë. Ajo hidhet në një familje të madhe dhe të mbyllur, ku gjithçka sillej rreth vendimeve të një kryefamiljareje që përveç që në rrethin e tyre kishte emër si grua buzëhollë dhe e mençur si fëmijë dhe Kadare e konsideronte të tillë. Do t'i duhej një jetë e tërë që të kuptonte esencën e nameve të tilla për "mençurinë e tëpërt", në veçanti të gjyshes, që përmes shenjave të fshehura vërehet qartë pikëpamja jo e drejtpërdrejtë e Kadaresë për gjyshen. Prandaj, metaforikisht e ka cilësuar të tillë "e mençur", duke shprehur ironi të thellë për mediokërit. Mediokriteti paraqitej si veçanti e gjithë familjes jo vetëm e gjyshes dhe hetohet në shumë raste. Si mosdalja e grave të moshuara nga shtëpitë e tyre ishte një dok i pashpjegueshëm dhe i paarsyeshëm. Mosdalja, sipas Kadaresë ishte një lloj statusi, në një formë ngritje rangu ose cilësi e një mondaniteti apo formë e disa familjeve gjirokastrite, të cilët vuanin nga mania e mendjemadhësisë. Vetë autori i cilëson doke të njerëzve të marrë, që kishin lidhje me ngritjen e autoritetit. Pastaj lëkundja e babait, domethënë qëndrimi neutral në raport me gruan dhe nënën, që sipas zakoneve të qytetit të vjetër epërsia në çdo rast duhej t'i takonte nënës, dhe si i tillë ai cilësohej si një i luajtur mendësh. Kadare citon se: Prej kohësh mendonin se "mikrobi i madhështisë" i ishte ngjitur ndërkaq jo vetëm asaj, por edhe mua qysh se kisha mbushur njëmbëdhjetë vjet. Ethet e lavdisë si tipar i karakterit të tij kishin vazhduar në gjithë rininë e tij, mbase gjatë gjithë jetës së tij.

Raporti mohues midis vjehrrës dhe nuses u hetua që në ditën e parë të martesës. Raporti i tyre shpesh dukej i lehtë për t'u kuptuar, por shpesh bëhej aq i pazbërthyeshëm, ashtu që mjegulla do të largohej vetëm pas shumë vitesh për ta kuptuar realitetin. Për balancimin e raportit të këtyre të dyjave, gjyqi ishte ai që gjykonte veprimet e të dyjave, e gjykatësi ishte babai. Procesi gjyqësor i këtyre dy grave ishte i papërfunduar; proces për diçka që nuk zgjidhej. Nga këndvështrrimi i Kadaresë si fëmijë ky proces ishte grotesk, por që duke u rritur ajo hetonte diçka me të thellë në gjithë këtë pështjellim.

Ndeshja e këtyre dy botëve të kundërta shkakton një mbyllje në vete të Kukullës, një largesë dhe një mospajtim i brendshëm me një realitet të ri, ku gjithçka përfundonte përbrenda një bashkëjetese boshe, një bote që nuk i takonte asaj. Merrej me mend se lidhjet e Kukullës me shtëpinë nuk mund të ishin veçse të sipërfaqshme. Ajo sipas gjitha gjasave në pamundësi që ta përballonte këtë kontrast jetësor, zgjedh tërheqjen dhe nënshtrimin në atë rreth të vetmuar. Shpresa e saj ishin fëmijët, si çdo dëshirë e një nëne, por kjo gjë nuk u përmbushë asnjëherë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës me djalin e saj, Ismailin. Ai nuk e njohu anën e vërtetë të saj, së paku sa ishte ajo në jetë. Edhe pse qe lidhja më e fortë jetësore nënë- bir, kjo lidhje kishte një largesë në realitet, dhe një ashpërsi e shprehur përmes ironisë nga ana e të birit. Kukull ishte ajo jo vetëm nga përshkrimi i jashtëm: e bardhë, e lehtë, e brishtë si prej porcelani dhe naive sikur një kukull, por edhe nga ana subjektive, sepse roli i një kukulle është sjellje e kënaqësisë tek të tjerët; një objekt i thjeshtë loje. Si e tillë, realiteti jetësor i Kukullës, u bë i errtë në një shtëpi që të hante. Kjo frazë ka përqendruar tërë trishtimin Hatixhes, e cila nuk mund t'i shprehte ndjenjat, mendimet, dëshirat, pasionin vetanak dhe e gjithë qenia e saj, prandaj çdo ditë humbte nën errësirën e një jete të mjerë. Autori paraqet në fomën më të mirë karakterin letrar që mishëron individin, konkretisht vizionin e tij për gruan shqiptare në një periudhë kohore 'mbytëse'. Edhe pse dukej aq naive dhe e brishtë kishte një fshehtësi të çuditshme. Dukej se nuk i dinte gjërat, por në realitet dinte shumë, dhe e gjithë enigma e saj fshihej prapa cilësimit të opinionit të të tjerëve, "gjendje ekonomike".

Pazbërthyeshmëria e figurës së nënës

Nëna, sipas Ismail Kadaresë të cilit i kishte bërë përshtypje poezia e e Andrei Voznjesenskit, që në një shpjegim të tij për ato vargje tregonte lidhjen e sintagmave nënë dhe terr, e sipas gjitha gjasave ky krahasim kishte të bënte me pazbërthyeshmërinë e nënës, ashtu sikur terri.

Pazbërthyeshmëria e nënës së Kadaresë qe karakteristikë që e përshkon gjithë romanin. Në një nga pjesët në mënyrë të sipërfaqshme përmendet një histori dashurie e nënës para martesës, por që me një fjalë ai s'do ta konsideronte as "dashurizë" historinë e treguar, duke e lënë në turbullirë mendjen e lexuesit se mos ishte ai i gjithë shkaku i misterit të karakterit të saj.

Gjithashtu, Kadare kishte dyshime në të ashtuquajturën dashuri midis babait dhe nënës. E quante dashuri në shikim të parë, duke e krahasuar me atë të Dantes dhe Beatriçesë. Mbase paradoksale dashuria e tyre që filloi nga një shikim nga dritarja dhe pas treçerek shekulli më vonë të mbyllet me dëshirën e nënës, për t'u varrosur në një varr me atë (bashkëshortin).

Enigma e nënës ishte aq e fortë sa që e krahasonte më hyrjet e daljet e fshehta të shtëpisë së tij, që nuk i kishte zbuluar kurrë, që shpesh dukeshin si kod i pashmangshëm për analizën dhe zbërthimin e këtyre mëdyshjeve.

Kah fundi i romanit, Kadare thekson rolin dhe ndjeshmërinë e nënës për artin në përgjithësi. As ajo, babai dhe vetë shkrimtari mbase as dyzimi i saj njerëzor nuk arriti ta kuptonte. Sensi dhe vetëdija e saj për artin shkonte përtej parashikimeve të tyre. Ishin të tjerët të cilët e vunë në pah ndjeshmërinë dhe pasionin e saj për Teatrin, Pallatin e Kulturës, Klubin e Shkrimtarëve, Galerinë e arteve, hotel Dajtin. Ishte shumë vonë kur Kadare kishte arritur të zbulonte se në ditët e bukura vishej me rroba të veçanta dhe dilte në ecjen e lehtë, e që në të vërtetë ajo fshehurazi shkonte në teatër. Zjarri pasionant për artin nuk i ishte shuar edhe pas kaq vjetësh, por që vazhdoi ta mbajë të gjallë në vitet e mëvonshme të jetës me një ndjesi dhe interes të pazakontë. Ajo mbeti gjithmonë e njëjta në stilin e saj kuptimi e moskuptimi bashkë, të bëra njësh, në jetë e në mosjetë.

Frika e mohimit të nënës nga djali është përshkruar në mënyrë të tërthortë. Ishte një frikë e brendshme e asaj që herë pas herë i shfaqej si ankth. Shqetësimi i saj nuk u shua pothuajse asnjëherë, pra vazhdoi deri në përjetësi. Edhe pse autori e dinte që frika e nënës ishte e kotë, e pakuptimtë, ai kurrë nuk u shpreh me të, sepse e kishte të pamundur t'ia shpjegonte. Tërheqja nga autoriteti i saj si nënë ishte i qëllimshëm, sepse e dëshironte dhe e kërkonte lirinë e djalit në një botë që ishte e izoluar. Mbase thirrja e saj "mos më moho", kishte një domethënie të thellë, në formën që nëse mohimi është aspekt i të përfituarit në avancimin e tij, atëherë le të mohohet nga i biri. Thelbësore ishte 'shkëlqimi' ose 'lartësimi' i tij. Përkundër ashpërsisë, dhe raportit tallës ndaj nënës që shprehet në faqe të tëra të romanit, ana tjetër e karakterit të djalit ishtë formë e dhembshurisë, sepse e tmerronin lotët e saj, si rrjedhojë ndjente dhembje të papërballueshme. Këtë gjë sigurisht që e ka ndjerë edhe babai i tij gjatë jetës, por ishte e pashmangshme që të përmbyste traditat e shtëpisë treqindvjeçare.

Pikëpamja e tij për nënën me kalimin e viteve ndryshonte në zbërthimin e së vërtetës përkundër pasakatësisë së arsyes në vështrimin e asaj, që pikërisht tek ajo fshihej zanafilla e dhuntisë së tij për të shkruar. Mbase gjithë ato që i kishte marrë, i kishte marrë nga një qumësht ndryshe, qumësht gjiri i një kukulle, e mbi të gjitha ndjesinë e tmerrit të ftohtë si të një gipsi, e që më vonë, çnjerëzorja tek ai do ta mbronte nga tmerri i njerëzve. Gjithçka e nënës i kishte kontribuar në punën e tij, madje edhe dhembja, mungesa, lotët, çdo gjë që e kishte dëmtuar atë, ishte bërë në çfarëdo forme pjesë e artit të tij. Ajo medeomos kishte dalë përballë me të dhe artin e të birit e që njëra gjithsesi do të humbiste. Ajo që u tret ishte pikërisht ajo, pra nëna. Përfundimisht hoqi dorë nga çdo 'pozitë', veçanërisht nga të qenit nënë, duke u shndërruar në kukull, për t'ia falur të birit lirinë, në një botë ku liria ishte e pazakontë, si copa e bukës së racionuar në kohën e gjermanëve, që e shkëputse nga pjesa e saj e paktë, për të ma dhënë mua fshehtazi...

Përfundim

Ky roman shenjon guximin e autorit për një histori të qytetit të Gjirokastrës, me ngarkesë ironie, duke e përshkruar veten në disa aspekte si një të ri arrogant, i fiksuar, e që më pas krijon një këndvështrim të ndryshim nga tradita dhe jeta mbytëse e vendlindjes dhe vlerave të së kaluarës, që kishin shënuar fëmijërinë e tij dhe jetën e nënës. Kadare nuk thekson çështjen e pakënaqësisë së Kukullës në mënyrë të drejtpërdrejtë, por që në mënyrë implicite transmetohet pakënaqësia e nënës në rrjedhën e romanit.

Diskursi i tij shfaq në mënyrë të nënkuptuar afërsinë e brendshme në mes tyre, por pamundësinë për ta shfaqur nga ana e autorit, kurse nga ana e nënës reflektohet me kujdesin, shqetësimet dhe dëshirat në raport me të.

"Kukulla" nuk është një roman idesh, pra në thelb është një roman i reflektimit të një marrëdhënieje, i përmirësimit, i vlerësimit dhe dinjitetit tipik si veprim definitiv i nderit përpara qenies më sublime, nënës së tij.

Libri me tregime "Mbretëria e ëndrrave" i Ndue Ukajt meriton me u lexue për stilin e zhdërvjellët dhe për ndjeshmëninë e naltë qytetare.

Kumtet e andrrave të këqija

Nga Ardian Ndreca

Ky libër me tregime i shkrimtarit Ndue Ukaj asht nji metër me të cilin autori mat dhe shmatë vetveten dhe gjinin e tokës prej së cilës ai ka dalë. Me nji gjuhë të thjeshtë, nganjiherë madje tepër të thjeshtë e pa trope, ai ndërton dhe zbërthen kryqëzimet e sotme të jetës sociale e politike të Kosovës së tij. Ndodh që nganjiherë të distancohet prej ngjarjeve që rrëfen tue i vendosë në kohna të paidentifikueme, pa deklarata pompoze toponimesh apo vitesh. Fabulat janë elementare, por asht elementarja ajo që ndërton intimitetin e nji bashkësie që ka pësue thyemje dhe damtime strukturale dhe po vonon me e marrë veten.

Ukaj asht rrëfimtar i qetë, sintaksa e tij ma së shumtit i ngjan asaj të rrëfimeve të motit buzë votrës, figuracioni asht i kandshëm, ndërsa erudicioni dhe formimi profesional ia lejojnë me hy e me dalë lirisht në fushat e pamata të letërsisë botnore prej kah zgjohen hera herës reminishenca të kandshme n'daç letrare n'daç filozofike.

Tek tregimi *Ëndrra e perandorit* autori lot me shtjellat e botës onirike, tue e kthye pallatin e perandorit në nji muskul kardiak ku ndihet vetëm ushtima e zemrës së tij të rrethueme prej vetmisë së pushtetit. Gjithçka asht pezull, e tmerrueme prej nji *horror vacui* që mbështjell keqas ata që kanë pushtet të pakufizuem dhe të pakontrolluem. Janë pamje jashtë kohet që ngatërrohen me jetën normale të cilitdo që provon sadopak andjen e pushtetit. E gjitha ngjet gati me vumjen në nji skenë metropolitane të bërthamës së nji tragjedie të vjetër. Andrra e mallkueme asht zhguelli prej frike e ankthi që rrethon misterin demoniak të pushtetit.

Pasqyra e një gjenerali asht rrëmimi freudian dhe rigjetja e ndërgjegjes, dorëzimi përpara së vërtetës, asaj që shpeshherë uniforma që i kemi ndërtue vetes msheh me vullnet dhe pa vullnet. Rrëfimi ka reminishenca psikoanalitike dhe mton me ndërtue nepërmjet nji fabule të thjeshtë rrugën e mundimshme të njohjes dhe pranimit të vetvetes.

Tema e pushtetit trajtohet edhe tek tregimi *Shpërfillja e një udhëheqësi* ku kulti personal merr përmasa patologjike të cilat të përkthyeme në art kumtojnë fundin e atij që e mban pushtetin. Ideja e nji uni hipertrofik që kaplon gjithçka që përmbys normalitetin e jetës së njerzve pse don që çdo detaj i saj të ketë vulën e vullnetit dhe dëshirave të tija, përshkon çdo rresht dhe na kujton disa faqe të trishtueshme të historisë sonë të shekullit XX.

Protagonisti i tregimit *Një letër pa paralajmërim* ndërthur dukshëm temën e pushtetit me zhvillimet tragjike të periudhës së mbaspamvarsisë në Kosovë. Tensioni i rikrijuem prej mujsharëve hyn frikshëm nën lëkurën e nji intelektuali patriot që ka vetëm nji faj: nuk asht ba borizan i farsës së atyne që për pushtet plaçkisin dhe rrënojnë të ardhmen e atdheut të tyne.

Fryma alegorike ndihet edhe tek tregimi *Muzeu më i madh i historisë*, ku Ndue Ukaj flet për muzeun e trajtuem si ngrehinë politike në shërbim të kësaj të fundit, pra historia e rrahun në kudhrën e politikës, e përthyeme me forcë për interesa të vogla meskine klanore. Kalojnë para syve skenat qesharake të ndamjes së nji lavdie të paqenë prej atyne që politikën e konceptojnë si grabitje të komunitetit ndërsa luftën si nji rast të papërsëritshëm me dalë në ballë siç del zakonisht gjithçka e pavlerë e rastësore që përmban historia.

Nji lakim të përafërt edhe pse në nivel tjetër ai i ban historisë edhe tek tregimit *Pak para se të binte errësira*, ku ndihet i fortë ndikimi pozitiv femnor, dashunia si balsam për melankoninë e intelektualit, në cilindo rreth të ferrit të ndodhet ai.

Marrinë që kapërthen do njerëz të lodhun prej rrengjeve të historisë, të cilët duen me konvertue në lavdi të paqenë personale vuejtjet shekullore dhe gjakun e derdhun prej trimave, autori e quen "sëmundja e lavdisë" dhe i jep hapsinë tek tregimi *Manual drite*, i cili përshkohet fund e maje prej shijes së keqe që len zhgënjimi prej asaj andrrës që s'u realizue dot. Onomastika në dorën e tarafeve, bustologjia, monografitë pseudohistorike me porosi, plagët e atyne që duen me projektue vetveten me zor në histori, mungesa e realizmit dhe e modestisë, që në fund krejt dëshmojnë edhe për ftohjen e idealeve të nalta të politikanit ma të madh, andrrimtarit të Kosovës së lirë dhe demokratike, Ibrahim Rugovës.

Krahas historisë së zvetnueme të trimave që dalin mbasi ka mbarue lufta, për autorin ekziston edhe nji histori e mirëfilltë, madje me nota intime familjare, nji të tillë përshkruen tregimi *Kur gjyshi im vizitoi Romën* ku ai përshkruen me lirizëm spontan e të çlirët figurën emblematike të gjyshit të tij, nji plak që mëson e udhëheqë në rrugën e virtytit me shembullin e tij të përkorë.

Autori e prekë me delikatesë magjinë e asaj kohe të artë që asht fëmijnia, i afrohet me detaje dhe përçon emocionet e pararendësit të tij gjatë nji vizitë në Selinë Apostolike në Romë.

Ky libër i Ndue Ukajt meriton me u lexue për stilin e zhdërvjellët dhe për ndjeshmëninë e naltë qytetare. Autori rrëfen me vetëdije dhe me respekt plagët e tokës së tij, nji vend ku ai dhe të ngjashmit e tij janë dhe ndihen përditë e ma shumë nji pakicë kulturore dhe shpirtnore. Këto tregime rrëfejnë me art mungesën e shpresës, thyemjen e andrrës por edhe dëshirën e nji ringjalljes së vërtetë të nji populli.

SILUETA PROMETEIKE E DE RADËS

nga Skënder Karriqi

1-Tabuja e Prometeut dhe çlirimi prej saj

Në kontekstin letrar të Rilindjes Kombëtare, në fakt, jemi në rrethanat e një qëndrimi *tabu* ndaj figurës së Prometeut. Një qëndrim të tillë do ta vërejmë tek të gjithë autorët e kësaj periudhe, të cilët, edhe pse njohës të mirë të mitologjisë dhe letërsisë klasike antike si dhe të autorëve evropianë që e kanë trajtuar pozitivisht temën e Prometeut, pothuaj nuk e përmendin fare këtë hero dhe mitin e tij, as në formën mitologjike, as në formën letrare. Janë vetë këta autorë pra, që e mbajnë larg nga vetja emrin e titanit.

Por nga ana tjetër, letërsia shqiptare e Rilindjes Kombëtare karakterizohet dukshëm nga prometeikja. Po të kemi parasysh praktikën leksikologjike të *tabusë* e cila domosdoshmërisht sjell me vete edhe qëndrimin tjetër, atë eufemistik (pra zëvendësimin e fjalës *tabu* me një fjalë tjetër), asgjë paradoksale s'ka në rrethana të pranisë së prometeikes që karakterizon letërsinë shqipe të Rilindjes pa praninë e shpallur të Prometeut. Prometeikja e kësaj letërsie ka patur heroin e vet eufemistik. Ndër përdorime të tilla si: *dritë, yll, diell, engjëll etj*, të cilat përmbushin funksionin eufemistik, është edhe emri *profet,* i përdorur me funksion eufemistik për të shmangur përdorimin e drejtpërdrejt të emrit *Promete*. Siç është në natyrën dhe funksionin e zëvendësimeve të tilla (eufemistike), roli i tyre është zbutës, shmangës dhe arrin deri në krijimin e iluzionit për tjetërsimin kuptimor etik të fjalës përkatëse të ndaluar.

Në *Parimet e estetikës* De Rada thotë ...*Si ai që shtynte Gurin...*[1] S'ka dyshim se fjala është për Sizifin, emrin e të cilit ai nuk e përmend, sepse ky hero mitologjik bënte pjesë në familjen e titanëve të rebeluar ndaj Zeusit, figurës mitologjike paralele me Zotin e krishterë. Ndërsa në poemën *Odiseu* ai thotë ...*/ Njerinë aq të bukur dhe me aq përgjërim, / të nxjerrë në dritë nga gjysmëperëndi,*[2] duke mos ia përmendur fare emrin Prometeut, gjysmëperëndisë për të cilën e ka fjalën, i cili, sipas mitit dhe variantit letrar të tij, u solli njerëzve zjarrin dhe u ndriçoi mendjen, të njihnin veten dhe të parashikonin të ardhmen. Në rastin e De Radës është vetë ai që e modelon këtë lidhje konkrete tabu-eufemizëm dhe më pas janë edhe të tjerët që e përdorin atë, qoftë për arsye të njëjta me të, qoftë duke pasur në konsideratë shenjën poetike të fjalës *profet*. Për raste të tjera që do të vijnë më pas, siç është, fjalavjen Naim Frashëri, krahas tabusë si qëndrim i brendshëm i vetë poetit, është dhe modeli që funksionon.

Pra, gjithsesi, tabuja është një ndalim në aspektin e jashtëm komunikues. Në përjetueshmërinë e subjektit, në rastin tonë autorit, ky ndalim nuk e anulon idenë, opinionin, bindjen e tij për objektin e ndaluar, i cili si çdo ndalim, do të jetë në *arkivin* e subkoshiencës së subjektit, (në rastin tonë De Radës). Kështu objekti i ndaluar është i pranishëm në ëndrrat e poetit, në lapsuset e tij, në shakatë etj. Por, ndonjëherë, ky objekt i ndaluar artikulohet hapur, duke i shpëtuar edhe censurimit të koshiencës. Kjo gjë ndodh në momente të një gëzimi të madh apo të një zemërimi a dëshpërimi po të madh. Kështu ndodh me De Radën, kur në një moment dëshpërimi, me anë të një letre më 20 prill 1893, të shkruar në Maki për De Gubernatisin, ndër të tjera shprehet: *Në moshën 20 vjeçare, pa e kuptuar ndërmora një vepër shumë më të madhe se mundësitë e mia. Larg prej mëmëdheut që nuk e njihja asfare, i lindur në një shtëpi të vogël, (nuk i kalonte 100.000 lira të ardhura) dhe në fshatin më të vogël italo-grek, mendova të restauroj gjuhën e vendlindjes sime dhe t'i ktheja racës sime dashurinë për të. Sed est Deus in nobis. Një shëndet i veçantë, një qëndrueshmëri e paepur, megjithëse nuk ushqehej nga ndonjë shpresë, kursimet e vogla që arrita të mbledh, ose* që më kishin lënë të parët e mi, lavdërimet e mëpasshme nga personalitete të shquara – Lamarttine, Tomaseo, Cantu, De Gubernatis,- s'më lanë të hiqja dorë... Ju e shihni Kont i nderuar sesi me pak gjë (E ka fjalën për 500 lirat e pagës qeveritare në vit për leksionet e shqipes në San Demetrio) as me korrespondencën e gjerë me mëmëdheun, as nevoja e botimit të leksioneve për t'i bërë të përbashkëta për të gjitha kolonitë italo-greke mund të më mbushin si një jetë e vërtetë ... Tani për tani unë eci në via exulis.. Përpjekjet për ta bërë të njohur Shqipërinë duke e lidhur me Italinë, i shoh të më shkërmoqen nëpër duar...Pamundësia është mbështjella që i hëngri zemrën Prometeut, por nuk më ka përkulur.[3]

Ky dëshpërim, madje i avancuar në kufijtë e zemërimit, do ta karakterizojë autorin edhe dy vjet më vonë, siç duket nga letra tjetër e datës 16 qershor 1895, si më poshtë: *E ç'të them për veten, trashëgimtar i mërguar që predikoj në shkretëtirë. Me Gramatikën dhe Konferencat ...500 lira dhe deri tani kam marrë 166. Nuk e di si do ta gjykojë Zoti punën e mendjes sime përderisa gjithnjë e më shumë ndiej Omnia vanitas.*[4] Në këtë letër De Rada nuk e përmend Prometeun, por, siç mund të shihet, ai me zor e përmban zemrimin ndaj Zotit, i cili, me sa duket, nuk i paska gjykuar mirë punët e mendjes së tij (De Radës). Ky zhgënjim në fund të jetës anullon edhe ndjenjën e mitit të profetit të dërguar nga Zoti për të ringjallur gjuhën shqipe dhe kombin shqiptar. Prandaj pikërisht në këtë moment dëshpërimi (më vonë zemërimi) ndjenja dhe figura e Prometeut çlirohen nga tabuja dhe De Rada shfaqet në profilin e vërtetë të modelit prometeik.

Kështu, ndërmjet imazheve alternative të *kalorësit të mrekullueshëm*, *profetit* apo *Prometeut*, është De Rada që përfundimisht e përcakton veten Promete, duke u vetëçliruar nga tabuja dhe duke u shfaqur në këtë mënyrë me madhështinë e figurës së kontribuesit nismëtar dhe të pashoq në rilindjen e gjuhës, kulturës dhe kombit shqiptar.

2-Silueta prometeike e De Radës

Ky ballafaqim i pamundur i të dyja figurave (profetit dhe Prometeut) flet, pa diskutim, për epërsinë e Prometeut brenda personalitetit dhe përjetueshmërisë së De Radës. I artikuluar nga vetë poeti në dhjetëvjeçarin e fundit të jetës, ky vetëpërcaktim në masën prometeike është i atillë, që e mbulon gjithë veprimtarinë dhe përpjekjet intelektuale të tij në favor të gjuhës shqipe dhe të rilindjes së kombit shqiptar. Evokimi i këtij përkushtimi nis që në zanafillë, kur ai ishte 20 vjeçar, e deri në momentin kur po flet (*Tani për tani..., i shoh...,por nuk më ka përkulur*). Siç shihet, koha gramatikore e referencës së Koliqit (nga e tashmja në të kryerën), përkon me kohën reale prej afro 70 vjetësh, gjatë së cilës u shkrua vepra deradiane. Madje, shprehja *Tani për tani*, si leokucion ndajfoljor, përmban kuptimin e kundërvënies të së tashmes (që po kalon autori) me të ardhmen (që do të jetë ndryshe). Në këtë kuptim, ky leokucion ndajfoljor përcjell të nënkuptuar edhe dimensionin e së ardhmes optimiste të De Radës Promete. Është pikërisht ky optimizëm që e motivon qëndresën e tij prometeike (...*por nuk më ka përkulur*).

Kështu që nga ky moment shfaqjeje në dhjetëvjeçarin e fundit të jetës ne shohim anën tjetër të medaljes, përsa i përket figurës së De Radës, dhe kjo s'është gjë tjetër, veçse silueta e Prometeut, të cilën ne e kemi ndjerë përgjatë gjithë përsiatjeve në kërkim të profilit të vërtetë të tij. Është përsëri vetë ai, De Rada, që na e ndriçon këtë profil. Ai s'mund të bënte më shumë se kaq, përveçse të na krijonte për veten idenë e siluetës prometeike. Dhe, që nga momenti i perceptimit të kësaj siluete, ne s'na mbetet gjë tjetër, veçse të bëjmë detajimin e saj. Më tej do të shohim figurën e plotë prometeike të heroit të gjuhës shqipe dhe mbarë Rilindjes Kombëtare, figurë të cilën De Rada e çliroi prej qenies së tij në kushtet e një dëshpërimi të madh për atë që, sipas tij, s'ka mundur të arrijë (...*Pamundësia është mbështjella që i hëngri zemrën Prometeut, por nuk më ka përkulur*), por edhe për mosvlerësimin e kësaj pune titanike (*E ç'të them për veten, trashëgimtar i mërguar që predikoj në shkretëtirë. Me gramatikën dhe Konferenca ...500 lira dhe deri tani kam marrë vetëm 166. Nuk e di si do ta gjykojë Zoti punën e mendjes sime përderisa gjithnjë e më shumë ndiej Omnia vanitas*).

Në vazhdim të detajimit, në konturet e siluetës prometeike të De Radës, të cilën thamë se e kemi ndjerë përgjatë gjithë kërkimit tonë, ne fillimisht duhet të kemi ndriçuar ndjeshmërinë e veçantë ndaj fisit. Pa fisin ai ishte një njeri i zakonshëm, thjesht një mërgimtar i kahershëm, që ende s'e kishte ndjerë grupin, kolektivitetin etnik, të cilit i takonte shpirtërisht. Ndërsa me identifikimin e këtij kolektiviteti, në një klimë më se të përshtatshme të humusit etnik shqiptar, do të fillonte brumosja heroike e De Radës. Tani që e gjeti, ai do t'i bëhet heroi fisit të tij, për ta nxjerrë atë nga errësira ku ka rënë, duke manifestuar në shkallën më të lartë ndjenjën e përkushtimit vetëflijues. Ne duhet të kemi ndriçuar edhe ndjenjën e vetmisë krijuese. Është figura e heroit që veçimin dhe vetminë i ka të domosdoshme për përmbushjen e aktit të krijimit. Kjo përkon me imazhin e De Radës, që, për të përmbushur veprën e tij, tërhiqet në Makin e vogël, në mes të vreshtit, në kasollen e mobiluar me një stil të thjeshtë, ku s'ka se si të mungojë kandili me flakën dritësuese. Ky imazh i De Radës, perceptuar në dinamikë, lëviz kodrave të Makit, në distancë horizontale dhe vertikale, distancë kjo që s'është gjë tjetër, veçse hapësira e domosdoshme medituese romantike. (Jo më kot Prometeun e kanë quajtur si heroin e parë të romantizmit). Për t'u përfunduar, silueta prometeike e De Radës do të detajohet me dritësimin e brendshëm të poetit, qëndresën heroike, vizionin optimist për të ardhmen e deri tek zhgënjimi ndaj atyre që duhet ta vlerësonin punën e tij, përfshi këtu edhe vetë Zotin (*Nuk e di si do ta gjykojë Zoti punën e mendjes sime perderisa gjithnjë e më shumë ndiej Omnia vanitas*). A nuk ishte mosmirënjohja e njerëzve një ndër brengat e Prometeut dhe argument i kundërshtarëve për ta luftuar atë, pasi njerëzit nuk po e ndihmonin në hallin që kishte?

Silueta Prometeike e De Radës, e detajuar prej nesh si fytyra e vërtetë e tij, do të projektohet në veprën letrare, sikurse do të rrëfehet në *Autobiografinë* e tij vetë poeti dhe do të reflektojë gjithashtu e teorizuar edhe në *Parime të estetikës.* Ndër të tjera, në këto dy vepra De Rada vetëpërcaktohet edhe përsa i përket raporteve të veprës së tij artistike me realitetin. Sipas tij, këto raporte s'janë gjë tjetër, veçse raporte imitimi e referimi ndaj jetës dhe përvojës së tij.

1 J. de Rada. *Parimet e estetikës*, fq. 129.
2 J. de Rada. Vepra I, e cituar, fq. 154.
3 E. Koliqi. Vepër e cituar, fq. 147.
4 Po aty, fq 146.

Studiuesit dhe shkrimtarit Çapaliku i është dashur më shumë kohë për kërkime e hulumtime në Shkodër, në Durrës, si edhe në vendlindjen e artistit, në Itali.

RENZO COLLURA, NJË ARTIST I HUMBUR NË SHQIPËRI

Nga Ferid Hudhri

"Renzo Collura..." është libri i parë kushtuar një artisti të huaj që ka jetuar dhe pikturuar në Shqipëri. I ardhur nga Agrigendo e Sicilisë, piktori italian Collura i kaloi vitet shqiptare në mjediset e Shkodrës dhe të Durrësit. U miqësua dhe bashkëpunoi me artistë të ndryshëm të asaj kohe. Pikturoi afreske në Kishën Franceskane. Krijoi portrete dhe peizazhe nga natyra. Realizoi edhe skenografi për shfaqje teatrore. Dy vitet e fundit të qëndrimit në Shqipëri (1945-47) Renzo Collura organizoi dhe drejtoi kurse artistike, i ngarkuar nga Ministria e Kulturës Popullore në Tiranë. Ndërsa në verën e vitit 1947 u largua përgjithmonë duke u ndarë përfundimisht edhe nga krijimet me temë shqiptare. Në Durrës la "studion e tij e vogël", ndërsa nëpër shtëpitë shkodrane i mbetën disa nga portretet e porositura prej familjarëve vendas.

Me fillimin e "luftës së ftohtë" humbën të gjitha lidhjet me miqtë e tij në Shkodër dhe në Durrës. Ndërsa nga "pushteti" i artit të ri të realizmit socialist në Shqipëri tablotë e artistit italian mbetën në hije. Pikturat e tij nuk mund të ekspozoheshin apo të komentoheshin. Por, ndonëse nuk u shkrua thuajse asnjë fjalë për veprat e artit, Collura përmendej në bisedat familjare në Shkodër, sidomos në ato shtëpi ku ruheshin tablotë që kishte pikturuar. Vetë autori i këtij libri, Stefan Çapaliku na dëshmon se e ka ndeshur emrin e artistit që në moshë të vogël. Te shtëpia e axhës së tij në Shkodër ruhet një nga veprat më të bukura që Collura ka pikturuar në Shqipëri.

Por, për realizimin e librit kushtuar këtij artisti, që doli nga shtypi në janar të vitit 2021 (74 vjet pas largimit në Itali), pas një heshtjeje të gjatë rreth veprimtarisë artistike dhe në mungesë të ish miqve dhe bashkëkohësve, studiuesit dhe shkrimtarit Çapaliku i është dashur më shumë kohë për kërkime e hulumtime në Shkodër, në Durrës, si edhe në vendlindjen e artistit, në Itali.

Libri i sapo botuar na jep informacion të pasur, foto të panjohura, imazhe të veprave të artit, letra, kartolina e shënime të ndryshme, si dhe intervistën me artistin Athos Collura, djalin e Renzo-s. Të gjitha së bashku e krijojnë më të plotë atmosferën e kohës kur jetoi dhe pikturoi, na e sjellin më të qartë personalitetin e artistit. I njohur për gjetje të bukura artistike ne krijimet e tij letrare e skenike, edhe në këtë libër arti Çapaliku na sjell një strukturë të veçantë, me një formulim grafik tërheqës, të pasuruar me imazhe të bukura.

Autori e përshkruan se si ndikoi edhe tradita e kulturës shqiptare përmes krijimtarisë së artistëve të njohur të Shkodrës (Idromeno, Marubi, Martini, Rrota, Kolombi, Kabashi, Jani etj). Për Shkodrën mund të shtojmë gjithashtu se ka qenë prej shumë e shumë kohësh mjedisi më tërheqës për artistët e huaj. Aty Edward Lear krijoi disa nga akuarelet më të bukura kushtuar gruas me kostum shkodran, urës mbi Drin, kalasë Rozafa dhe shumë motive të tjera. Edith Durham para se të vizatonte dhe të pikturonte nëpër trojet shqiptare shkroi se Shkodra ka ngjyrë, ka art. Kur erdhi në Shkodër piktori i njohur i temave shqiptare P. Jovanovich vizatoi bashkë me Idromenon nëpër rrugët e qytetit. Po ashtu kanë jetuar dhe krijuar në kryeqendrën e veriut shqiptar edhe artistë të tjerë austriakë, anglezë, gjermanë, francezë, italianë, çekë, rusë, serbë, hungarezë, bullgarë dhe nga vende të tjera të botës. Në muajin prill të vitit 1918 në Shkodër u hap ekspozita e parë me vepra të tre autorëve të huaj (Horovitz, Pravotinski dhe Beszedes), që shënohet si e para veprimtari arti që është organizuar në Shqipëri. Midis gjithë këtyre veprimtarive të autorëve të huaj përfshihen edhe pikturimet e artistit italian, të parqitur me një stil tërheqës nga Stefan Çapaliku.

Libri "Renzo Collura, një artist i humbur në Shqipëri/ un artista disperato in Albania" (i botuar në shqip dhe në italisht) e paraqet të plotë jetën dhe veprimtarinë e piktorit italian për lexuesit e të dy vendeve ku jetoi dhe krijoi.



Stefan Çapaliku

Renzo Collura



Lamtumirat

tregim nga

SHQIPTAR OSEKU

Vdekja është e vështirë për njerëz të moshuar, mama. Prandaj kur zonja Ana më tha që të shkoj me të, nuk i thashë jo. Ajo kishte dalur me Ronjën për shetitje lamtumirëse në parkun e mbuluar nga bora ndërsa unë po kthehesha nga shkolla. Ta them të drejtën më pëlqente të shetisja me to. Ecnin ngadalë, duke u ndalur shpesh, që Ronja të nuhaste përreth. Parku është i bukur në dëborë. Por unë i kam fucking zët shetitjet lamtumirëse, lamtumirat në përgjithësi. Po ta kisha ditur punën do të kisha gjetur një justifikim për t'u larguar, të betohem.

Por si thashë, nuk e dija. Në pamjen e tyre s'kishte asnjë paralajmërim të asaj që do të ndodhte më vonë. Ana kish veshur pallton e vet të vjetër gri, e atë kësulën me lulka të kuqe që ulërin nga larg se kjo grua është me halle. Ronja mezi ecte. Kur u afruan, pashë që Ana kish mbathur atletet që i kisha falur muaj më parë. Ajo m'u qas pothuaj te fucking hunda, të betohem. M'i nguli sytë e vet blu matanë ca syzesh të trasha si fund botilesh, e më pyeti si kam qenë. Mbante erë si rëndom, shurrë e alkool. Mirë, i thashë, ti si ke qenë. Nuk duhej ta kisha pyetur, por ku di unë. Ajo është më e moshuar.

Nuk jam mirë, më tha. Duhet ta çoj Ronjën te veterinari. Ronja ish ulur në borë, me kokën varur, sikur e dinte. Këto dy muaj të dimrit Ronja ish lodhur a plakur shumë, nuk di si thuhet për qen. A thuhet u plak për një qen?

Kur patëm hyrë te ky apartamenti ku jemi tash, babi e unë, Ronja luante me mua në kopshtin e pallatit. Ajo vraponte për të marrë gjithçka që gjuaja, top, dru, këpucë të babit, e ma sillte te këmbët që ta gjuaja prapë. Babi s'ishte dhe aq i gëzuar kur gjente këpucët e grisura nga dhëmbë labradori, hahah. Por Ronja dhe unë bënim kokrrën e qejfit. Ana asokohe banonte në apartamentin sipër nesh, me një burrë që s'e shihnim kurrë. Ajo asokohe nuk ishte ende grua me halle. Dilte në dritare dhe më pyeste, a do të luash me Ronjën. Unë i thoja gjithmonë po. Atëbotë Ana nuk mbante syze.

Mua më pëlqente të luaja me Ronjën kur isha e vogël, se babi është me nerva. Ose jo me nerva, po s'di, me depresion ndoshta. A me ankth, s'di. Ai kish qenë në luftë dhe nuk ndihej mirë. Ti mami kishe ikur që prej mbarimit të luftës, ai është rrëfim tjetër. Unë s'kam kujtim tëndin. Ronja për mua qe si mama e dytë, a si të them. Dakord ky qe teprim, por Ronja kishte, s'di, një si instinkt të mamasë, besoj. Ku ta di unë se ç'është ky instinkt? Por Ronja s'më linte të dal në rrugën ku bënin kërdinë veturat, ta zëmë. Ngrente gjithë fucking lagjen në këmbë sa nisesha andej, të betohem. Atëhere isha e vogël, pesë-gjashtë vjeç. Mbaj mend që luanim princesash dhe Ronja ishte gjoja kali im i zi; babi ka një video të vjetër ku unë mundohem të kalëroj mbi Ronjën. Ose e bëja princeshë edhe Ronjën si veten, me dantella e diademë. Veç të na kishe parë!

Mandej unë nisa shkollën e s'kisha kohë të luaj me Ronjën. Babi është shumë nevrik rreth shkollës, s'di si të them. Ose jo nevrik, po do shumë që të kem nota të mira. Ronja lehte përditë jashtë dritaresh dhe nganjëherë babi më linte të luaj, por më shpesh duhej të bëja detyrat. Shkolla të hap sytë, më thonte, ndonëse detyrat mua më mbyllin sytë e më hapin gojën. Shkolla të bën njeri, më thonte. Kjo më dukej për të qeshur, pse a s'qenkam njeri tashmë? Çfarë qenkam pra, labrador?!

Por pushimet e verës ishin super, se mund të luaja prapë me Ronjën. Kur u rrita ca, Ana më la edhe ta shetis Ronjën. Ronja kish nisur të plaket, a çfarë thuhet për qentë, që atëhere. Nuk është se vraponte më mbas veturash, a bicikletash. Nuk u lehte më as qenve tjerë. Asaj i pëlqente të ecte ngadalë, e të nuhaste me nge shurrosje të qenve tjerë, te ky parku ynë mbrapa pallatit. Kjo është mënyra si komunikojnë qentë, këtë e kemi mësuar në biologji. Spërkasin me shurrë për të markuar habitatin e vet. E bëjnë më fort qentë meshkuj, mësuesja thotë se meshkujt e kanë zakon të pshurrin strehën e vet hahah. Ajo është e divorcuar. Por Ronja nuk bënte shurrën, vetëm nuhaste shurrosjet e qenve tjerë. Kjo është sikur SMS i qenve, ku di unë. Tjerë që dilnin me qen kishin nxitim, e tërhiqnin qenin zvarrë për kollare. Unë jo, të betohem. Unë kam respekt për SMS të tjerëve. Kur dilte me mua, Ronja mund të mirrte gjithë kohën që i duhej, për të nuhatur çdo njollë të verdhimtë që na dilte para.

Babi më thotë ende nganjëherë se unë s'i rrok metaforat. Ai thotë se them shpesh fucking, e betohem, e se kjo më bën të tingëlloj më e vogël se ç'jam, dhe e pasigurt. Ndoshta ka të drejtë, s'di, por tash jam pesëmbëdhjetë vjeç. Mund të them fucking sa fucking herë të dua, kur s'dëgjon babi. Por unë betohem se babi e ka gabim kur thotë se qentë nuk zhvillojnë intelekt më shumë se fëmija tre vjeç. Gjindja mund të thonë çfarë të duan. Por Ronja mua më kuptonte më mirë se njerëzit. Ajo ishte shoqja ime më e mirë. Më saktë, shoqja e vetme. Të jesh bija e një veterani me PTSD, nuk është se të bën yll të shkollës. Ronja s'lodhej pse unë kisha rroba të pista, flokë të pakrehura, atlete të vjetra. Ajo ishte gjithmonë aty për mua, mama.

Në atë kohë Ana nuk mbante erë. Por jeta e saj mori teposhtëzën, a si ta quash, kur i vrau veten burri. Një rast i tmerrshëm, ky. Sa marr vesh, Ana dhe Ronja e kishin gjetur burrin të varur në dhomë të ditës, a diçka të ngjashme. Unë s'e kisha parë kurrë atë njeri, s'di as sot si dukej. Por mbaj mend ambulancën para portës, e komshitë e mbledhur aty jashtë. Sa vjeç isha, nëntë? Dhjetë? Mbaj mend Ronjën që rrinte veshulur pranë Anës, e Anën që ulëriste emrin e tij, Mark, Mark, si më le kështu. Burri i saj paskësh patur emrin Mark. Infermierët mbyllën dyert e ambulancës, Ana po bërtiste Mark, Mark, nga brendësia e ambulancës, ambulanca iku. E Ronja ngeli jashtë, ulur në të pasmet. Një qen tjetër do të vraponte mbas ambulancës, të betohem, por jo Ronja. Babi im mund të fucking thotë çfarë të dojë. Ronja ishte më e urtë se shumë njerëz.

Ana s'u këndell më nga ai rast. Është rrëgjuar, thonte babi, është bërë alkooliste. Por si bëhet njeriu alkoolist brenda natës? Ndoshta Ana ish e pikëlluar pse burri e kish lënë ashtu, e ndoshta rakia e bënte të harrojë. A ndoshta vetëvrasjet i bëjnë gjindjen të ndiehen fajtorë, ku di unë. Ndoshta Ana kish frikë të jetojë në një banesë ku dikush kish vrarë vetën. Unë do të kisha shumë fucking frikë të banoj aty. Ndoshta rakia i jipte Anës zemër. Por lekë s'i jipte, Anën e flakën më vonë me zor nga apartamenti ca policë. Komshitë thonin se ajo s'kish paguar qiranë, e se orenditë e Anës i kish marrë qiradhënësi si zhdëmtim. Kjo dmth në vend të qirave të papaguara. Unë s'isha aty atë ditë, por komshitë thanë se Ronja kish ndjekur Anën veshulur, thuase e kish kuptuar se çfarë po ndodh. Thuase e kish ditur se aty e tutje do të flenin përfundi urash, a si i thonë fjalës.

Ana e Ronja nuk u zhdukën krejt. Ato kthenin shpesh te oborri i pallatit. Biles javët e para fjetën në qilarët poshtë pallatit, babi më çonte poshtë me pak ushqim për to. Por qiradhënësi pikasi kartonët e plaçkat e tyre dhe ndërroi gjithë dryrët. Kështuqë ato zunë të flejnë gjetkë, te një vend me pamje të bukur thonte Ana, por kthenin përnatë në oborr për të marrë pak ushqim nga babi. Të dyjat u plakën shumë vjet për pak muaj, s'di si të them. Anës nisi t'i vinte era shurrë. Ronjës i dukeshin kockat nën lëkurë. Ajo më lëpinte fytyrën, por nuk ishte me humor si dikur. Kur e mirrja ta shetis ecte kokëvarur, nuk nuhaste as njollat e verdha. Më vjen keq ta them tash mama, por unë nisa t'i shmang. S'mund të dal se kam detyra shtëpie, i thoja babit, dhe ai s'e zgjaste më tej. Më vjen keq ta them, mama. Por unë ndihesha keq, kur vinin Ana e Ronja në oborr.

Edhe tash, kur Ana me kësulën po më thonte prej matanë botilash të trasha se do ta çonte Ronjën te veterinari, e Ronja rrinte ulur sus me të pasmet në borë, kokëvarur, u ndiva njësoj keq. Instinkti im i parë ishte që t'u shmangem prapë, "kam detyra matematike". Të rriturit pranojnë gjithmonë këtë argument. Por Ana sikur parandiu se çfarë do t'i thoja, e më tha se kish nevojë për ndihmën time. A vjen me mua të marrim plakat e Ronjës, më tha. Unë s'kisha parë se ku jetonin, atë vendin me pamje të bukur, e u ndieva kureshtare. Dakord, i thashë. Kam detyra matematike, por i bëj më vonë.

Dhe kështu pashë, mama, se ku kishin banuar Ana e Ronja këto vitet e fundit. Ecëm pothuaj dy orë, të betohem, minimumi. Ecëm sa lamë pas nesh parkun, paralagjet me pallatet e rrjeposura, filloren ku shkoja dikur, gjimnazin ku shkoj tash, e ecëm më tej akoma, në vise ku s'kisha qenë kurrë më parë. Në fund, doli që Ana dhe Ronja s'banonin përfundi një ure. Ato banonin në një livadh të gjerë jashtë qytetit, matanë një gardhi me telagjemba, në një si pleme a ahur me trerë të kulmit të rënë brenda, me një si traktor të braktisur e të ndryshkur, si të mbytur në dëborën përjashta. E kam një fotografi të atij vendi, që ti s'do ta shohësh kurrë, mama.



Aty morëm plaçkat e Ronjës, që ishin në një karrocë shitoresh, si në filma. Një qese plastike, ku ishin ca fotografi të vjetra të Ronjës si këlysh i vogël. Lodrat e saj, sa kish qenë këlysh. Ana i kish ruajtur të gjitha. Aty ishte edhe diadema që i kisha vënë dikur, kur luanim princeshash në oborr. Ana i kish ruajtur mama, të betohem. Të gjitha.

Kur u nisëm të kthehemi, unë kuptova më në fund se çfarë do të bënim te veterinari. Se kjo s'ishte vizitë e zakonshme, për fucking vaksinë a ku di unë. Kuptesa më erdhi ngadalë, gjersa po ktheheshim të njëjtën rrugë nga e cila kishim ardhur, përskaj gjimnazit, fillores, pallateve të rrjeposura, si kur zgjidh gradualisht një detyrë të vështirë matematike. Por kur më gdhiu e vërteta, ajo ish e plotë dhe pa asnjë mundësi gabimi a keqkuptimi. Ekuacion i qartë.

Ordinanca e veterinarit ishte në hyrje të lagjes sonë, një zyrë në nivel përdhesë tek një prej atyre pallateve që kishim kaluar. Të premtoj mama, kjo qe hera e parë që vura re, që vura re përnjëmend, sa të vjetra e të përlyera që ishin këto pallate ku banonim. Brendësia e ordinancës ishte si kur shkon te dentisti, veçse afishet nuk shfaqnin fëmijë e të rritur të lumtur, por qen e mace me gëzof të shkëlqyer. Pak ironike, po ta mendosh arsyen e vizitës sonë. Veterineri ishte një grua, që më pyeti nëse unë doja të marr pjesë në ndarje. Të betohem mama, kështu e quajti. Fucking ndarje. Ana i tha po, do të marrë pjesë. Kjo është shoqja më e mirë e Ronjës, tha ajo.

S'kam pse të flas në detaje për atë se çfarë ndodh në raste të tilla, mama. Veç po them se hymë në një dhomë gri, ku një llambë fluorescente ndriçonte me ndërprerje. Ana e uli Ronjën e ulën në një shtrat barrelë mbi rrota. Ronja e dinte, të betohem e dinte, se çfarë po ndodh. Unë i vura diademën e princeshave në kokë. Ajo më lëpiu një dy herë fytyrën, pastaj lëpiu dhe fytyrën e Anës. Mandej vari kokën mbi putrat e parme, e ashtu priti injeksionin. Kur doli veterineri, Ana dhe unë ngelëm një copë herë të gjatë aty, mbi trup të Ronjës, ndërsa ky po ftohej. Dikur më vonë, s'di, mbas dhjetë minutash a gjysëm ore, veterineri hyri prapë, e na premtoi se do të kujdeset për trupin e Ronjës. Ronjën e puthëm dhe një herë të fundit. Mandej e lamë aty, në barrelë, me lodrat dhe diademën mbi kokë.

Kur dolëm, Ana m'u lut mua që t'i ruaj fotot e veta të vjetra të Ronjës si këlysh. Ato i ruaj tash në një kuti këpucësh nën shtrat, bashkë me foto të mia të vjetrat me babin. Anën s'e kam parë më që atë ditë, mama, dhe kam një si frikë se çfarë mund të ketë ndodhur me të. Kur nuk erdhi për të marrë ushqim si rëndom atë mbrëmje, babi më pyeti nëse dija gjë dhe unë i dëftova se ç'kish ndodhur. Vura re se ai u trondit, mama. Fytyra i mori atë pamjen që i merr kur flet për luftën, mama, a kur hesht për ikjen tënde. Supozoj se në botën e tij të gjitha janë pjesë të një rrëfimi të madh. Lufta, ikja jote, vdekja e Ronjës, zhdukja e Anës. Supozoj se për të, të gjitha lamtumirat e ndara janë të ndërlidhura me fije të holla të padukshme.

Mbas disa ditësh, babi më pyeti nëse mund ta gjeja atë plemen a ahurin në mes të livadhit dhe unë u mundova vërtet ta gjej mama, të premtoj që u mundova. Të dy u munduam. Ecëm me babin me orë të tëra, dy a tri a katër orë, s'di, sa u mërdhimë në të ftohtët e dëborën që mbulonte paralagjet e qytetit. Pyetëm njerëz, pyetëm policinë. Por atë plemen a ahurin a si ta quaj me traktorin e mbytur në dëborë nuk e gjetëm dot. Ishte thuase s'kishin ekzistuar kurrë. Dhe Ana poashtu. Babi thotë se Ana mund të ketë vdekur, mund të ketë mërdhirë nga të ftohtit. Unë kam frikë se ka vrarë veten, si Marku i saj.

Është pak e frikshme mama, të banosh nën një apartament që mund t'i ketë vdekur tre banorë të dikurshëm. Por aty tashti banon një familje, dy prindër me dy fëmijë. Ndoshta apartamenti i pëlqen ata më fort se banorët e vet të mëparshëm. Uroj të jetë ashtu.

Nuk e di si bëhet kështu mama, që gjindja zhduken pa gjurmë. Njerëz, qen. Persona që të kanë dashur. Pse u zhduke ti? Unë nuk kam asnjë kujtim të hershëm nga ti. Ndoshta ishte zor të kujdeseshe për një fëmijë si unë, s'di. Babi thotë shpesh se unë i shkaktoj kokëdhimbje. Ndoshta të shkaktoja edhe ty. Ose ndoshta ishte zor të ishe me babin, ai ka probleme. Flet netve për luftën, e për gjindjen që zhduken, dhe mua më bëhet se s'flet me mua po me vetveten.

Kjo pra është arsyeja pse u vura të të kërkoj, mama. E pse të gjeta, më në fund. Le ta them edhe këtë, që të mos ngel asgjë e pathënë midis nesh. Të kam kërkuar dalë-ngadalë, gradualisht, sikur zgjidh njeriu një detyrë të zorshme të matematikës. Dhe të kam gjetur, më në fund. E di pallatin e rrjeposur ku banon, në anën tjetër të qytetit. E di dhe burrin me të cilin jeton. E di që ke një tjetër vajzë të vogël me atë burrin. Ju kam parë bashkë, në oborr të pallatit.

M'u duke e lumtur, s'di. Por unë s'të qasem ty, as motrës sime. Të thashë që në fillim mama, unë i kam fucking zët lamtumirat. Lamtumirat në përgjithësi. Lamtumirat që thuhen, e lamtumirat e pathëna. Ku është fucking dallimi?

Vetmia e syve të qenit

tregim nga

NASI LERA

Mban mend t'i ketë dashur ndonjëherë qentë? – tha si e trembur në gjumë gruaja.

Burri bëri sikur nuk e dëgjoi. Djali i tyre nuk i kishte dashur kurrë qentë. Burri ishte i bindur për këtë. Ai nuk e harronte ditën kur sa nisi të tregonte për një natë me dëborë, kur i ati i kishte sjellë një qen që polli katër këlyshë, i biri ia preu shkurt:

- Nuk ke kujtime të tjera që vetëm historinë e qenit që polli katër këlyshë më ke treguar gjithë jetën!

Burri e donte atë kujtim. Ai ia sillte përherë të gjallë të atin. Ditën që i biri ia preu shkurt, atij iu duk sikur bashkë me kujtimin e asaj nate me dëborë, i vdiq edhe i ati. Ai e kuptoi këtë kur të nesërmen filloi t'i tregojë një mikut të vet si i kishte vdekur babai. Asnjërit nuk i kishte treguar si i kishte vdekur babai, të gjithëve u kishte treguar si i kishte sjellë një natë dimri me dëborë një qen që i kishte pjellë katër këlyshë. Këlyshët kishin kohë që kishin vdekur e megjithatë vazhdonin të lëpinin vitet me gjuhët e tyre të vogla, të kuqe dhe të shihnin muajt me sytë e tyre të pafajshëm. Burrit iu duk sikur ata po lëpinin edhe lëkurën e butë të asaj nate dhe u çua ndenjur.

- Çfarë po mban vesh? – tha gruaja.

- Asgjë, - tha burri.

Dhe nuk guxoi t'i thoshte të vërtetën. Atë natë do të ishte i lumtur sikur t'i tregonte edhe një herë gruas kujtimin e tij më të bukur. Por se pse pati frikë se ajo do t'ia priste shkurt, siç ia kishte prerë i biri para katër vjetësh. Dhe e ndrydhi përbrenda natën kur i ati i solli një qen që të nesërmen i polli katër këlyshë. Megjithëse kishin vdekur, këlyshët vazhdonin të lëpinin me gjuhët e tyre lëkurën e netëve. Ishte një zhurmë e lehtë, e ëmbël, që përveç burrit nuk e dëgjonte kush. Ata kujtojnë se është era, thoshte me vete burri. Atij i vinte keq që ata kujtonin se ishte era, sepse i dukej sikur nuk kishin asnjë kujtim si kishte ai kujtimin e një nate dimri me dëborë, kur i ati i solli një qen që të nesërmen i polli katër këlyshë. Ai kujtim ia sillte përherë të gjallë të atin. Sa sy të butë dhe të ngrohtë kishte babai, tha me vete dhe i erdhi keq që kishte folur në kohën e shkuar për të. Ai e ndjeu menjëherë veten të lodhur. Donte të çohej, por e dinte se do të mërzitej më shumë. Prishja e kujtimit ia kishte zvogëluar botën. Ajo po bëhet përherë dhe më e vogël sepse po vdesin kujtimet, tha. Dhe një botë e vogël është gjithmonë një botë e vetmuar, është një kub akulli që e nxjerrin nga frigoriferi dhe e shkrijnë në një gotë me ujë.

Burrit po i zihej fryma. Në dhomën ngjitur flinte i biri dhe qeni që ai kishte sjellë me vete. Ishte një qen i rrallë, me veshë të mëdhenj dhe me dy sy... Burri lëvizi tërë zhurmë. Ai nuk donte të sillte ndërmend sytë e qenit që flinte pranë të birit. Nuk e kuptoj përse e solli, kur ai nuk i ka dashur kurrë qentë. Sa tha kështu iu kujtua kur u hap dera dhe, para se të hynte i biri, hyri tërë frikë dhe habi qeni i vogël. Sytë e tij ishin të mbushur me frikë. Pak po t'i bërtisja kishte për t'u strukur nën karrige dhe kishte për t'u dridhur. Përse u meka dhe nuk i fola as edhe një fjalë? Kur më solli babai qenin që më polli katër këlyshë, u hodha përpjetë nga gëzimi dhe babai më shihte i lumtur që kërceja përpjetë nga gëzimi. Atë natë babai i kishte sytë më të ëmbël dhe më të butë se çdo natë tjetër.

- Mban mend t'i ketë dashur ndonjëherë qentë? – pyeti përsëri gruaja.

Burri nuk mund të shtirej më sikur nuk e kishte dëgjuar.

- E ç'rëndësi ka kjo? – tha.

- Mua nuk më kujtohet t'i ketë dashur ndonjëherë, - tha gruaja.

- E ç'rëndësi ka kjo, - përsëriti burri. – Njeriu nuk do diçka dhe më vonë, papritur, e do.

- E di, - tha gruaja, - kjo më ka ndodhur edhe mua.

- Kjo i ndodh çdo njeriu, - tha burri.

Gruaja heshti. Nata ishte tërë dritë.

- Ia pe me kujdes? – tha gruaja dhe nga zëri burri e kuptoi se asaj do t'i pëlqente që ai të mos kishte parë me kujdes.

- Çfarë? – tha pavetëdije burri.

- Sytë...

- E kujt? – pyeti burri mbasi gruaja heshti dhe nuk foli.

- Sytë e qenit.

- I pashë, - tha burri.

- Si t'u dukën?

- Si m'u dukën!

- Po.

- Nuk e mbaj mend si m'u dukën, - gënjeu burri.

Sytë e qenit kishin brenda tyre vetminë. Ai e kishte vënë re menjëherë këtë dhe kishte ndjerë një ndrydhje të dhimbshme në kraharor. Vetmia e syve të qenit nuk e la t'i gëzohej të birit që kishte dy vjet pa e parë. Ai do qëndronte vetëm katër ditë dhe do largohej përsëri. Burri mezi e kishte pritur ardhjen e të birit. Megjithëse i biri i kishte vrarë kujtimin e tij më të bukur, kujtimin e asaj nate dimri, me dëborë, kur i ati i solli një qen që i polli katër këlyshë. Kishte vite që i biri ishte kthyer në e vetmja dashuri e tij. Këtë e ndjeu kur ai u largua dhe e mori për herë të parë në telefon. Burri ishte tronditur aq shumë sa iu mek zëri. Nga sa larg vinte zëri, kishte thënë duke u përpjekur të mbulonte mekjen që kishte ndodhur para së shoqes. Vetëm vetmia e përcjell zërin nga aq larg, kishte shtuar me vete.

- Po mua përse m'u dukën ashtu? – foli përsëri gruaja.

Burri nuk e pyeti si i ishin dukur. Pyetja mbeti e varur pas dritës së hënës që kishte mbytur dhomën.

- Po mua përse m'u dukën ashtu? – ngulmoi përsëri gruaja. – Ai më pa sikur do ta dëboja.

- Kush? – tha i hutuar burri.

- Qeni, - tha gruaja. – Ai më pa tërë frikë sikur do ta dëboja.

- Ndoshta nga që është i vogël, - tha burri.



- Jo, - tha gruaja, - qentë e vegjël nuk i kanë ashtu sytë.

- Ti nuk ke mbajtur ndonjëherë qen, - tha burri.

- Po kam parë tërë ata qen të vegjël dhe asnjë nuk e ka pasur vështrimin aq të lodhur dhe të vetmuar.

- Ai ka ardhur nga larg, - tha burri. – Për të ardhur deri këtu e kanë ndarë nga këlyshët e tjerë.

- Ta ketë pasur nga ndarja? – tha gruaja.

- Patjetër, - tha burri.

- Do ta marrë përsëri me vete kur të ikë?

- Nuk më tha gjë dhe unë nuk e pyeta.

- Më mirë ta lerë këtu, - tha gruaja.

- Ai vetëm më tha se e kishte gjetur në dëborë duke qarë dhe e kishte marrë në dhomë sepse i erdhi keq. Ka një muaj që flenë bashkë.

- Po tjetër ç'të tha?

- Ishte i lodhur dhe e zuri gjumi.

- Po qenin kur e zuri gjumi?

- Në të njëjtën kohë.

- Sikur të mos e kishte ashtu vështrimin, do ta mbaja me qejf.

- Sa të mësohet me ne dhe nuk do ta ketë më atë vështrim, - tha i pasigurt burri.

- Sa mirë do të ishte sikur të mos ketë më atë vështrim, - tha gruaja. – Mua m'u duk sikur nuk do t'i ndryshojë kurrë. Të kujtohet sa vështrim të ëmbël ka pasur? Ti gjithmonë më pëshpërisje se ai kishte vështrimin më të ëmbël.

- Kush?

- Babai yt natën kur të solli qenin që të polli katër këlyshë.

- Atë natë po binte dëborë dhe kur binte dëborë babai e kishte vështrimin më të ëmbël se kur binte shi.

- Unë nuk do ta shoh dot në sy, kur të zgjohet, - tha gruaja.

Burri u shtang. Të njëjtën gjë po mendonte edhe vetë.

- E ka trembur largësia, - tha ai.

- Tërë atë vetmi nuk e fut dot vetëm një natë. Ai duhet të ketë qenë gjithmonë vetëm.

- Duhet të jetë trembur shumë kur e kanë lënë mes dëborës, - tha burri. – Ti nuk e merr dot me mend ç'do të thotë të mbetesh vetëm mes dëborës.

- Nuk e kam ditur ç'do të thotë të mbetesh vetëm mes dëborës, - tha gruaja. – Tani e di sepse e pashë në sytë e tij më mirë se sa po ta kisha provuar vetë.

- E, megjithatë, përsëri nuk e di, - tha burri. – Ti nuk ke qenë ndonjëherë e vetmuar mes dëborës.

- Isha kur pashë sytë e tij, - tha gruaja.

- Të gjithë qentë duken të vetmuar në dëborë, - tha burri. Ai harroi se qeni i tij kishte ardhur në një natë me dëborë.

- Bie shumë dëborë atje ku është djali? – pyeti gruaja.

- Bie, - tha burri.

- Bën ftohtë kur bie dëborë?

- Jo, - tha burri, - Ftohtë bën vetëm kur ajo ka pushuar së rëni dhe fillon të ngrijë.

- Kur gjeti qenin binte dëborë apo ajo kishte pushuar?

- Nuk e pyeta.

- Ta kishe pyetur, - tha gruaja.

- Harrova, - tha burri. – Do ta pyes kur të zgjohet.

- Më mirë mos e pyet, - tha gruaja e trembur nga ndonjë hollësi tjetër që nuk i shkonte në mendje atë çast dhe të cilën nuk donte ta mësonte.- Mos e pyet për asgjë!

- Mirë, - tha burri, - nuk do ta pyes për asgjë.

- Mos të shpëton goja dhe e pyet.

- Nuk do më shpëtojë, - tha burri.

- Se ti prekesh menjëherë, - tha gruaja. – Megjithatë ta kishe pyetur, në binte dëborë apo ajo kishte pushuar së rëni kur gjeti qenin.

- Përse shqetësohesh në binte apo kishte pushuar dëbora kur gjeti qenin? – tha burri.

- Nuk e di përse do të më pëlqente të kishte gjetur kur binte dëborë. Se kur bie dëborë njeriu nuk është aq i vetmuar se sa kur ajo ka pushuar dhe ngrin nëpër natë. Kam frikë se e ka gjetur kur nuk binte dëborë.

Burri heshti. Atij iu kujtuan sytë e qenit dhe vetmia e tyre. Tani e dinte kujt i ngjante ajo vetmi. Dhe për të larguar natën kur dëbora ngrin, u çua nga shtrati dhe eci drejt dhomës ku flinte i biri. Dikur, kur i prishej gjumi, shkonte dhe shihte mos ishte zbuluar i biri. Kur kapi dorezën e derës dora i ngriu, sepse iu kujtua se aty përveç të birit, flinte edhe qeni. Shtangu në vend dhe u kthye përsëri në dhomë, i lodhur, si të kishte bërë rrugën më të gjatë, më të vetmuar të jetës së tij, megjithëse kishte hedhur vetëm disa hapa në korridorin e vogël të shtëpisë.

Jorge Luis Borges
MREKULLIA E FSHEHTË

Tregim

Përktheu nga origjinali Mira Meksi

Dhe Zoti e bëri të vdiste për njëqind vjet; pastaj e ngjalli dhe i tha:
- Sa kohë ke ndenjur këtu?
- Një ditë, ose një pjesë të ditës, - iu përgjigj ai.
Kurani, II, 261

Natën e 14 marsit të vitit 1939, në një apartament në rrugën Zeltnergasse në Pragë, Jaromir Hladik-u autor i tragjedisë së pambaruar Armiqtë, i veprës Mbrojtje e përjetësisë dhe i një analize mbi burimet jo-tëdrejtëpërdrejta çifute të Jakob Boehme-s, pa në ëndërr një ndeshje të gjatë shahu. Nuk luanin dy vetë, por dy familje të shquara. Ndeshja kish filluar përpara shumë shekujsh. Askujt nuk i kujtohej çmimi i lojës, por pështpëritej se qe i madh e ndoshta i pafund; gurët dhe tabela e shahut ndodheshin në një kullë të fshehtë. Jaromir-i (në ëndërr) ishte djali i madh i njerës nga familjet kundërshtare. Orët gjëmonin çastin e fillimit të lojës – çast që s'mund të shtyhej dot më: ëndërruesi bridhte nëpër rërat e nje shkretëtire me shi dhe nuk arrinte dot të kujtonte as figurat dhe as rregullat e lojës së shahut. Në këtë pikë u zgjua. Zhaurrima e shiut dhe orët e tmerrshme pushuan. Nga Zelternegasse ngjitej një zhurmë ritmike dhe e njëzëshme, e cila pritej nga disa zëra urdhërues

Kishte zbardhur dita; pararoja e blinduar e Reich-ut të Tretë po hynte në Pragë.

Në ditën e nëntëmbëdhjetë autoritetet morën një denoncim; po në nëntëmbëdhjetë, në muzg, Jaromir Hladik-u u arrestua. E shpunë në një kazermë të bardhë e të sterilizuar, në bregun tjetër të Moldau-t. Nuk mundi të kundërshtonte dot asnjë nga akuzat e Gestapos: mbiemri i tij nga nëna ishte Jaroslavski, kishte gjak çifut, studimi i tij mbi veprën e Boehmes mbante erë hebraizmi dhe firma e tij mbyllte një protestë kundër Anschluss-it. Në 1928 kishte përkthyer Sepher Yezirah-un për shtëpinë botuese Hermann Barsdorf. Katalogu proliks i kësaj shtëpie botuese e kishte ekzagjeruar, për motive komerciale, famën e përkthyesit; këtë katalog shfletoi Julius Rothe, një nga shefat që kishte në dorë fatin e Hladik-ut. S'ka njeri që të mos i besojë lehtë gjërat që nuk janë të zanatit të tij: mjaftuan dy a tri mbiemra të shkruar me gërma gotike që Julius Rothe të bindej për superioritetin e Hladik-ut dhe të vendoste ta dënonte me vdekje, pour encourager les autres1. Ekzekutimi i vendimit u la për më 29 mars në orën 9 të mëngjesit. Kjo shtyrje e afatit (rëndësinë e së cilës lexuesi do ta vlerësojë më pas) i dedikohej dëshirës administrative për të vepruar në mënyrë pavetore dhe pa ngut, ashtu siç veprojnë bimët dhe planetet.

Në fillim Hladik-u u tmerrua. Mendoi se litari, sëpata apo thika nuk kishin për ta llahtarisur aq sa pushkatimi, i cili i ngjante i padurueshëm. Më kot u rrek t'ia mbushte mendjen vetes se i frikshëm qe vetëm akti i përgjithshëm i vdekjes dhe jo rrethanat konkrete. Nuk lodhej së imagjinuari tërë këto rrethana: në mënyrë krejt absurde arrinte t'i shkonte nëpër mend të gjitha variantet. E afronte pafundësisht procesin, që nga agu i pagjumë deri te breshërima misterioze. Përpara ditës që kish paracaktuar Julius Rothe, vdiq nga qindra lloje vdekjesh, në oborre me kënde që i kishin të gjitha format gjeometrike, i pushkatuar nga ushtarë të ndryshëm që u lëvizte numri gjithësaherë e që herë e vrisnin që nga larg dhe herë që nga shumë afër. I përballonte me një tmerr të vërtetë (ndoshta me një guxim të vërtetë) këto pushkatime imagjinare; çdo gjasmim zgjaste disa sekonda; kur mbyllej rrethi, Jaromir-i, kthehej pambarimisht në vigjiljet drithëruese të vdekjes së tij. Më pas mendoi se realiteti nuk para përkon me parashikimet; me një logjikë perverse arriti në përfundimin se po të parashikosh një detaj të rrethanave do të thotë ta parandalosh atë. Besnik i kësaj magjie të vakët, shpikte, me qëllim që të mos bënin vaki, rreziqe mizore; natyrisht, në fund zinte e tmerrohej nga frika se këto rreziqe mund të qenë profetike. Natën, i mjerë, arrinte të krijonte një lloj sigurie te substanca arratisëse e kohës. E dinte se kjo substancë po rrokullisej drejt agut të ditës 29. Logjikonte zëlartë: Tani është nata e datës 22. Sa të zgjasë kjo natë (dhe gjashtë të tjera si kjo) jam i paprekshëm, i pavdekshëm. Mendonte se netët me ëndrra ishin pishina të thella dhe të errëta ku mund të zhytej. Shpesh e dëshironte me shpirt breshërimën përfundimtare që do ta çlironte, për mirë apo për keq, nga angaria e kotë e të imagjinuarirt. Më 28, kur perëndimi i fundit i diellit pasqyrohej në hekurat e larta, imazhi i dramës së tij Armiqtë ia zhbëri nga mendja ato arsyetime të urryera.

Hladik-u i kish kaluar të dyzetat, përveç disa miqësive dhe një vargu zakonesh, jeta e tij ishte ushtrimi problematik i letërsisë; si të gjithë shkrimtarët, i maste virtutet e të tjerëve me ato që bënin dhe kërkonte që edhe të tjerët ta matnin me ato që ai përfytyronte apo që projektonte. Të gjithë librat që kishte çuar në shtyp i shkaktonin një ndjenjë komplekse qëndrimi. Në analizën që i pat bërë veprës së Boehme-s, të Abenestra-s dhe Fludd-it kishte luajtur rol në mënyrë thelbësore thjesht puna; në përkthimin që i pat bërë Sepher Yezirah-ut, kish ndikuar shkujdesja, lodhja dhe hamendja. Gjykonte, ndoshta më pak të mangët

Mbrojtjen e përjetësisë: volumi i parë ravijëzon historinë e përjetësive të ndryshme që kanë përfytyruar njerëzit që nga Qenia e palëvizshme e Parmenides-it deri te e kaluara e ndryshueshme e Hinton-it; volumi i dytë mohon (me Francis Bradley-in) teorinë se të gjitha faktet e universit përfshihen në një seri kohore. Ai argumenton se shifra e praktikave të mundshme të njeriut nuk është e pafundme dhe se mjafton një "përsëritje" e vetme për të vërtetuar se koha është një mashtrim… Për fat të keq, nuk janë më pak mashtruese argumentet që vërtetojnë këtë mashtrim. Hladik-u i kalonte ato shpesh përpara syve me një lloj mëdyshjeje përçmuese. Kishte shkruar edhe një seri poezish ekspresioniste; këto, për çudi të poetit, u përfshinë në një antologji të vitit 1924 dhe s'pati antologji të mëpastajme që të mos i trashëgonte. Nga tërë kjo e kaluar e paqartë dhe e venitur, Hladik-u kërkonte ta lante shpirtin me anë të dramës në vargje Armiqtë. (Hladik-u predikonte vargun sepse ai nuk i lejon spektatorët të harrojnë irealitetin, i cili është kusht i artit.)

Kjo dramë vëzhgonte njësitë e kohës, të vendit dhe të aksionit; ajo zhvillohej në Hradcany, në bibliotekën e baronit Roemerstadt, një nga mbrëmjet e fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Në skenën e parë të aktit të parë, një i panjohur i vjen për vizitë Roemerstadt-it. (Ora bie shtatë, një furi e rrezeve të fundit të diellit dalldis xhamat, ajri sjell një melodi të apasionuar dhe të njohur hungareze.) Këtë vizitë e pasojnë vizita të tjera; Roemerstadt-i nuk i njeh, njerëzit e bezdisin, por ka përshtypjen e pakëndshme se diku i kishte parë, ndoshta në ëndërr. Të gjithë e mbysin në lëvdata, por duket sheshit – në fillim për spektatorët e pastaj edhe për baronin vetë – se janë armiq të fshehtë, të përbetuar për t'i bërë varrin. Roemerstadt-i arrin t'i ndalojë apo t'i zhbëjë intrigat e tyre komplekse; gjatë dialogut ata e hedhin fjalën si larg e larg tek e fejuara e tij, Julia de Weidenau dhe te një farë Jaroslav Kubin-i, i cili dikur i kishte rënë asaj më qafë me dashurinë e tij. Tani ky është marrosur dhe kujton se është Roemerstadt-i… rreziqet shtohen; në fund të aktit të dytë Roemerstadt-i është i detyruar të vrasë një komplotist. Nis akti i tretë dhe i fundit. Rrëmeti sa vjen e rritet: kthehen përsëri në skenë aktorë që dukej se ishin nxjerrë jashtë loje; kthehet, për një çast, njeriu që kishte vrarë Roemerstadt-in. Dikush vë në dukje se nuk është errur: ora bie shtatë, në xhamat e lartë pasqyrohet dielli në të perënduar, ajri sjell një muzikë të apasionuar hungareze. Shfaqet bashkëbiseduesi i parë dhe përsëdyt fjalët që ka thënë në skenën e parë të aktit të parë. Roemerstadt-i i flet pa u habitur; spektatori kupton se Roemerstadt-i është mjerani Jaroslav Kubin. Drama nuk ka ndodhur: është marrëzia rrethore që jeton dhe rijeton pafundësisht Kubin-i.

Asnjëherë nuk e kishte pyetur veten Hladik-u nëse kjo tragjikomedi plot gabime ishte e pavlerë apo e mrekullueshme, absolute apo e rastësishme. Në përmbledhjen që skicova, ai parandjente(nuhaste) shpikjen më të përkryer për të fshehur defektet e tij, për të ushtruar idetë e tij fatlume, parandjente mundësinë për të çliruar (në mënyrë simbolike) thelbin e jetës së tij. Tashma kishte mbaruar aktin e parë, si edhe ndonjë skenë të aktit të tretë; karakteri metrik i veprës e lejonte ta redaktonte atë vazhdimisht duke korrigjuar gjashtërrokëshat pa pasur nevojë ta kishte dorëshkrimin para syve. Mendoi se i mungonin edhe dy akte dhe se së shpejti do të vdiste. Në errësirë iu drejtua Zotit. Nëse ekzistoj në njëfarë mënyre, nëse nuk jam një nga përsëritjet apo gabimet e tua, ekzistoj si autor i veprës "Armiqtë".

Për ta përfunduar këtë dramë, që mund të më justifikojë, të të justifikojë edhe ty, më duhet edhe një vit. M'i fal këto ditë, Ti që ke në dorë shekujt dhe kohën. Ishte nata e fundit, më mizorja, por dhjetë minuta më pas, gjumi e mbyti si një ujë i errët.

Ndaj të zbardhur, pa në ëndërr sikur ishte fshehur në një nga navatat e bibliotekës së Clementinum-it. Një bibliotekar me syze të zeza e pyeti: Ç'kërkon? Hladik-u iu përgjigj: Kërkoj Zotin. Bibliotekari ia ktheu: Zoti ndodhet në një nga germat e njërës nga faqet e njërit nga të katërqind mijë volumet e Clementinum-it. Prindërit e mi dhe prindërit e prindërve të mi e kanë kërkuar këtë germë: unë kam lënë sytë duke e kërkuar. Hoqi syzet dhe Hladik-u pa se sytë e tij qenë të vdekur. Hyri një lexues dhe dorëzoi atllasin që kishte marrë. Ky atllas është i pavlerë, tha ai dhe ia la në dorë Hladik-ut. Ky e hapi kuturu. Pa një hartë të Indisë, marramendëse. Befas i hipi një siguri dhe preku një nga germat më të vogla. Një zë nga gjithkund i tha: Të është dhënë koha që të nevojitej për punë. Këtu, Hladik-u u zgjua.

Iu ndërmend se ëndrrat e njerëzve i përkasin Zotit dhe se Maimonides-i ka shkruar që fjalët e ëndrrave janë hyjnore kur dëgjohen të qarta e të shkoqura dhe nuk shihet me sy ai që i thotë. U vesh; dy ushtarë hynë në qelinë e tij dhe e urdhëruan t'i ndiqte pas.

Përtej derës, Hladik-u kishte parashikuar një labirint me galeri, shkallë dhe pavijone. Realiteti ishte më i varfër: zbritën në një oborr të brendshëm nëpërmjet një shkalle të vetme prej hekuri. Shumë ushtarë – disa syresh me uniformë të zbërthyer – jepnin e merrnin me një motoçikletë. Rreshteri vështroi sahatin: ishte ora tetë e dyzetë e katër minuta. Duhet pritur të shkonte ora nëntë. Hladik-u më tepër një kërkush se një fatzi, u ul mbi një stivë drush. Pikasi se sytë e ushtarëve shmangnin sytë e tij. Për t'ia lehtësuar pritjen, rreshteri i dha një cigare. Hladik-u nuk e pinte duhanin; e pranoi nga mirësjellja a nga përulësia. Kur e ndezi, pa se i dridheshin duart. Dita u vrenjt; ushtarët flisnin me zë të ulët sikur ai tashma të kishte vdekur. Më kot u rrek të kujtonte gruan, simboli i të cilës ishte Julia de Waidenau…

Toga e pushkatimit zuri vend dhe mori pozicion gatitu. Hladik-u, në këmbë pas murit të kazermës, priti batarenë e ekzekutimit. Dikush pati frikë se mos njollosej muri me gjak. Atëherë e urdhëruan të dënuarin të bënte përpara disa hapa. Në mënyrë krejt absurde Hladik-ut iu kujtuan ngurimet e fotografit përpara shkrepjes së aparatit. Një sumbull e madhe shiu fshiku një nga tëmthat e Hladik-ut dhe u rrokullis ngadalë nëpër faqen e tij; rreshteri dha me ulërimë urdhërin final.

Universi fizik u ndal.

Armët qenë drejtuar mbi Hladik-un por njerëzit që do ta vrisnin kishin ngurosur. Krahu i rreshterit përjetësonte një gjest të pambaruar. Në një nga plloçat e oborrit një bletë projektonte një hijezë të ngulët. Era kishte ngecur në vend si në një pikturë. Hladik-u u rrek të nxirrte nga gurmazi një çirrmë, një rrokje, u rrek të përdridhte dorën. Kuptoi se ishte paralizuar. Nuk i mbërrinte as zhurmërimi më i mpakët i botës së gurëzuar. Mendoi jam në ferr, kam vdekur. Mendoi, jam i çmendur. Mendoi koha është ndalur. Më pas vrau mendjen se po të ishte kështu, duhet të qe ndalur edhe mendimi i tij. Deshi ta vinte në provë: përsëriti (pa i lëvizur buzët) eglogën e katërt dhe misterioze të Virgjilit. Përfytyroi se ushtarët, tashma të largët, i kishte kapluar i njëjti ankth; deshi të shkëmbente një fjalë me ta. U çudit që nuk ndjente as lodhjen dhe as marramendjen e ngurosjes së tij të gjatë. Ra në gjumë nuk dihet sa kohë. Kur u zgjua, bota vazhdonte të ishte e palëvizshme dhe shurdhace. Në faqen e tij, pika e ujit nuk lëvizte; në oborr, hijeza e bletës dhe tymi i cigares nuk davariteshin. Kaloi edhe një "ditë" tjetër, përpara se Hladik-u ta kuptonte.

Zotit i pat kërkuar një vit të tërë për të mbaruar veprën e tij: një vit po i jipte i gjithfuqishmi. Zoti po ngjizte për të një mrekulli të fshehtë: plumbi gjerman do ta vriste në orën e caktuar, por në mendjen e tij, që nga urdhëri deri tek ekzekutimi i tij do të rridhte një vit i tërë. Hladik-u u mëdysh, pastaj u topit, u nënshtrua dhe pas nënshtrimit e pushtoi një mirënjohje e beftë.

Nuk kishte në dorë asnjë dokument tjetër përveç kujtesës; ngase i mësonte përmendësh të gjithë gjashtërrokëshat që shtonte, i qe krijuar një saktësi fatlume, të cilën as që e merrnin dot me mend aventurierët që kuturisen dhe harrojnë paragrafet e përkohshme dhe të turbullta. Nuk punoi për ardhmërinë dhe as për Zotin, të cilit nuk ia njihte shijet letrare. I përpiktë, i ngulët, i fshehtë, ai endi në kohë labirintin e tij ta lartë e të padukshëm. E rithuri aktin e tretë dy herë me rradhë. Fshiu ndonjë simbol tepër të dukshëm: tingëllimi i përsëritur i këmbanave, muzika. Asnjë rrethanë nuk e bezdiste. Hoqi, shkurtoi, zgjeroi; në ndonjë rast iu kthye formës së fillimit. Arriti ta donte oborrin, kazermën; njëra nga fytyrat që e përballte, i ndryshoi krejt konceptimin që kishte për karakterin e Roemerstadt-it. Zbuloi se kakofonitë e mundimshme që e shqetësuan aq shumë Floberin janë thjesht besëtytni pamore: dobësi dhe pengesa të fjalës së shkruar, jo të fjalës tingëlluese… E mbaroi dramën: i mbetej të zgjidhte vetëm një epitet. E gjeti; pika e ujit rrëshqiti mbi faqen e tij. Ai lëshoi një piskamë çmendarane, lëvizi fytyrën, batarja e shëmbi përtokë.

Jaromir Hladik-u vdiq më njëzet e nëntë mars, në orën nëntë e dy minuta të mëngjesit.

DY ESE NGA TONY MORRISON

LETËRSIA DHE JETA PUBLIKE

Përktheu nga origjinali Granit Zela

Kur i rikthehesh kohës së studimeve universitare, ka gjasë të kesh sërish përjetimet e studentit që merret në provim dhe i duhet të zgjidh probleme, duke hasur vështirësi të ndryshme, për të parashtruar një përgjigje të qartë, të shtjelluar në mënyrë bindëse. Tani, shumë e shumë vite më pas, ndjehem njëlloj si atëherë, sikur jam para një komisioni i cili është gati të më marrë në pyetje dhe të mbaj shënim çfarë them. Dua ta shfrytëzoj rikthimin tek ky përjetim si një mundësi për të shfaqur disa mendime që s'kam pasur asnjë mundësi t'i nyjëtoj publikisht, por vetëm me anë të letërsisë, për të treguar se si këto mendime janë të pranishme në veprën time. Çështja që dua të shtjelloj është mospjesëmarrja në jetën publike, e cila po përkeqësohet nga zvetënimi i jetës private, dhe unë propozoj letërsinë për zgjidhjen e kësaj krize në mënyra që edhe letërsia s'mund t'i imagjinoj.

Gjatë viteve 1980-90, teknologjia dhe bota elektronike pamore e ndryshuan perceptimin e publikut dhe përvojën tonë me njëri-tjetrin. Pas perëndimit të viteve 1960-70, vite tejet të keqpërdorura kur pati një luftë të vërtetë, kundërthënëse, dinamike kundër dhe pro jetës publike dhe opinioneve të shprehur publikisht, duket se s'ka gjasë që të ketë ndonjë dekadë si ajo ku çështjet e ndërgjegjes, moralit, ligjit dhe etikës ishin çliruese dhe jo shtypëse. Ia vlen të theksohet se ishte një dekadë që ndryshe nga çdo e mëparshme, ndjehet keq me veten e vet. Ajo lloj jete publike, lëvizja e të drejtave civile, etj, s'përjetohet ashtu si e mundësuan dukuritë mediatike me anë të peshës së madhe të reklamës dhe fantazisë mediatike, e cila shtyp realitetet e ndarjes dhe shfrytëzimit, maskon shkëputjen e ekzistencës si individ privat dhe publik. Pasoja mund të jenë apatia, neveria, dorëzimi, ose një lloj zbrazëtie e brendshme, një botë ëndërrore e nxitësve artificial dhe përvojës së kthyer në përvojë televizive, ku, siç e ka vënë re Frederic Jameson, "në asnjë civilizim të mëparshëm, çështjet e mëdha metafizike, pyetjet themelore mbi qenien dhe kuptimin e jetës, s'janë dukur të jenë kaq pa lidhje dhe pa kuptim." Ai i shkruante këto mendime në vitin 1971 dhe janë deri diku të pazbatueshme në kohën tonë kur etika e produkteve dhe e mediave kanë forcë më të madhe se sa etika sociale apo drejtësia.

Jetojmë në epokën e spektaklit i cili mëton të na angazhojë, të ndërmjetësojë midis nesh dhe realitetit objektiv pa paragjykime. Ngjan shumë me premtimin për të mirat e energjisë bërthamore: të qenit e sigurt, e pastër dhe me çmim të lirë, por që doli të jetë e rrezikshme, e ndotur (e infektuar) dhe e shtrenjtë. Premtimi i bërë nga spektakli s'është përmbushur. Jo vetëm që s'jemi të angazhuar, por jemi distancuar plotësisht, të paaftë për të dalluar, ndryshuar apo përcaktuar tronditjen ose ndjeshmërinë. Regjimi i autoritetit pamor është një organizim detyrues i imazheve sipas një kronometri dhe e përcjell vetveten tek ne si imitim i reales.

Lajmet premtojnë të na informojnë, megjithatë, bërja njësh e lajmeve të mbrëmjes: e uraganit në Pensilvani, të armatosurve në Bosnjë, mësuesve të Mançesterit në grevë... operacioni i zemrës së një jetimi në Kaliforni, diktohet nga kufizimet kohore të mediumit. Ngjarjet e bëra grumbull i paraqiten shikuesin sikur të ishte ashtu edhe në botën e jashtme, gjë që s' është e vërtetë. Miliona njerëz kërkojnë në ekran shenja të identitetit të tyre kolektiv si një shoqëri kombëtare dhe si qytetarë të botës. Media tani luan rolin vendimtar në krijimin e bashkësisë së përfytyruar të kombit dhe globit. Në këtë mënyrë, lajmet marrin vlerë si sistem autoriteti, një institucion kombëtar me një rol të privilegjuar si roje e identitetit të kombit dhe matës i pulsit të tij.

Ngjarjet e fundit tregojnë se diçka ka shkuar keq. Formula, autoriteti, paradigma, qëllimet e spektaklit mund të jenë duke mos funksionuar. Televizioni që ishte kisha e autoritetit modern më parë i paraqiste lajmet rëndom si spektakël i shenjtë: funeralin e John F. Kennedy-t, dasmën e princit Çarl, inagurimet presidenciale, vdekjen e Dianës, të gjitha nënkuptonin se ajo që transmetohej kishte domethënie të madhe kombëtare dhe ndërkombëtare. Por, te njësimi i lajmit (që s'është vetëm lajm por edhe pikturë) me spektaklin në shërbim të argëtimit fitimprurës, disa narrativa elektronike të krijuara fillimisht si histori zyrtare ose kombëtare, nuk zbuluan identitetin e premtuar kombëtar, por të metat e tij. Lufta bëhet një histori e përcaktuar në kohë dhe formë, ku pyetja elektronike kthehet në politike: Kur do të largohemi? Kur do të kthehen trupat tona ushtarake në shtëpi? Kur do të vdes despoti? Në narrativat e tjera kombëtare, dëgjimi i Clarence Thomas-it, gjyqi i O.J, hetimi i Whitewater-it, seancat dëgjimore të zyrtarëve të lartë para komisioneve të hetimit, koha dhe forma narrative, ashtu si subjekti, i nënshtrohen nevojave të programimit televiziv. Është mbresëlënëse të sjellësh ndër mend se gati të gjitha këto histori të kohëve të fundit janë shumë të ndikuara nga raca dhe/ose seksi dhe autoriteti i ushtruar ose i kufizuar nga secili prej tyre.

Këto spektakle kombëtare nuk i fshehën ndarjet ashtu siç do të donin, por i përkeqësuan. S'mund të mbështetemi te spektakli për t'i zhdukur dhe shmangur plotësisht këto ndarje. Më shumë gjasa ka që të dëmtojë, ndryshojë ose shtrembërojë kohën, gjuhën, përfytyrimin e moralit, konceptet e lirisë, marrjen e njohurive, pasi vetëdijet tona po zvogëlohen në diçka që na sjell rehati. Ne kthehemi në "reklama" për veten nën trysninë e spektaklit që rrënon përvojën tonë të dikotomisë jetë publike/private. Pyetja që ngrihet është se si dhe ku mund ta përjetojmë publiken në kohë, në gjuhë, si pasojë, dhe në kontekst, në mënyrë që të marrim pjesë plotësisht në jetën tonë vetjake, madje qoftë edhe në një jetë të sajuar në lidhje me jetën e bashkësive të ndryshme, të cilat mëtojmë ose dëshirojnë t'u përkasim.

Cili është burimi i këtij perceptimi të thjeshtëzuar të privates dhe publikes? Një pjesë e pështjellimit mund të shkaktohet thjesht nga përdorimi i pakujdesshëm

i termave: ekziston jeta private dhe po ashtu edhe privatizimi i burgjeve, i kujdesit shëndetësor dhe i të ashtuquajturave shkolla publike. Përdorimi i parë buron nga garancitë kushtetuese, si dhe nga nevoja që kemi si individ. I dyti është investim i korporatave që tregtohet publikisht. I pari (nevoja individuale për privatësinë) mund të braktiset, në një emision televiziv, për shembull, ose mund të humbasë në gjykatë (me figurat "publike" dhe personat shumë të rëndësishëm), por në çdo rast, ngjyresa të tilla të privatësisë janë të mbikqyrura vazhdimisht. I dyti, privatizimi i institucioneve zyrtare publike, mund të pengohet gjithashtu nga gjykatat, por ne na paraqiten sikur përfaqësojnë të mirën "publike", si nxitje konkurence dhe kështu me radhë, gjë që ul çmimet dhe rrit cilësinë për konsumatorët. Interesi publik shpesh përcaktohet si interes "i veçantë".

Këto përkufizime që fshijnë kufijtë midis individit dhe komunitetit të tij të përfytyruar, bëjnë që të mos befasohemi apo shqetësohemi nga fakti se jeta publike tani jepet si fenomen pamor i një narrative të zgjedhur që shfrytëzon dhe bën të bujshëm seksin, racën, familjen dhe rrezikun që ekziston për jehonën në nivel kombëtar që ato kanë dhe aftësinë që kanë për t'u tregëtuar. Kjo shpërbërje kaotike e jetës private dhe publike - jetës private të mbikqyrur vazhdimisht - dhe e fushës publike që s'e kontrollojmë dot, nxit ndrydhjen brenda narcizimit të së ndryshmes, dorëzimin tek kënaqësitë sipërfaqësore të argëtimit ose pjesëmarrjes në një bashkësi krejtësisht të gënjeshtërt të krijuar nga frika dhe dëshira e pafund.

Mua më duket se përballë këtyre përmbysjeve tashmë që kanë ndodhur, ndërkohë që ka gjasa të ketë edhe të tjera, letërsia ofron një lloj të veçantë përmirësimi. Historia e mëtimeve për studimin e letërsisë rrotullohet rreth tre përfitimeve kryesore: 1. ndikimi në krijimin e karakterit të letërsisë, fuqizimin e forcës morale, 2. të qenit e përshtatshme për aktivitete argëtimi intelektual, jo-politik, 3. rolin e saj në zhvillimin e fuqisë së imagjinatës e cila është thelbësore për një qytetar. Edukimi për të qenë qytetar i një vendi është më i rëndësishëm sesa edukimi për të qenë konsumator, të qenit qytetar si objektiv shoqërizohet me ide trazuese nacionaliste. Problemi me nacionalizmin s'është dëshira për vetëvendosje, por iluzioni epistemologjik se mund të ndjehesh si në shtëpinë tënde, mund të kuptohesh, vetëm nga njerëz si ti. Ajo që bie në sy me nacionalizmin s'është dëshira për të qenë zot në shtëpinë tënde por bindja se vetëm njerëzit si ti meritojnë të jenë në atë shtëpi.

Nëse cilësitë ndikuese të letërsisë në formimin e karakterit të njeriut, intelektualizmi i saj rreptësisht jo-politik, ose dobia për të krijuar qytetarë më të mirë dhe përkujdesës – nëse njëra prej këtyre mëtimeve ende është e rëndësishme për lexuesit (dhe s'jam e sigurt nëse çështja e letërsisë la ndryshuar shumë që prej mendimeve të shfaqur nga F.R.Leavis-it tek revista American Scholar apo hulumtimet e Emerson-it), ekziston sidoqoftë një lloj nevoje e menjëhershme për ta studiuar letërsinë: letërsia artistike mund të jetë (dhe besoj se është) rruga e fundit dhe vetmja për të kujtuar, e vetmja digë qëndrese ndaj shpërdorimit të kotë të ndërgjegjes dhe kujtesës. Letërsia artistike mund të ketë një alternativë gjuhësore që mund të organizohet, të shmangë ose ta analizojë regjimin, autoritetin e pushtetit pamor elektronik, joshjen e "virtuales." Studimi i letërsisë artistike mund të jetë gjithashtu edhe mekanizmi i vendosjes së lidhjes në hallkën e shkëputur mes publikes dhe privates.

Letërsia ka veçori që bëjnë të mundur ta përjetosh publikun pa qenë i detyruar dhe pa iu dorëzuar atij. Letërsia s'e pranon dhe e prish konsumin pasiv ose të pakontrolluar të spektaklit të krijuar për ta shtetëzuar identitetin në mënyrë që të na shesë produkte. Letërsia s'na kërkon por na lejon ta shprehim përvojën tonë si individ shumëpërmasor. Duke bërë kështu, ajo është më e domosdoshme se kurrë më parë. Si art, letërsia merret me pasojat njerëzore të disiplinave të tjera: historisë, të drejtës, shkencës, ekonomisë, mjekësisë etj. Si rrëfim, forma është metoda kryesore me të cilën njohuritë rroken dhe përkthehen si rrokje e njëkohshme e natyrës njerëzore në kohë, kontekst, hapësirë, në gjuhë metaforike dhe shprehëse, e cila organizon ndikimin çorientues të realiteteve të shumëfishta: të zmadhuara, virtuale, mega-realiteteve, hiper-realiteteve, atyre kibernetike, të mundshme, të tejdukshme, dhe nostalgjike. Më në fund, letërsia mund të projektojë një të ardhme më pak të mundimshme.

Këto lëvizje teorike (në lidhje me prirjen e veçantë të romanit për të përjetuar një tërheqje gjithnjë e më të madhe nga jeta publike) bëhen teknika të dallueshme në tre librat e fundit që kam shkruar: I dashuri, Xhaz, Parajsë, romane që kanë të përbashkët paradoksin strukturor romanor. Një përmbledhje pas-rrëfimore, jashtë-tekstore, jashtë librit që komenton jo për subjektin ose tregimin, por për të përjetuarit e subjektit; s'komenton kuptimin e tregimit, por përvojën e nxjerrjes së kuptimit nga tregimi. Këto përmbledhje shtesë, luajnë rolin e mbrojtjes publike, duke këmbëngulur në pasojat e leximit të librit, duke ndërhyrë në intimitetin e vendosur midis lexuesit dhe faqes, duke e bërë të detyrueshme, nëse ia del, një përsiatje, debat, diskutim i cili ka nevojë për të tjerët për të realizuar hulumtimin më të plotë të mundshëm. Shkurt, aktet shoqërore plotësojnë përvojën e leximit.

Romani I dashuri e përfundon rrëfimin me pyetjen e Sethes për individualitetin e saj. Aktivitet jashtë-rrëfimor është risjellja e ndjenjës së të qenit e përndjekur, ndjenjë më e fortë tani nga sa hamendësohej të ishte në fillim: një fëmijë i mllefosur, krijesë ligësia e së cilës ishte e përligjur. Shumë më përtej se problemi i asgjësimit, ajo, figura e të Dashurit e thirrur në "jetën e përtejme" të librit tani është përgjegjësia e atyre që janë bërë pjesë dhe kanë qenë dëshmitarë të historisë. Është përgjegjësi private që fsheh detyrimet publike ose të bashkësisë: "Kjo s'është një histori për t'ia treguar kujtdo." "Kushdo mund ta prek nëse do." "Atë e harruan." "Vetmia që mund të tronditet [individuale]" "Vetmia që endet [publike]."

Tek romani Xhaz, përtej librit, gjestet janë më të forta: personazhet shpëtojnë nga prognoza e librit, janë të ndryshëm dhe më të ndërlikuar se janë përfytyruar në libër. Kështu, paragrafët e fundit s'përbëjnë thjesht një lutje për të kuptuar një rrëfimi mashtrues, vetë-përfshirës, por për një marrëdhënie private të stërholluar, të përbashkët, shumë intime midis lexuesit dhe asaj që është shkruar në fletë. Këto paragrafë bëjnë të mundur pjesëmarrjen e lexuesit duke i kushtuar vëmendje të madhe, imponuese veprimit të leximit si veprim me pasoja publike dhe madje edhe përgjegjësi publike. Nga fjali të tilla si: "Shih, shih. Shih ku janë duart e tua. Shihi tani," mund të krijohet ideja se je ti që duhet të bësh diçka, diçka duhet të përfytyrohet përsëri, të ndryshohet dhe se vërtetë është në duart e lexuesit.

Në romanin Parajsa, përsëri romani mbaron (ose mbyllet) me veprimtari pothuajse të parëndësishme për rrëfimin. "Pothuajse" sepse të lejon të hamendësosh për atë që u ndodhi grave në manastir. Por, para së gjithash, për të përfunduar lojën me ungjillin, "vizitat" dhe "vështrimet" e Testamentit të Ri dhe më në fund për të rigjetur përfytyrimin e parajsës. Dhe parajsa s' është gjë tjetër por një ekzistencë e vetmuar, në çdo lloj projektimi, një bashkësi me jetë të përbashkët publike. Romani, besoj, lejon, nxit mënyra për ta përjetuar publiken - në kohë, me ndikim, në një hapësirë të përbashkët shoqërore, tek njerëz të tjerë (karakteri i tyre) dhe tek gjuha e cila këmbëngul në pjesëmarrjen individuale. Ai përpiqet edhe të hedh dritë dhe vendos një urë lidhëse mes saj dhe jetës publike.

RREZIKU

Regjimet autoritare, diktatorët, despotët janë shpesh, por jo gjithmonë, budallenj. Por asnjëri prej tyre nuk është aq budalla sa t'u lërë shkrimtarëve largpamës, disidentë, dorë të lirë për të botuar gjykimet e tyre apo për t'iu bindur instinkteve krijuese. Ata e dinë këtë e bëjnë duke marrë rrezikun në sy. Nuk janë aq budallenj sa të heqin dorë nga kontrolli (i hapur ose i fshehtë) i medias. Metodat e tyre përfshijnë mbikëqyrjen, censurën, arrestimin, madje edhe vrasjen e atyre shkrimtarëve që e informojnë dhe e shqetësojnë publikun. Shkrimtarët e trazuar, ata që bëjnë pyetje duke dyshuar, duke i parë gjërat në një këndvështrim më të gjerë, gazetarët, eseistët, shkruesit në blogje, poetët, dramaturgët, mund t'i hapin punë shtypjes sociale që funksionon si një gjendje kome për popullatën, një gjendje kome të cilën despotët e quajnë paqe dhe këta janë ata që ndërpresin hemoragjinë e gjakut të luftës, i cili shndërrohet në ushqim për përkrahësit e politikës së forcës dhe spekulatorët që fërkojnë duart.

Ky është rrezik i tyre. I yni është i një lloji tjetër. Sa e zymtë, e padurueshme, e urryer bëhet ekzistenca kur nuk na lejohet krijimi i veprës së artit. Fakti që jeta dhe vepra e shkrimtarëve të cilët përballen me rrezikun duhet të mbrohet është nevojë e ngutshme, por bashkë me këtë ngut, duhet të sjellim në kujtesë se mungesa e tyre, bllokimi i punës së shkrimtarit, zhdukja e tij mizore, është një rrezik po aq real edhe për ne. Shpëtimi që duam për ta është një bujari për veten. Ne të gjithë e dimë që kombet mund të identifikohen me shkrimtarët e arratisur nga brigjet e vendeve të tyre. Këto janë regjime që përligjin frikën e shkrimit të pambikqyrur ngaqë e vërteta i shqetëson. Është shqetësim për luftënxitësin, torturuesin, hajdutin e korporatave, kalemnxhijtë e politikës, sistemin e korruptuar të drejtësisë, si dhe për një publik në gjendje kome. Shkrimtarët e papersekutuar, të paburgosur, shkrimtarët e bezdisshëm janë shqetësues për injorantin mujshar, racistin tinëzar dhe grabitqarët që ushqehen nga burimet e botës.

Alarmi, ky shqetësim për ngritjen e problemeve nga shkrimtarët është iluminues për shkak se ky veprim është i hapur dhe i pambrojtur, por nëse nuk mbikqyret nga policia është kërcënues. Rrjedhimisht shtypja historike e shkrimtarëve është shenjë e hershme paralajmëruese e zhdukjes së të drejtave dhe lirive të tjera që pasojnë. Historia e shkrimtarëve të persekutuar është po aq e gjatë sa historia e vetë letërsisë. Dhe përpjekjet për të na censuruar, për të na lënë të vdesim urie, për të na displinuar dhe për të na asgjësuar përbëjnë shenja të qarta se diçka e rëndësishme ka ndodhur. Forcat kulturore dhe politike mund të rrafshojnë të gjithë llojet a arteve, përveç "të sigurtit", të gjitha llojet a arteve përveç atyre të miratuara nga shteti.

Më kanë thënë që ekzistojnë dy reagime njerëzore ndaj perceptimit të kaosit: ndërrimi i emrave dhe dhuna. Kur kaosi është thjesht e panjohura, ndërrimi mund të arrihet pa asnjë përpjekje – një specje, yll, formulë, barazim, prognozë e re. Ndodh gjithashtu edhe krijimi i një harte, katagolizimi i gjithçkaje, ose krjimi i emrave të rinj për zona gjeografike që mungojnë, për peizazhe dhe popullsi. Kur kaosi bën qëndresë, ose duke e reformuar veten ose duke u rebeluar kundër një rendi të imponuar, dhuna shihet si reagimi më i shpeshtë dhe më racionali në përballjen me të panjohurën, të kobshmen, të egrën, të paarsyeshmen dhe të pakorrigjueshmen.

Reagime racionale mund të jenë; censura, internimi në kampe, burgjet, ose vdekja, vetëm për ty ose bashkë me të tjerët në luftë. Nuk ka megjithatë një reagim të tretë ndaj kaosit, i cili është heshtja. Një heshtje e tillë mund të jetë pasiviteti dhe mosdëgjimi. Mund të jetë frika paralizuese. Por mund të jetë edhe arti. Ata shkrimtarë që e ushtrojnë zejen e tyre afër ose larg fronit të pushtetit politik, atij ushtarak, në ndërtesën shtetërore perandorake apo në shtëpizë, mund të krijojnë një kuptim përballë fytyrës së kaosit, dhe ata duhet të mbështeten, të mbrohen. Dhe është e drejtë që një mbrojtje e tillë të nisë nga shkrimtarët e tjerë. Dhe është e domosdoshme jo vetëm për të shpëtuar shkrimtarët e rrethuar, por për të shpëtuar veten tonë.

Mendimi që më bën të sjell në kujtesë me tmerr fshirjen e zërave të tjerë, të romaneve të pashkruara, poezive të pëshpëritura ose të gëlltitura nga frika e përgjimit nga njerëz të këqinj, metoda të jashtëligjshme, gjuhë të nxjerra jashtë përdorimit që fliten nëpër kthina nëntokësore, pyetjet e eseistëve që sfidojnë autoritetin që nuk janë bërë kurrë, drama të pavëna në skenë, filma që nuk janë shfaqur-ky mendim më kthehet në makth. Është sikur një univers i tërë ngjyroset me bojë të zezë. Disa lloje traumash tek disa popuj janë aq të mëdha, në mënyrë mizore, sa ndryshe nga paraja, ndryshe nga hakmarrja, dhe madje ndryshe edhe nga drejtësia, apo vullneti i mirë i të tjerëve, vetëm shkrimtarët mund t'i përkthejnë këto trauma, ta kthejnë dhimbjen në kuptim, duke e forcuar përfytyrimin për të moralshmen. Jeta dhe verpa e shkrimtarit s'janë një dhuratë për njerëzimin; ato janë domosdoshmëri.

LEDION KRISAFI

e hëna e parë e dhjetorit

OnufriRoman